

PYJET E VJETËR TË AHUT NË SHQIPËRI



Abdulla Diku

Lulëzim Shuka

**PYJET E VJETËR
TË AHUT
NË SHQIPËRI**

Abdulla Diku

Lulëzim Shuka



Një komb që shkatërron tokën e tij shkatërron vetveten.
Pyjet janë mushkëritë e vendit, ato pastrojnë ajrin
dhe i japin energji të freskët popullit.

- *Franklin D. Roosevelt, presidenti i 32-të i SHBA (1933-1945).*

Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri

Në realizimin e këtij botimi kanë kontribuar:

Teksti	Dr. Abdulla Diku
Habitatet	Prof. Dr. Lulëzim Shuka
Informacioni	MSc. Admir Seci
Gjeologjia	Dr. Hamdi Beshku
Hartografimi	MSc. Elson Salihaj
Redaktoi	Jetmira Muçaj

Informacione mbi pyjet e Ahut: Inxh. Daut Breçani (Tropojë)
Inxh. Bajram Kullolli (Librazhd)
Inxh. Hazis Porja (Mat)

Fotot për zonën Curraj i epërm: Ondrej Kameniar (Universiteti i Shkencave të Jetës, Pragë, Çeki)
Fotot për zona e tjera: Abdulla Diku & Lulëzim Shuka

Botimi, përveç shfrytëzimit të burimeve të literaturës është shoqëruar edhe me ekspedita në terren, të realizuara në periudhën Gusht-Dhjetor 2017.

© PSEDA - ILIRIA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për autorin. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet pa lejen apo citimin e tij.

ISBN 978-9928-202-93-2



Ky botim është realizuar në kuadër të projektit; "Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri", mbështetur nga GEF/SGP Shqipëri.

Projekti është zbatuar nga organizata ILIRIA, Tiranë. [web: www.iliria-al.org](http://www.iliria-al.org)

Përmbajtja

Shkurtime	8
Hyrje	9
Pyjet në Shqipëri	10
Karakteristikat e pyjeve të vjetër.....	11
Pyjet dhe drurët më të vjetër në Botë	13
Pyjet e vjetër e të virgjër në Shqipëri	14
Vlerësimi i vlerave të pyjeve të vjetër të Ahut	16
Rëndësia e pyjeve të vjetër	18
Rëndësia ekologjike.....	18
Roli kulturor i pyjeve të vjetra.....	19
Legjislacioni për pyjet e vjetër	20
Pyjet e vjetër dhe sistemi kombëtar i zonave të mbrojtura	22
Ahu (Fagus sylvatica L.)	23
Pyjet e Ahut në Shqipëri.....	26
Evidentimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri.....	27
Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri.....	28
Habitatet kryesore ku shrihen pyjet e vjetër të Ahut.....	31
Toka.....	33
Klima.....	33
Biodiversiteti në Pyjet e Vjetër të Ahut në Shqipëri.....	34
Fauna.....	34
Flora.....	36
Aktivitetet kryesore që mund të zhvillohen.....	39
Zonat me Pyje të Vjetër Ahu në Shqipëri	41
Livadhi i Harushës	41
Skeda e zonës.....	41
Përshkrimi i zonës.....	45
Gjeologjia dhe hidrogeologjia.....	46
Hidrografia.....	48
Habitatet kryesore në zonë.....	48
Vlerat kryesore të zonës.....	51
Udhërrëfyes për në zonë.....	53
Lumi i Gashit	55
Skeda e zonës.....	55
Përshkrimi i zonës.....	55
Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut.....	61
Gjeologjia dhe hidrogeologjia e zonës.....	64
Hidrografia.....	65
Habitatet kryesore.....	66
Vlerat kryesore të zonës.....	70
Udhërrëfyes për në zonë.....	72
Lumi i Tropojës	73
Skeda e zonës.....	73
Përshkrimi i zonës.....	73
Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut.....	78
Gjeologjia dhe hidrogeologjia.....	79

Hidrografia.....	81
Habitatet kryesore në zonë	81
Vlerat kryesore të zonës.....	83
Udhërrëfyes për në zonë.....	86
Curraj i Epërm	87
Skeda e zonës.....	87
Përshkrimi i zonës.....	92
Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut	93
Gjeologjia dhe hidrogeologjia.....	94
Hidrografia.....	95
Habitatet kryesore në zonë	96
Vlerat kryesore të zonës.....	99
Vlera të tjera natyrore dhe kulturore të zonës	100
Udhërrëfyes për në zonë.....	102
Zall-Gjoçaj	104
Skeda e zonës.....	104
Përshkrimi i zonës.....	109
Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut	110
Gjeologjia dhe hidrogeologjia.....	111
Hidrografia.....	112
Vlerat kryesore të zonës.....	113
Habitatet kryesore në zonë	115
Vlerat natyrore dhe kulturore të zonës.....	118
Udhërrëfyes për në zonë.....	118
Rrajca	121
Skeda e zonës.....	121
Përshkrimi i zonës.....	126
Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut	127
Gjeologjia dhe hidrogeologjia.....	128
Hidrografia.....	128
Vlerat kryesore të zonës	129
Habitatet kryesore në zonë	130
Udhërrëfyes për në zonë.....	132
Rreziqet kryesore për pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri	134
Vlerësimi i rreziqeve	136
Mbrojtja e pyjeve të vjetër të Ahut	138
Plani i veprimit për mbrojtjen e pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri	138
Propozime për pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri	140
Inventarizimi i pyjeve të vjetër	142
Plani i monitorimit për pyjet e vjetër të Ahut	143
Old beech forests in Albania	145
Old beech forests in world	146
Old beech forests in Albania	148
Old forests and the national system of protected areas	149
Protection of old beech forests	151
Proposals for old beech forests in Albania	152
Referenca / References	153

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Sipërfaqja dhe volumi sipas llojeve pyjore në Shqipëri	10
Grafiku 2. Sipërfaqja e pyjeve të Ahut sipas rretheve	26
Grafiku 3. Volumi i pyjeve të Ahut, sipas rretheve	26
Grafiku 4. Sipërfaqja e zonave qendrore dhe buferike e pyjeve të vjetër të Ahut	29
Grafiku 5. Sipërfaqja me pyje të vjetër të Ahut (% që zë secila zone ndaj totalit)	30
Grafiku 7. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Lumi i Gashit”	62
Grafiku 8. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, “Lumi i Gashit”	63
Grafiku 9. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Lugina e Tropojës”	78
Grafiku 10. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, “Lugina e Tropojës”	79
Grafiku 11. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Curraj Epërm”	93
Grafiku 12. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, “Curraj i Epërm”	94
Grafiku 13. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Mbasdeje”	110
Grafiku 14. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, “Mbasdeje”	111
Grafiku 15. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Rrajca”	127
Grafiku 16. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, “Rrajca”	127
Grafiku 17. Niveli i rrezikut sipas zonave me pyje të vjetër Ahu	136

Lista e figurave

Figura 1. Zhvillimi i pyllit, deri në stadin klimaks	12
Figura 2. Harta e shtrirjes së Ahut (<i>F. sylvatica</i>) në Evropë	24
Figura 3. Kërkesat optimale të Ahut ndaj faktorëve ekologjikë	25
Figura 4. Zonat me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri	28
Figura 5. Habitatet kryesore ku shtrihen pyjet e vjetër të Ahut	32
Figura 6. Gjitarët në pyjet e vjetër të Ahut	34
Figura 7. Shpendët në pyjet e vjetër të Ahut	35
Figura 8. Amfibët në pyjet e vjetër të Ahut	35
Figura 9. Insektet dhe molusqet në pyjet e vjetër të Ahut	35
Figura 10. Flora në pyjet e vjetër të Ahut	36
Figura 11. Aktivitetet që mund të zhvillohen në pyjet e vjetër të Ahut	39
Figura 12. Drejtimet kryesore për në Livadhin e Harushës	54
Figura 13. Drejtimet kryesore për në “Lumin e Gashit”	72
Figura 14. Drejtimi kryesor për në Luginën e Tropojës	86
Figura 18. Drejtimet kryesore për në Rrajcë	132
Figura 19. Rreziqet kryesore për pyjet e vjetër të Ahut	136
Figura 20. Propozimet për pyjet e vjetër të Ahut	141

Lista e tabelave

Tabela 1. Pyjet dhe drurët më të vjetër në botë	13
Tabela 2. Mbulimi i pyjeve të vjetër të Ahu në SKZM	22
Tabela 3. Lista e habitateve të Ahut (<i>F. sylvatica</i>) sipas Natura 2000	25
Tabela 4. Zonat me pyje të vjetër Ahu dhe sipërfaqet e tyre	29
Tabela 5. Të dhëna për moshën e disa drurëve në Lumin e Gashit dhe Curraj i Epërm	31
Tabela 6. Akset rrugore për në Livadhin e Harushës	53
Tabela 7. Akset rrugore për në Curraj të Epërm	102
Tabela 8. Akset rrugore për në Zall-Gjoçaj	119
Tabela 9. Akset rrugore për në Rrajcë	132

SHKURTIME

- AKZM** Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- BB** Banka Botërore
- dH** deutsche Härte (tregues për fortësinë e ujit; 10 mg/l CaO ose 17.848 ppm)
- FAO** Organizata Botërore e Bujqësisë dhe Ushqimit
- GiZ** Organizata Gjermane për bashkëpunim
- ha** Hektar
- HEC** Hydrocentral
- INSTAT** Instituti i statistikave
- ISHMPU** Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave
- IUCN** Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
- l/s** Litër për sekond
- m** Metër
- md** Mbi nivelin e detit
- MTM** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- n/parcelë** Nën parcele pyjore
- Nj.Ad.** Njësi Administrative
- OKB** Organizata e Kombeve të Bashkuara
- OSHC** Organizata të Shoqërisë Civile
- PK** Park Kombëtar
- PM** Plan menaxhimi
- SKZM** Sistemi kombëtar i zonave të mbrojtura
- UNESCO** United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
- UNESCO** Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë

Hyrje

Pyjet janë një vlerë natyrore unike dhe e paçmueshme për nga rëndësia e tyre. Në jetën e përditshme ne i shohim dhe prekim kudo produktet që ofrojnë pyjet duke filluar që nga banesat, mobilet, energjia që sigurohet nga to e deri tek ushqimi apo bimët mjeksore që përfitojmë prej tyre. Një prej vlerave më të mëdha që pyjet na ofrojnë është oksigjeni i cili na mundëson jetën tonë. Është e lehtë për t'u vënë re efekti i pazëvendësueshëm i tyre edhe në peizazh apo në mbrojtjen që i bëjnë tokës nga erozioni dhe degradimi. Ka pafundësisht të mira dhe shërbime që përfitojmë nga pyjet të tilla si; uji i pastër, magazinimi i karbonit, vende pune, reduktim apo parandalim i pasojave të katastrofave natyrore si dhe ofrojnë mbrojtje për më shumë se gjysmën e habitateve tokësore të planetit. Në një farë mënyre pyjet përfaqësojnë edhe 'historinë e natyrës' së një vendi. Në shumë raste drurët janë përdorur si "regjistra" të klimës për ta vlerësuar atë për periudha më të hershme kohore. Përmes analizave të elementëve të drurëve pyjorë dhe bimëve është studiuar dhe përcaktuar dinamika dhe efektet e epokave akullnajore në pjesë të ndryshme të globit.

Qëllimi i këtij botimi ka të bëjë me evidentimin dhe promovimin e atyre fare pak zonave natyrore me pyje të vjetër që kanë mbetur në vend. Janë zona ku natyra ka zhvilluar veten e saj duke mos pasur asnjë ndikim nga njeriu. Proçeset dinamike natyrore kanë ndjekur normalitetin e tyre të zhvillimit, duke arritur në ekosisteme pyjore që përfaqësohen aktualisht me stadin e tyre *klimaks*. Ne kemi vetëm disa zona të vogla dhe të virgjëra të natyrës tonë, këto zona përfaqësojnë Shqipërinë e egër ose 'ishujt e fundit natyrorë' të saj.

Nëse në vitin 1997 pyjet e virgjër përfaqësonin rreth 7% të fondit pyjor kombëtar tashmë këto pyje përfaqësojnë vetëm 1% të tij. Një tregues i reduktimit drastik të tyre në një periudhë kohore kaq të shkurtër.

Ekzistojnë disa kërcënime ndaj pyjeve të vjetër të tilla si; zjarret, prerjet, kullotja, gjuetia, mbetjet, erozioni, hapja e rrugëve, ndërtimet, HEC-et, pronësia mbi tokën etj. Këto kërcënime i bëjnë këta grumbuj edhe më të ekspozuar ndaj rrezikut të zhdukjes së tyre.

Ne duhet të krijojmë mundësitë për ti mbrojtur ato dhe atë çfarë ato përfaqësojnë. Nëse i mbrojmë dhe promovojmë do t'ju krijojmë mundësinë edhe gjeneratave të ardhëshme ti shohin dhe përjetojnë ato. Disa nga zonat me pyje të vjetër Ahu meritojnë të jenë pjesë e UNESCO, *Wilderness Europe*, apo *Sistemit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura*. Prezenca e këtyre organizatave prestigjioze rrit vlerën e vendit tonë, e bën atë më tërheqës dhe më të kërkuar nga vizitorët.

Në botën e qytetëruar, një kulturë që inkurajon respektimin dhe menaxhimin e burimeve pyjore është më e preferuar se një kulturë që nuk i vlerëson seriozisht ato.


Grumbujve me pyje të vjetër Ahu do të propozohet që tu jepet mbrojtje ligjore bazuar në legjisllacionin kombëtar por edhe mbrojtje ndërkombëtare bazuar në direktivat, konventat dhe marrëveshjet ku Shqipëria bën pjesë.

Shpresoj që ky të mos jetë botimi i fundit për pyjet e vjetër dhe të virgjër të Shqipërisë. Gjithashtu uroj që botimet e radhës të mos jenë mbi 'historinë' e pyjeve të virgjëra në Shqipëri por të bazuara në ekzistencën, mirëmenaxhimin dhe mbi histori suksesi të lidhura me to.

Pyjet në Shqipëri

Bazuar në të dhënat e kadastrës pyjore dhe INSTAT (2017) Shqipëria ka rreth 1.052 milion ha me pyje (36.6% të sipërfaqes së vendit), me një volum lënde drusore rreth 51.6 milion m³. Nisur nga këto shifra rezultojnë që pyjet tona janë mjaft të degraduara, duke pasur një volum prej vetëm 49 m³/ha. Në 20 vitet e fundit fondi pyjor kombëtar është reduktuar me 32 milion m³ ndërsa volumi mesatar për hektar është pakësuar me 40% duke rënë nga 81 m³/ha (1997) në 49 m³/ha (2017).

Grafiku në vijim paraqet sipërfaqen dhe volumin e pyjeve të Shqipërisë për vitin 2017 sipas llojeve kryesore që përbëjnë fondin pyjor kombëtar të vendit;



Grafiku 1. Sipërfaqja dhe volumi sipas llojeve pyjore në Shqipëri

Aktualisht jemi vendi më i varfër i Evropës sa i përket burimeve pyjore që kemi. Ekziston një hendek i thellë ndërmjet rritjes natyrore të pyjeve dhe volumit të fondit pyjor që pakësohet dhe ku prerja e pyjeve e tejkalon me 2-3 herë rritjen e tyre.

Nga studimet më të fundit (FAO 2017, BB 2018) vërehet se sasia e fondit pyjor që pakësohet rezultojnë të jetë rreth 2-2.5 herë më e madhe nga sa është rritja natyrore e tyre në vit. Një pjesë e madhe e pyjeve përdoret për dru zjarri (2.5- 3 milion m³/vit), ndërsa pjesa tjetër për sektorin e ndërtimit dhe përpunimit të drurit. Gjithashtu zjarret kanë shkaktuar dhe vazhdojnë të shkakojnë “kafshime” të mëdha në fondin pyjor. Të gjitha këto pakësime (humbje) të fondit pyjor, bëhen në ‘kurriz’ të vetëm 1.4 milion m³ biomase drunore që rritet në vit nga pyjet tona.

Agjensia Evropiane e Mjedisit¹ (2017) tregon se Shqipëria ka shfrytëzuar (pakësuar) në vitet; 1990, 2000, 2005 e 2010 respektivisht; 2.3; 3; 5.5 dhe 4.4 herë më shumë pyje nga sa ishte rritja vjetore e tyre. Një tregues i qartë ky se sa në mënyrë të paqëndrueshme dhe jo eficiente janë përdorur pyjet këto 30 vitet e fundit. Një situatë e ngjashme ka ekzistuar edhe në periudhën 1950-1990, por investimet në krijimin e pyjeve të rinj nga pyllëzimet kanë qenë më të shumta në atë periudhë. Shqipëria përfaqëson sot të vetmin vend në Evropë ku prerja e pyjeve e tejkalon me 2-4 herë rritjen vjetore të tyre.

Kuptohet që pjesë e kësaj situatë të vështirë të fondit pyjor kombëtar janë edhe pyjet e vjetër në Shqipëri.

Karakteristikat e pyjeve të vjetër

Një pyll i vjetër i quajtur ndryshe edhe *pyll primar*, *pyll i virgjër*, *pyll i lashtë* - është një pyll që ka arritur në moshën e tij maksimale pa shqetësime të konsiderueshme, duke shfaqur tipare ekologjike unike. Një pyll i vjetër konsiderohet edhe një komunitet pyjor që ka arritur gjendjen e tij të stadit *klimaks*.

Karakteristika strukturore e pyjeve të vjetër ka të bëjë me praninë e drurëve të vjetër si dhe;

- o shenja minimale të shqetësimeve njerëzore;
- o drurë me moshë të ndryshme;
- o strukturë dhe mbulesë jo uniforme e kurorave;
- o drurë të tharë, të rrëzuar apo të kalbur, pyje shumë katëshe;
- o mbulesa e tokës e paprekur;
- o një ekosistem i shëndetshëm kërpuddhash, prania e llojeve indikatore në pyll.

Disa nga karakteristikat më kryesore të pyjeve të vjetër përveç strukturës janë;

Biodiversiteti. Pyjet e vjetër janë biologjikisht të shumëllojshëm. Në to gjenden më shumë lloje të rralla, specie të rrezikuara të florës dhe faunës se në pyjet e rinj.

Mosha e përzier. Një pyll i vjetër ka një strukturë shumëmoshare të drurëve, për shkak të rigjenerimit (ripërtëritjes) që ndodh në kohë të ndryshme. Mosha e përzier e pyllit është një kriter i rëndësishëm që e bën pyllin një ekosistem të qëndrueshëm në një periudhë të gjatë kohore.

Hapësirat e kurorave. Hapsirat në kurorat e drurëve janë thelbësore në krijimin dhe mbajtjen e strukturës shumëmoshare të grumbullit pyjor. Disa bimë rriten vetëm si rezultat i dritës që vjen prej hapësirave të krijuara në kurorat e drurëve.

Topografia. Pyjet e vjetra përfaqësojnë ekosisteme të qëndrueshme natyrore. Si të tilla ato vendosen në pjesë terreni që kanë komunikim apo ndërlidhje ndërmjet tyre. Karakteristika më kryesore topografike në rastin e pyjeve të vjetër të Ahut është lugina. Në përgjithësi dyshemeja e pyllit ka shenja të ngriturash nëpër të, për shkak të drurëve të kalbur e dekompozuar apo rrënjëve që dalin nga toka prej drurëve të rrëzuar.


1 <https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/forest-growing-stock-increment-and-fellings-3/assessment>

Shtresa me lëndë organike. Toka e pyjeve të vjetër është shumë e pasur në lëndë organike. Drurët e rrëzuar thahen dhe kalben duke veshur shtresën e sipërme të tokës me lëndë organike. Drurët e rënë pasurojnë me materiale organike tokën, duke siguruar një substrat të pasur për myshqet, kërpudhat, filizat si dhe krijimin e mikro-habitatëve për speciet në dyshemenë e pyllit.

Tokat. Tokat e pyjeve të vjetër, për shkak të shtresës së pasur me lëndë organike sigurojnë shumë forma të jetës që strehohen dhe ushqehen aty.

Fazat më kryesore të zhvillimit të pyllit drejt një strukture natyrore përshkruhet në vijim. Figura nr.1 ilustron karakteristikat që lidhen me fazat e rritjes; nga faza e instalimit të pyllit deri tek krijimi i strukturës së pyllit në stadin e tij *klimaks*, me drurë të vjetër, të thatë, të rrëzuar si dhe shumëllojshmëri strukturash vertikale (nga filizëria deri tek drurët e rritur dhe të pjekur).

Figura 1. Zhvillimi i pyllit, deri në stadin klimaks



Koncepti i strukturës së drurëve përfshin mbulesa pyjore me shumë kate dhe hapësira në kurorat e drurëve, lartësi dhe diametra shumë të ndryshëm të drurëve, specie të ndryshme dhe sasi të konsiderueshme të mbeturinave drurore në dyshemenë e pyllit.

Çdo vend ka formuluar propozimet e tij lidhur me përkufizimin e pyllit të vjetër/virgjër. Në terminologjinë pyjore shqiptare, në këtë formulim mund të përfshihen grumbujt e pjekur dhe të tejpkur (zakonisht mbi 120 vjeçarë), me strukturë natyrore (kopshtore).

Një propozim për të përkufizuar pyjet e vjetër në Shqipëri do të ishte: (i) *Pyjet e krijuara në mënyre natyrore*, (ii) *që nuk kanë përjetuar ndikim të rëndësishëm njerëzor gjatë zhvillimit të tyre*, (iii) *ku dominojnë drurët me moshë ≥ 120 vjeçare²*, (iv) *janë të vendosura në njësi territoriale uniforme (të pa fragmentuara) dhe (v) që zenë një sipërfaqe minimale prej 100 ha.*

2 Kjo moshë duhet të përfaqësojë një kufi minimal për të paktën 50% të numrit të druveve zotërues në një zonë të caktuar

Pyjet dhe drurët më të vjetër në Botë

Pyje të vjetra (lashta) janë ato pyje të cilat kanë një periudhë të gjatë dhe të pandërprerë të zhvillimit të tyre. Pyje të tilla gjenden kryesisht në zonën ekuatoriale dhe hemisferën e jugut, për shkak se epokat akullnajore atje nuk kanë pasur të njëjtin ndikim mbi biomasën pyjore si në hemisferën veriore. Pyje të tilla kanë histori zhvillimi miliona vjeçare dhe përfaqësojnë aktualisht zona të mirëfillta relikte nga pikpamja e evolucionit bimor. Psh. pyjet *Tarkine* në Australi të krijojnë idenë sikur kthehesh mbrapa në kohë duke parë se si ka qenë aty jeta në tokë 300 milion vjet më parë.

Në tabelën nr.1 jepet një listë e shkurtër e pyjeve dhe drurëve më të vjetër në Botë;

Tabela 1. Pyjet dhe drurët më të vjetër në botë

Nr.	Pyjet më të vjetër në Botë ³	Drurët më të vjetër në Botë ⁴
1	<i>Tarkine, Australi</i> . Është një masiv i pyjeve tropikale (pyjet e shiut) ku gjenden 'pishat' Huon/Makuarie (<i>Lagarostrobos franklinii</i> (Hook.f.) Quinn)	Pisha Methuselah, (<i>Pinus longaeva</i>), Mosha: 4,849 vjeçare. Kaliforni (SHBA)
2	<i>Pyjet Arakuaria, Kili</i> . Në këto pyje rritet Pisha Kiliane (<i>Araucaria araucana</i> (Molina) K. Koch) me drurë me moshë deri në 1000 vjet.	Gran Abuelo (Gjyshi i madh) - Selvia e Patagonisë (<i>Fitzroya cupressoides</i> I.M.Johnst.) në Kili . Mosha: 3,646 vjeçare.
3	<i>Pyjet Yakushima, Japoni</i> . Përfaqëson një zonë pyjore me Kriptomeria (<i>Cryptomeria japonica</i> (L.f.) D.Don), me drurë rreth 1,000 vjeçarë.	Ulliri Evropian (<i>Olea europaea</i> L.), Oliveira do Mouchão në Portugali . Mosha 3,350 vjeçare.
4	<i>Pyll i lashtë i Pishës Bristlekon, Kaliforni</i> (SHBA). Është një grumbull pyjor ndër më të vjetrit në botë, me pishat <i>Pinus aristata</i> , <i>Pinus longaeva</i> etj. Njëkohësisht gjendet edhe pisha <i>Methuselah</i> , 4,849 vjeçarë.	Sekuolja gjigande (<i>Sequoiadendron giganteum</i> (Lindl.) J.Buchh.) e quajtur ndryshe "Presidenti" në Kaliforni (SHBA). Mosha 3,200 vjeçare
5	<i>Pyjet tropikale Daintree, Australi</i> . Përfaqësojnë një zonë me pyje mjaft të vjetër dhe relikte.	Pisha e maleve Bristlekon, Kaliforni (<i>Pinus aristata</i> Engelm.). Mosha 2,460 vjeçare
6	Pyjet Bialowieza, Poloni dhe Bjellorusi . Një masiv pyjor me 'histori' 7,000 vjeçare, me Hormoq, panja, mështekna, dushqë, vidhe etj.	Fiku i shenjtë (<i>Ficus religiosa</i> L. 1753, Forssk. 1775), në Anuradhapura, Sri Lanka . Mosha 2,302 vjeçare
7	Amazona, Brazil dhe Peru . Përfaqëson pyjet e vjetër dhe ende të paprekur të disa zonave në perëndim të shtetit të Akrës (Brazil) dhe Perunë lindore.	Dëllinja Bennett (<i>Juniperus grandis</i> R.P.Adams) në Kaliforni (SHBA) Mosha: 2,200 vjeçare
8	<i>Pyjet Vaipoua, Zealanda e Re</i> . Masivi pyjor me drurë e shkurre përfaqëson një entitet gati 2000 vjeçarë	Pisha bisht dhelpër (<i>Pinus balfouriana</i> Balf.) në Kaliforni (SHBA). Mosha 2,110 vjeçare.
9	Pyjet e Baobabit, Madagaskar dhe Afrika e Jugut . Përfaqëson një ekosistem pyjor me drurë mbi 1,000 vjeçarë.	Larshi sub-alpin (<i>Larix lyallii</i> Parl.) në Kanada . Mosha: 1,944 vjeçare
10	Pyjet Kombëtare Tongas, Alaskë (SHBA). Janë pyje që arrijnë moshë deri 700 vjeçare, dhe që bëjnë një kontrast unik me peizazhin ku ndodhen.	Druri Sugi, Kriptomeria – (<i>Cryptomeria japonica</i> (L.f.) D.Don), në Japoni Mosha: 1,806 vjeçare

3 <https://www.afar.com/magazine/10-amazing-ancient-forests-around-the-world>

4 <https://10mosttoday.com/10-oldest-still-living-trees-world/>

Pyjet e vjetër e të virgjër në Shqipëri

Mjedisi natyror në kontinentin Evropian përjetoi ndryshime drastike në periudhën e *pleistocenit* (epoka gjeologjike e *kuaternarit*). Faza e fundit akullnajore *Würm*⁵ (24,000-10,000 vjet më parë) ndikoi dukshëm në strukturën dhe shpërndarjen e vegjetacionit në kontinent. Nga kjo periudhë e kanë origjinën masivet pyjore të kontinentit evropian që ne shohim sot. Tërheqja e akujve mundësoi shtrirjen e mbulesës pyjore nga jugu (mesdheu) drejt veriut të kontinentit.

Në këtë mënyrë filloi vendosja e pyjeve nga jugu drejt veriut duke nisur me llojet; kserofite → dushqet → ahët → rrobujt → hormoqet → hartina → mështekna etj. Një shtrirje të ngjashme patën pyjet edhe në drejtimin vertikal në masivet e larta malore të Alpeve evropiane, Karpatat, Alpet Dinarike etj.

Për shkak të izolimit gjeografik dhe pamundësisë për të aksesuar masivet me pyje natyrore të vendit, periudha 1900-1944 e gjeti vendin tonë me pjesën më të madhe të pyjeve të zonave malore të dominuara nga Ahu, Pisha e zezë, Rrobulli, Arneni, Bredhi i bardhë etj. me strukturë të virgjër ose natyrale. Përdorimi i pyjeve në pjesën më të madhe të tij mbetej i kufizuar dhe vetëm për plotësimin e nevojave të popullsisë.

Pas vitit 1944 në Shqipëri gjendeshin rreth 300 mijë hektarë me pyje Ahu e Bredhi, si dhe rreth 100 mijë hektarë pyje pishash (Pishë e zezë, Rrobulli, Arneni) me strukturë natyrore. Ndër masivet me të mëdha me pyje të tillë ishin; Vermoshi, Fushë-zeza, Boga, Thethi (Shkodër), Valbona dhe Lumi i Gashit (Tropojë), Shëmri, Arrën dhe Surroj (Kukës), Kurorë-Dardhë, Munellë, Krab e Kaçinar (Pukë), Lurë, Prat-Selishtë, (Dibër), Mbasdejë, Qafë-Shtamë, Llapushë, Balgjaj, Bizë-Martanesh (Mat), Stravaj, Sopot, Rrajcë, Qarrishtë, Steblevë (Librazhd), Bishnica (Pogradec), Gjinari e Zavalinë (Elbasan) etj.

Për shkak të izolimit të plotë dhe mungesës thujse totale të ndikimit të njeriut disa prej masiveve pyjore të virgjër të përmendura më lart kanë përbërë në këtë periudhë vlera të jashtëzakonshme shkencore që nuk i kanë shpëtuar as vëmendjes së studjuesve të huaj siç është rasti i *Frederik Mark-Graf-it* i cili në librin e tij “Pflanzengeografie Albaniens” i karakterizon si vlera unike në Evropë masivet tona pyjore të *Lurës, Vermoshit, Thethit, Lumit të Gashit, Rrajcës, Steblevës*, etj.

Për shkak të natyrës së zhvillimit të vendit dhe kërkesave të larta për lëndë drusore, në periudhën 1950-1990 është shfrytëzuar prej pyjeve thujse trefishi i mundësisë së shfrytëzimit. Kjo bashkë me shpyllëzimin masiv të rreth 300,000 ha me pyje dushqesh në zonën fushore dhe kodrinore të vendit, shkaktoi një degradim dhe pakësimin drastik të sipërfaqes së pyjeve natyrore (virgjëra) në vend.

Pas vitit 1990 megjithëse vendi duhej të ishte në emergjencë mjedisore sa i përket pakësimit të fondit pyjor, u vazhdua me prerjet masive të pyjeve, veçanërisht periudhat 1991-1993 dhe 1998-2002. Për të përkeqësuar me tej situatën zjarret masive këto vitet e fundit dogjën

5 Würm është emri i lumit në Alpet Evropiane, prej te cilit ka marrë emrin akullnaja

shumë nga grumbujt pyjorë kudo në vend. Nga ana tjetër, investimet në pyllëzime pas vitit 1990 kanë qenë në nivele minimale dhe të papërfillshme.

Botimi i vetëm lidhur me pyjet e virgjër është ai i vitit 1997; “Pyjet e Virgjër të Shqipërisë” – (Vëzhgimi ekologjik). Botimi u realizua nga Institut i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave, Instituti i Kërkimeve Biologjike dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës. Botimi përbënte një analizë shkencore të pyjeve të virgjër, parë nga aspektet ekologjike më shumë se për nga rëndësia ekonomike e tyre. Studimi përfshinte 34 ekonomi pyjore me pyje të virgjër, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 69,430 ha, si dhe propozimin për shpalljen e pesë zonave si Parqe Kombëtare, me një sipërfaqe 16,700 ha.

Që nga viti 1997, sipërfaqja e pyjeve të virgjër në Shqipëri është pakësuar me afro 7 herë.



Vlerësimi i vlerave të pyjeve të vjetër të Ahut

Për shkak të rëndësisë së madhe dhe vlerave që ato mbartin, pyjet e vjetër të Ahut janë përfshirë në listën e disa prej organizatave me prestigjoze në botë dhe Evropë si psh. UNESCO, Wilderness Europe etj. Gjithashtu, me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të pyjeve të vjetër të Ahut janë krijuar rrjete të tilla si psh.; *'Rrjeti Evropian i Pyjeve të Ahut'*. Nga ana tjetër lista e Habitave të Natura 2000 përmban së paku nëntë emërtime kryesore (kode) për pyjet e Ahut.

Pyjet e vjetër të Ahut në UNESCO. Lista e Trashëgimisë Botërore (UNESCO) është një përmbledhje e monumenteve më të rëndësishme, më të shquara dhe më të vlefshme kulturore dhe natyrore në botë. Arsyet se përse Ahu (*Fagus sylvatica* L.) është unik në shkallë evropiane dhe botërore edhe përse UNESCO i ka përfshirë pyjet e Ahut në inventarin e saj janë se:

- Ahu evropian është i përhapur dhe i kufizuar vetëm në Evropë;
- Mund të mbizotërojë pyjet pothuajse apo tërësisht, ashtu si asnjë specie tjetër drunore në Evropë apo në botë;
- Ahu është zhvendosur gjatë periudhës së akullnajave në skajet më jugore të kontinentit, dhe u rikthye sërish në zonat e tij natyrore;
- Ka aftësi të madhe përshtatëse dhe toleruese në kushte të ndryshme klimatike, gjeografike dhe fizike.

Në Korrik 2017, UNESCO mori vendimin për nominimin e *"Pyjeve Primare dhe të Vjetër të Ahut të zonës së Karpateve dhe Rajonave të Tjera të Evropës"*, si pjesë e Trashëgimisë Natyrore Botërore. Në këtë listë u përfshinë pyjet e Ahut në Shqipëri, Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Itali, Rumani, Slloveni, Spanjë dhe Ukrainë.

Shqipëria, krahas zonave të trashëgimisë kulturore që janë pjesë e UNESCO-s, ka tashmë edhe dy zona pjesë të Trashëgimisë Botërore Natyrore; Pyjet e Vjetër të Ahut në Rrajcë (Përrenjas) dhe ato të Lumit të Gashit (Tropojë).

Rrjeti Evropian i Pyjeve të Ahut. Synon krijimin e një rrjeti funksional të ekspertëve të pyjeve të Ahut dhe praktikantëve nga zonat që kanë pyje me vlerë (të vjetra) të Ahut. Rrjeti do të shërbejë si një platformë për:

- Mësim të ndërsjellë dhe shkëmbim të gjetjeve / rezultateve kërkimore të kohëve të fundit në lidhje me gjendjen e pyjeve të Ahut në përgjithësi;
- Diskutimin e qasjeve të ndryshme të menaxhimit në lidhje me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve të Ahut;
- Zhvillimin e një strategjie të përbashkët për pyjet e Ahut në Evropë.

Wilderness Europe. Është një organizatë evropiane e cila synon të evidentojë dhe promovojë zona natyrore dhe të pa ndikuara nga njeriu. Përfaqëson një rrjet zonash nëpër vende të ndryshme evropiane, duke përfshirë; zona të mbrojtura, lumenj, pyje, ekosisteme malore etj.

Natura 2000. Lista e habitateve⁶ të Natura 2000 përmban nëntë klasifikime specifike (emërtime dhe kode) për Ahun evropian (*F.sylvatica* L.) dhe bashkëshoqërimet e tij natyrore. Kjo për shkak të shtrirjes së gjerë të tij nëpër të gjithë kontinentin evropian.



⁶ Natura 2000 përfshin zonat kryesore për shumimin dhe jetesën e llojeve të rralla e të kërcënuara, dhe disa tipe habitatesh të rralla natyrore. Ai shtrihet në 28 vendet e BE-së, si në det dhe në tokë. Qëllimi i rrjetit është të sigurojë mbijetesën afatgjatë të llojeve dhe habitateve më të çmuara dhe më të rrezikuara të Evropës të listuara nën Direktivën e Shpendëve dhe në Direktivën e Habitaveve.

Rëndësia e pyjeve të vjetër

Rëndësia ekologjike

Ka shumë arsye se përse duhen ruajtur pyjet e një vendi, por ruajtja e pyjeve të vjetër është akoma më shumë e rëndësishme. Disa nga arsyet janë;

- Pyjet e vjetër përfaqësojnë qindra e mijëra vite të trashëgimisë gjenetike. Duke mbijetuar në kushte të ndryshme, në këto pyje gjenden drurë të vjetër të cilët mund të përmbajnë gjene që do ju mundësojnë atyre t'iu mbijetojnë ndryshimeve të klimës globale, sëmundjeve të reja dhe paqartësive të së ardhmes.
- Pyjet e vjetër përfaqësojnë “*rezervuar gjenetike*”. Kjo i bën ata të paçmueshëm për rigjenerimin e pyjeve në të ardhmen.
- Për shkak të kompleksitetit të strukturës së tyre, ato përmbajnë habitate natyrore dhe specie mjaft të rëndësishme për biodiversitetin, përfshirë specie të rralla e të rrezikuara.
- Sigurojnë vende folezimi, strehimi dhe ushqimi për një numër të madh shpendësh dhe gjitarësh. Kjo për shkak të nivele më të larta të burimeve ushqimore që ato përmbajnë (insekte, larva, bimësi etj). Zakonisht në pyje të tilla është karakteristike shtresa e mbeturinave drunore të cilat përfaqësojnë një mbulesë të pasur tokësore, vend strehimi dhe ushqimi për faunën e egër, por edhe për florën. Trungjet e drurëve të rënë dhe degët e tyre ofrojnë strehim dhe bazë ushqimore për salamandrat, gjitarët e vegjël dhe artropodët (*brumbujt, merimangat, insektet* etj.).
- Në pyjet e vjetër ka më shumë se kudo tjetër lloje të vjeshtullave, myshqeve, likeneve dhe kërpudhave. Kjo prej lëndës organike dhe lagështirës së shtuar në tokë prej prezencës së lëndës organike aty.
- Grabitqarët, kukuvajkat, qukapikët dhe shumë lloje zogjsh janë më të shpeshtë dhe shumë më të pranishëm në pyjet e vjetër.
- Ofrojnë shërbime të paçmueshme në ekosistem (sekuestrimin e karbonit, pastrimin e ajrit dhe të ujit, mbrojtjen e tokës, vlera estetike etj.)
- Habitatet me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri janë të rëndësishëm pasi ofrojnë strehë dhe ushqim për gjitarët më të mëdhenj si; Ariun (*Ursus arctos*), Ujkun (*Canis lupus*), Rrëqebullin (*Lynx lynx ssp. balcanicus*), Derrin e egër (*Sus scrofa*), Dhinë e egër (*Rupicapra rupicapra*), Kaprollin (*Capreolus capreolus*) ose gjitarët me të vegjël si Macja e egër (*Felis silvestris*), Ketri (*Sciurus vulgaris*) etj.

Roli kulturor i pyjeve të vjetra

Shumë fëmijë që rriten sot nuk e kanë idenë se cila do të ishte pamja natyrore e tokës që i rrethonte ata nëse mjedisi do të ishte i pashqetësuar. Çfarë lloj drurësh do të rriteshin? Çfarë kafshësh do të jetonin aty? Kur ne flasim për humbje të resurseve gjenetike, zhdukjen e pyjeve të vjetër, shkatërrimin që i kemi bërë pyjeve dhe se si duhet të korrigojmë kjo situatë, si do t'ja bëjmë nëse nuk ka vende të përshtatshme për t'jua treguar këtë fëmijëve, por të mbeteshim vetëm tek tregimet nëpër libra?

Ekzistojnë përfitime shëndetësore dhe sociale edhe nga pyjet. Ndoshta fakti më i njohur, por më pak i studiuar si atribut i pyjeve të vjetra është bukuria e tyre. Ky element i bukurisë sjell një përzierje gëzimi dhe respekti për të gjithë ata që përrjetojnë një pyll të vjetër. Shumë adhurues të pyjeve dhe natyrës përshkrijnë me qindra kilometra për të pasur një eksperiencë në një pyll të vjetër.

Parqet kombëtare me zonat e tyre natyrore e të virgjëra e nisën historinë e tyre si vende për rekreacion njerëzor dhe qetësi shpirtërore, ndërsa përfitimet ekologjike u vlerësuan më vonë.

Drurët e vjetër shërbejnë gjithashtu edhe si “regjistra” të klimës dhe historive ekologjike të zonave ku ato bëjnë pjesë. Është fakt i njohur tashmë që përmes leximit dhe analizës së rathëve vjetorë të drurëve të vjetër është arritur të rikrijohen modelet e klimës për periudha të ndryshme kohore.



Legjislacioni për pyjet e vjetër

Në Shqipëri politikat dhe programet për ruajtjen dhe menaxhimin e pyjeve të vjetër nuk ekzistojnë. Nuk ka as praktika të mira menaxhuese në këtë drejtim. Në vijim jepem përgjegjësitë institucionale dhe baza kryesore ligjore lidhur me menaxhimin e pyjeve në Shqipëri.

MTM: Sipas ligjit nr. 48/2016, për 'Disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005', "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, Minsitria është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, si dhe miratimin e planeve të menaxhimit për fondin pyjor kombëtar. Është organ i specializuar politikëbërës, me attribute teknike, menaxhuese, kontrolluese e këshillimore. Siguron/ofron mbështetje teknike në fondin pyjor kombëtar.

Bashkitë: Bazuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet" (i ndryshuar), bashkia është institucioni që merret me '*administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorialë administrativë...*'. Pra në të gjitha rastet kur pyjet e vjetër të Ahut nuk janë pjesë e Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura, ato menaxhohen dhe administrohen nga bashkitë. Në rastin konkret; Livadhi i Harushës, (Malësia e Madhe), Curraj i Epërm, (Tropojë), Lumi i Tropojës, (Tropojë) dhe Zall-Gjoçaj (Mat) aktualisht janë nën pronësi dhe menxhim të bashkive përkatëse. Bazuar në legjislacionin aktual, pyjet e vjetër nuk kanë asnjë vlerësim specifik apo mbrojtje ligjore sa i përket rëndësisë së tyre biologjike apo të trashëgimisë natyrore që ato përfaqësojnë. Ato mund të trajtohen si gjithë fondi tjetër pyjor, duke përjashtuar kështu rëndësinë ekologjike dhe vlerat e tjera të tyre.

Bashkitë janë autoriteti rregullues, kontrollues dhe ligj-zbatues në territoret e tyre edhe për ndërtime.

Aktivitetet e tjera në fondin pyjor që menaxhohet nga bashkitë si; shfrytëzimi i pyjeve, gjuetia dhe peshkimi janë gjithashtu nën autoritetin dhe kompetencat e pushtetit vendor.

AKZM: Është institucioni publik qendror që drejton dhe administron veprimtarinë e ruajtjes e të menaxhimit të të gjitha zonave të mbrojtura mjedisore në Republikën e Shqipërisë.

Në rastin e pyjeve të vjetër të Ahut, dy zonat; **Lumi i Gashit** dhe **Rrajca** dhe janë pjesë e Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura;

- **Lumi i Gashit** - Rezervë strikte natyrore/ rezervat shkencor (kategoria I)
- **Rrajca** – Pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë" (kategoria e II).

Disa grumbuj të vegjël me pyje të vjetër Ahu (Ahu i Vranicës në Çerem, Tropojë, Ahishta Gurra e Hasan Gashit në Mërtur) janë shpallur si monumente natyre (kategoria III), duke gëzuar kështu një status mbrojtës.

Ligji 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" fokusohet në rolin mbrojtës dhe mbështet praktikat konservuese në pyje më shumë se sa shfrytëzimin apo prerjen e tyre. Në nenin 46 thuhet që; 'Pyjet në zonat e mbrojtura mjedisore përjashtohen nga klasifikimi si pyje prodhuese...'

Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin 81/2017, AKZM ka për detyrë të kujdeset edhe për detyrimet e ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

ISHMPU. Inspektoriati e bazon veprimtarinë e tij në ligjin Nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektoriati është përgjegjës për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e mjedisit lidhur me kundërvajtjet administrative. ISHMPU siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve dhe ujërave lidhur me dënimin e kundërvajtjeve administrative, ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Mbetet në dorën e administratës së Zonave të Mbrojtura, të Bashkive por edhe OSHC-ve detyrimi për të evidentuar, promovuar dhe propozuar që pyje të tillë të gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore.



Pyjet e vjetër dhe sistemi kombëtar i zonave të mbrojtura

Vetëm dy nga gjashtë zonat me pyje të vjetër Ahu janë pjesë e Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura⁷. Për të patur një vështrim më të qartë lidhur me mbulimin ose jo të pyjeve të vjetër të Ahut brenda Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura shikoni të dhenat në tabelën nr. 2;

Tabela 2. Mbulimi i pyjeve të vjetër të Ahu në SKZM

Zona me pyje të vjetër Ahu	Kategoria e zonës së mbrojtur ⁸	Kategoria
Livadhi i Harushës	Parku Kombëtar ‘Alpet Shqiptare’	II*
Lumi i Gashit	Rezervë strikte natyrore/ rezervat shkencor	I
Lumi i Tropojës	Parku Kombëtar ‘Alpet Shqiptare’	II*
Curraj i Epërm	Parku Natyror Bashkiak ‘Nikaj-Mërtur’	IV*
Zall-Gjoçaj	-	-
Rrajca	Parku kombëtar Shebenik-Jabllanicë	II

*Zonat përfaqësojnë propozime të pa miratuara ende

Vetëm dy zona janë të përfshira aktualisht brenda Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura; Lumi i Gashit (kategoria I) dhe Rrajca (kategoria II). Zonat e tjera janë aktualisht jashtë këtij sistemi. Për tre nga këto zona (Livadhi i Harushës, Lumi i Tropojës dhe Curraj i Epërm) ka propozime konkrete për ti shpallur si zona të mbrojtura. Livadhi i Harushës dhe Lumi i Tropojës janë propozuar (propozim i vitit 2016, i cili nuk është miratuar ende) për tu shpallur si zona qendrore të Parkut Kombëtar “Alpet Shqiptare” (kategoria e II). Kjo në kuadër të hartimit të planit përkatës të menaxhimit i cili përfshinte thujse gjithë rajonin e Alpeve Shqiptare.

Curraj i Epërm është propozuar si zonë qendrore e Parkut Natyror Bashkiak/Parkut Natyror Rajonal (kategoria e IV). Propozimi është bërë në kuadër të hartimit të planit të menaxhimit të Parkut Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur (2014), i cili përfshin të gjithë territorin e njësisë Administrative Lekbibaj (Tropojë). Propozimi nuk është miratuar ende nga MTM.

Më e vështirë paraqitet situata në rastin e Zall-Gjoçajt, zonë për të cilën nuk ka asnjë propozim konkret për ta përfshirë atë në sistemin e zonave të mbrojtura në vend.

Fakti që vetëm dy nga gjashtë zonat kanë një status mbrojtje aktualisht është një thirrje për vlerësimin e situatës së këtyre pyjeve duke i përfshirë ato sa më shpejt në Sistemin kombëtar të zonave të mbrojtura të vendit. Një nevojë emergjente për një vlerësim dhe përfshirje në sistemin e zonave të mbrojtura duhet të ketë për “Zall-Gjoçaj” zonë e cila vazhdon të jetë shumë e ekspozuar ndaj rreziqeve të dëmtimeve.

7 Më parë, Sistemi kombëtar i zonave të mbrojtura njihet si; Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura

8 Ligji 81/2017 për “Zonat e Mbrojtura”

Ahu (*Fagus sylvatica* L.)

Sinonimet; *Ahu i zakonshëm*, *Ahu evropian*. Origjina e fjalës *Fagus* (latinisht) është nga fjala greke “*phegos*”, e cila nënkuptonte “*i ngrënshtëm*” dhe ndonjëherë “*dushk*”.

Ahu është një dru i madh i cili mund të arrijë lartësinë deri në 50 metra dhe deri në 3 m diametër të trungut. Por përmasat më normale janë 25-35 m lartësi dhe deri në 1.5 m diametër trugu. Ahu ka një jetëgjatësi tipike prej 150-200 vitesh edhe pse në raste të rralla mund të jetojë edhe mbi 300 vjet. Disa drurë me moshë 477 vjeçare janë konstatuar në *Izvoarele Nere*⁹ (Rumani) dhe madje edhe me moshë afro 500 vjeçare në *Uholka-Shyrokyi Luh*¹⁰ (Ukrainë).

Ashtu si shumica e drurëve, forma e drurit dhe e kurorës varet nga vendndodhja: në zonat pyjore, Ahu rritet në mbi 30 metra lartësi, me kurorën që vendoset në majën e drurit. Në vende të hapura, lartësia e drurit është shumë më e shkurtër (zakonisht 15-24 m), ndërsa kurora është shumë e madhe dhe fillon që në pjesët e poshtme të trungut.

Gjethet janë të alternuara të thjeshta dhe të kembyera, në formë më shumë eliptike se sa vezake, 5-10 cm të gjatë dhe 3-7 cm të gjerë, me 6-7 çifte nervatura në secilën anë të gjethëve. Sythet janë 15-30 mm të gjatë dhe 4-5 mm të trashë. Është lloj monoik. Lulëzon në fillim të pranverës (Prill-Maj). Frutet (*akene*) ehuj janë trekëndore 15-20 mm të gjatë, dhe 7-10 mm të gjerë në bazë. Prodhimi i luleve dhe farave është veçanërisht i bollshëm në vitet që pasojnë një verë të nxehtë dhe të thatë. Periodiciteti i frutifikimit maksimal varion 5-8 vjet, ndërsa rrallë ndodh për dy vjet rresht. Në 1 kg farë gjenden 4000-6000 fara (mesatarisht 4500). Frutifikon në moshën 40-50 vjeçare kur është si dru i vetmuar (jashtë masivit) dhe 60-80 vjeçare kur është në masiv. Ripërtërihet mjaft mirë me farë dhe më pak me lastarë.

Përhapja natyrore e Ahut është thujse kudo në Evropë dhe varion nga Suedia jugore në Sicilinë veriore, në perëndim të Francës, në Anglinë jugore, në Portugalinë veriore, në Spanjën qendrore, në lindje dhe në veriperëndim të Turqisë, ku ndërthuret me Ahun e lindjes (*Fagus orientalis*). Në Ballkan shfaqen disa hibridizime të Ahut (*F.sylvatica*) me Ahun e lindjes (*F.orientalis*); duke krijuar specie hibride të quajtur *Fagus x taurica*. Në pjesën jugore të zonës së shtrirjes së tij rreth Mesdheut Ahu rritet kryesisht në lartësitë 600-1800 mnd.

Në figurën nr.2 jepet harta me shpërndarjen natyrore të Ahut (*F.sylvatica*) në Evropë (me ngjyrë të gjelbër) dhe ajo e Ahut të lindjes (*F.orientalis*) në ngjyre kafe të çelët.

9 <http://true-romania.tours/romanian-beech-forests-included-unesco-world-heritage-list/>

10 https://en.wikipedia.org/wiki/Uholka-Shyrokyi_Luh_primeval_beech_forest



Figura 2. Harta e shtrirjes së Ahut (*F. sylvatica*) në Evropë

Burimi: Caudullo, G., Welk, E., San-Miguel-Ayanz, J., 2017. Chorological maps for the main European Woody species. Data in Brief 12, 662-666. DOI: 10.1016/j.dib.2017.05.007. <https://doi.org/10.6084/m9.figshare.5101144>

Sistemi rrënjor është i cekët, madje sipërfaqësor, me rrënjë të mëdha që shtrihen në të gjitha drejtimet. Rrënjët e Ahut formojnë ecto-mikoriza¹¹ në të cilët zhvillohen disa lloje kërpudhash të rëndësishme për rritjen e drurit dhe marrjen e ujit e lëndëve ushqyese nga toka si; *Amanita*, *Boletus*, *Cantharellus* etj.

Pesha e drurit të thatë vlerësohet në rreth 700-750 kg/m³.

Informacioni në vijim¹² jep disa të dhëna mbi lartësinë që drurët e Ahut kanë arritur në vende të ndryshme të Evropës;

1. 54 m, Rumani
2. 49 m, Francë, Foret de Lyons
3. 49 m, Gjermani
4. 48.5 m, Hollandë. Middachten, De Steeg (2006)
5. 47.3 m, Amelisweerd, Utrecht (2003)
6. 46 m, Republika Çeke
7. 45.65 m, Pyjet Sonian, Belgjikë (2011)
8. 44.2 m, Lugina Kirnitsch, P.K. Sachsische Schweiz, Gjermani (2010)
9. 43 m, Heilige Hallen, Gjermani (*JPh* 2010)
10. 43 m, Hof te Dieren, Holandë

¹¹ Lidhje simbiotike ndërmjet rrënjëve dhe kërpudhave

¹² <http://www.bomeninfo.nl/tall%20trees.htm>

Sipas prof.Vasil Markut (Dendrologjia, 2013) kërkesat optimale të faktorëve ekologjike për Ahun paraqiten në figurën nr.3;

Figura 3. Kërkesat optimale të Ahut ndaj faktorëve ekologjikë

Temperatura mesatare vjetore	6-9 °C
Reshjet mesatare vjetore	1900-2500 mm
Zgjatja e stinës së vegjetacionit	5 muaj
Lagështia atmosferike në verë	70-80%
Lartësia mbi nivelin e detit	1000-1400 m
Kundrejtimi	VP, VL
Shkalla e ngopjes së tokës me baza	Mbi 70%
Reaksioni i tokës (pH uhor)	5.8-6.5
Tipi i humusit	I butë
Thellësia e tokës	Mbi 80 cm
Ngjeshmëria e tokës	E shkrifët
Përbërja mekanike	Subargjilore e mesme (SAM)

Sipas listës së habitateve¹³ të Natura 2000, Ahu evropian (*F. sylvatica* L.) paraqitet i klasifikuar në nëntë habitate kryesore;

Tabela 3. Lista e habitateve të Ahut (*F.sylvatica*) sipas Natura 2000


Kodi	Emertimi i habitatit
91K0	Illyrian <i>Fagus sylvatica</i> forests (<i>Aremonio-Fagion</i>)
9110	<i>Luzulo-Fagetum</i> beech forests
91W0	Moesian beech forests
9130	<i>Asperulo-Fagetum</i> beech forests
9140	Medio-European subalpine beech woods with <i>Acer</i> and <i>Rumex arifolius</i>
9150	Medio-European limestone beech forests of the <i>Cephalanthero-Fagion</i>
91V0	Dacian Beech forests (<i>Symphyto-Fagion</i>)
91X0 *	Dobrogean Beech forests
9270	Hellenic beech forests with <i>Abies borisii-regis</i>

13 http://ec.europa.eu/environment/nature/legislation/habitatsdirective/docs/2007_07_im.pdf


Pyjet e Ahut në Shqipëri

Ahu perfaqeson llojin më të rëndësishëm pyjor në Shqipëri sa i përket kontributit të tij në sipërfaqen dhe volumin e fondit pyjor kombëtar. Sipas të dhënave kadastrale të vitit 2017, pyjet me Ah kanë një sipërfaqe prej rreth 171 mijë hektarë (rreth 17% të sipërfaqes pyjore të vendit). Por më së shumti Ahu vlerësohet prej volumit që ai siguron si lloj, i cili arrin rreth 20.4 milion m³ (40% të fondit pyjor të vendit), me një volum mesatar prej 119 m³/ha.

Grafikët në vijim japin të dhëna për sipërfaqen dhe volumin e pyjeve të Ahut në Shqipëri;



Grafiku 2. Sipërfaqja e pyjeve të Ahut sipas rretheve



Grafiku 3. Volumi i pyjeve të Ahut, sipas rretheve

Rrethet me sipërfaqen dhe volumin më të madh të pyjeve të Ahut në Shqipëri janë; Librazhdi, Tropoja, Malësia e madhe, Bulqiza, Tirana, Shkodra, Puka, Pogradeci dhe Mati.

Evidentimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri

Përzgjedhja e grumbujve më kryesorë me pyje të vjetër Ahu, u bazuata në disa kriterë kryesorë;

- a. Moshë e grumbujve pyjorë (mbi 120 vjeç)
- b. Një sipërfaqe minimale ≥ 150 ha
- c. Topografia dhe homogeniteti i zonës (zonë e organizuar në formën e një lugine, shpati, pllaje etj. duke shfaqur një grumbull pyjor të pa fragmentuar)
- d. Mungesa e ndikimit njerëzor mbi zhvillimin e ekosistemit pyjor (grumbuj ku ndikimi njerëzor nuk ka ekzistuar në dinamikën e zhvillimit të pyllit).
- e. Mundësia për të garantuar menaxhimin dhe mbrojtjen e këtyre grumbujve pyjorë në kushtet ku ata ndodhen sot, të pa shqetësuar nga njeriu.

Bazuar në kriteret e mesipërme rezultoi se zonat me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri janë:

1. Livadhi i Harushës (Malësia e Madhe)
2. Lumi i Gashit (Tropojë)
3. Curraj i Epërm (Tropojë)
4. Lumi i Tropojës (Tropojë)
5. Zall-Gjoçaj (Mat)
6. Rrajcë (Përrenjas)

Këto zona paraqiten në figurën nr. 4, në vijim. Përveç këtyre zonave pyjore, ka edhe disa "njolla" të vogla me pyje të vjetër Ahu të shpërndara në vend si; Ahu i Vranicës (Çerem-Tropojë), Lugu i Ndërmajës (Tropojë), Mali i Dajtit (shpati perëndimor), pjesa Lindore e Malit me Gropa (Klos), Stebleva etj. Gjithsesi këto njolla të vogla me pyje të vjetër Ahu kanë një sipërfaqe të kufizuar dhe ka shumë gjasa që të mos i mbijetojnë presionit njerëzor, përjashtuar rastet kur ato gëzojnë status mbrojtës. Nga këto 'njolla' pyjore masivi lindor i Malit me Gropa (masivi malor mbi fshatrat Guri i Bardhë dhe Murrize) ka nevojë për hulumtime të metejshme edhe prej pranisë së karsteve dhe peizazhit unik që ofron ajo zonë.

Katër nga gjashtë zonat e propozuara (Livadhi i Harushës, Lumi i Gashit, Curraj i Epërm dhe Lumi i Tropojës) gjenden në rajonin e Alpeve Shqiptare duke përbërë kështu edhe rajonin jugor të Alpeve Dinarike. Ndërsa Zall-Gjoçaj shtrihet në Zonën Malore Qendrore dhe Rrajca në rajonin Lindor të Vëndit.

Katër zona (Livadhi i Harushës, Lumi i Gashit, Lumi i Tropojës dhe Rrajca) janë zona që vendosen në kufinj të shtetërore të vëndit.




Figura 4. Zonat me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri

Zonat janë pasqyruar në këtë botim të hartografuara, ndarë në dy nën zona;

- Zona qendrore – përfaqëson ekosistemet me Pyje të vjetër Ahu
- Zona buferike – përfaqëson ekosisteme të tjera të cilat bashkëshoqërojnë ato të pyjeve të Ahut, kryesisht brezi i kullotave Alpine. Janë quajtur zona buferike me qëllim që për çdo aktivitet menaxhues apo të përdorimit të territorit, këto zona të shërbejnë si zbutëse të ndikimeve apo presioneve mbi pyjet e vjetër të Ahut.

Në hartë, zonat e propozuara janë paraqitur si njësi uniforme gjeografike (lugina), ku pjesa buferike përfaqëson kurorën që rrethon zonat me pyje të vjetër Ahu. Është quajtur zonë buferike edhe për arsyen se në realitet ofron një farë mbrojtje për pyjet e vjetër të Ahut si nga pikpamja e territorit ashtu dhe ajo e aktiviteteve socio-ekonomike që zhvillojnë aty komunitetet vendore.

Dy zonat me pyje të vjetër Ahu; “Lumi i Gashit” dhe “Rrajca” - pjesë e UNESCO-s, duhet të jenë motivimi për ti mbrojtur dhe shmangur çdo ndikim njerëzor në të gjithë pyjet e kësaj kategorie, me qëllim ruajtjen e thesareve të fundit me pyje të vjetër e të virgjër të Shqipërisë.

Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri

Grumbujt me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri përfaqësojnë sipërfaqe unike, thuajse natyrore dhe deri tani pa ndikime të rëndësishme nga njeriu. Ato janë evidentuar të jenë në 6 zona të ndryshme të vendit me sipërfaqe dhe karakteristika të ndryshme nga njëra-tjetra.

Në tabelën nr.4 në vijim jepen zonat me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri dhe sipërfaqet respektive të zonave qendrore dhe buferike të tyre;

Tabela 4. Zonat me pyje të vjetër Ahu dhe sipërfaqet e tyre


Nr	Emri i zonës	Zonë qendrore, ha	Zonë buferike, ha	Totali, ha
1	Livadhi i Arushës	1058.5	1381.3	2439.8
2	Lumi i Gashit	5228.8	4123.4	9352.15
3	Lumi i Tropojës	1243.6	2973.8	4217.5
4	Curraj i Epërm	1644.1	895.8	2539.9
5	Zall Gjoçaj	792.2	1652.9	2445.1
6	Rrajca	1730.0	1025.4	2755.4
	Shuma	11697.3	12052.5	23749.8

Sipërfaqja e zonave me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri, vlerësohet në 11,697.3 ha. Kjo shifër përbën vetëm 1.1% të sipërfaqes së fondit pyjor të vendit.

Sipërfaqja e zonave buferike, përreth pyjeve të vjetër të Ahut vlerësohet në 12,052.5 ha. Edhe kjo është një zonë mjaft e rëndësishme për mbrojtjen e ekosistemeve të pyjeve të vjetër të Ahut por edhe zbutjen e ndikimeve në këto pyje.


Sipërfaqja totale e zonave ku gjenden pyjet e vjetër të Ahut (zonat qendrore dhe buferike) vlerësohet në 23,749.8 ha.

Tabela e mesipërme paraqitet e ilustruar grafikisht në grafikët në vijim;



Grafiku 4. Sipërfaqja e zonave qendrore dhe buferike e pyjeve të vjetër të Ahut


Nisur nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave të evidentuara rezultojnë se Lumi i Gashit (Tropojë) dhe Lumi i Tropojës (Tropojë) kanë sipërfaqen më të madhe.



Grafiku 5. Sipërfaqja me pyje të vjetër të Ahut (% që zë secila zonë ndaj totalit)

Të renditura sipas madhësisë së zonës qendrore (zona me pyje të vjetër Ahu) rezultojnë se masivet më të mëdha me pyje të vjetër Ahu janë; Lumi i Gashit (45%), Rrajca (15%) dhe Curraj i Epërm (14%). Ndërkohë që sipërfaqja më e vogël me pyje të vjetër Ahu është Zall-Gjoçaj me 7% të sipërfaqes me pyje të vjetër Ahu.

Nisur nga sipërfaqja e përgjithshme përqindja që zë çdo grumbull pyjor jepet në grafikun në vijim;



Grafiku 6. Ekosistemet me pyje të vjetër Ahu, zonat qendrore+bufenike (% ndaj totalit)

Nga grafiku i mesipërm, shihet se Lumi i Gashit përbën ekosistemin më të madh me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri (me 39% të sipërfaqes së përgjithshme), ndërsa Zall-Gjoçaj atë më të voglin, me vetëm 10% të sipërfaqes.

Për dy nga zonat; Lumi i Gashit dhe Curraj i Epërm ka të dhëna për moshën e disa drurëve të analizuar në zonë. Një grup me studentë nga Fakulteti i Pyjeve dhe Shkencave të Drurit (Universiteti i Çek i Shkencave të Jetës), Departamenti i Ekologjisë Pyjore të drejtuar nga pedagogët Martin Mikoláš dhe Ondrej Kameniar (2016), realizoi disa matje dendrometrike dhe vlerësime në këto dy zona, lidhur edhe me moshën e drurëve pyjore. Të dhënat e atyre matjeve jepen në tabelën nr.5 në vijim;

Tabela 5. Të dhëna për moshën e disa drurëve në Lumin e Gashit dhe Curraj i Epërm

Zona	Drurë të analizuar	Moshë, sipas klasave të moshës (çdo 50 vjet)				
		Σ >250	251-300	301-350	351-400	401-450
Lumi i Gashit	35	9	4	-	3	2
Curraj i Epërm	32	8	4	4	-	-

Këto janë edhe të dhënat më të fundit lidhur me moshën e dy prej grumbujve pyjorë në fjalë. Gjithsesi, ka nevojë urgjente për të bërë më shumë matje dhe vlerësime dendrokronologjike në të gjitha zonat me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri.

Habitatet kryesore ku shrihen pyjet e vjetër të Ahut

Dy habitatet më kryesore të pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri janë;

- **91K0 Pyje lirieke me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion)** të cilët paraqiten si vazhdim i atyre lirieke, të cilët shtrihen në **masivet malore Dinarike (Livadhi i Harushës, Lumi i Gashit, Lumi i Tropojës dhe Curraj i Epërm)**
- **91W0 Pyje Ahu Moesianë** shtrihen në pjesën qendrore dhe jug-lindore **të vendit**. Kanë karakteristikat e pyjeve të Evropës qendrore, ndaj pyjet e Ahut të këtyre zonave do të rekomandohej përfshirja e tyre nën këtë kod/habitat. Gjithsesi, duhen ende shumë eksplorime dhe vëzhgime fushore për të pasur një vlerësim më të saktë në këtë drejtim.

Nga ana tjetër duke qenë se masivet me pyje të vjetër Ahu janë të kufizuara në sipërfaqe, një propozim tjetër lidhur me përfshirjen në habitatet e Natura 2000, do të ishte **përfshirja e tyre nën kodet 9130 (Pyje Ahu të karakterizuara nga shoqërimi *Asperulo-Fagetum*) dhe 9110 (Pyje Ahu të karakterizuara nga shoqërimi *Luzulo-Fagetum*)**. Siç u theksua më sipër do të duhen shumë studime të mirëfillta fitocoenologjike në këtë drejtim për të pasur një vlerësim më të saktë.

Përveç habitateve më kryesore të pyjeve të Ahut, janë edhe disa habitate të tjera bashkëshoqëruese, apo që vendosen në brezat mbi dhe nën pyjet e Ahut. Një listë e përgjithshme e këtyre habitateve jepet në figurën nr. 5 në vijim;

Figura 5. Habitatet kryesore ku shtrihen pyjet e vjetër të Ahut

Kodi	Emërtimi i tipit të habitatit	Zonat me pyje të vjetër Ahu					
		Livadhi i Harushës	Lumi i Gashit	Lumi i Tropojës	Curraj i Epërm	Zall-Gjoçaj	Rrajcë
91K0	<i>Pyje ilirike me Fagus sylvatica (Aremonio-Fagion).</i>	+	+	+	+		
91W0	<i>Pyje ahu Moesianë</i>					+	+
6110 *	<i>Kullota shkëmbore gëlqerore ose bazofilike të aleancës Alysso-Sedion albi</i>	+					
6170	<i>Kullota alpine dhe subalpine në vende shkëmbore gëlqeore</i>	+					
6520	<i>Livadhe të larta malore</i>	+				+	+
3220	<i>Lumenjtë alpinë dhe bimësia barishtore përgjatë brigjeve të tyre</i>		+				
4060	<i>Shqopishte alpine dhe të borealit</i>		+	+	+	+	+
6230 *	<i>Kullota me prani të lartë të N. stricta në substrate silicore të zonave malore</i>		+	+			
8210	<i>Shpate shkëmbore gëlqerore me vegetacion hasmofitik</i>		+	+	+		
91L0	<i>Pyje ilirikë me dushk dhe shkozë (Erythronio-Carpinion)</i>		+				
91M0	<i>Pyje gjetherënës Ballkano-Panonikë me dushqe</i>		+				
9180 *	<i>Pyje të aleancës Tilio-Acerion të shpateve shkëmbore dhe luginave të thata</i>		+				
91BA	<i>Pyje Moesianë me Bredh</i>		+				
95A0	<i>Pyje pishash të larta të zonave malore të Mesdheut</i>		+	+	+	+	
3240	<i>Lumenj alpine dhe bimësia e tyre drunore me Salix elaeagnos</i>			+	+		
6520	<i>Livadhe malore të lartësive</i>			+			
9150	<i>Pyje ahu Medio-Europiane mbi gëlqerorë të aleancës Cephalanthero-Fagion</i>				+		
92A0	<i>Galeri apo breza pyjore me Salix alba dhe Populus alba</i>						+
7110 *	<i>Mocalishte me ngritje aktive</i>		+	+			+

Lista e habitateve të paraqitura në tabelë nuk është përfundimtare dhe as shteruese. Kjo pasi ka më shumë nevojë për vëzhgime të detajuara fitosociologjike, fitogjeografike dhe fitocoenologjike në këtë drejtim.

Një përshkrim më i detajuar i habitateve jepet në përshkrimet e grumbujve përkatës në kapitujt në vijim.

Toka

Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri kanë një shtrije të gjerë, nga veriu drejt jug-lindjes. Kjo e diktuar edhe prej kushteve klimatike dhe kërkesave specifike që kanë pyjet e Ahut ndaj tyre. **Tokat e murrme pyjore.** Të gjitha masivet me pyje të vjetër Ahu shtrihen në tokat e murrme pyjore. Formimi i tokave të murrme pyjore është bërë në kushtet e një lagështire mjaft të madhe (mbi 1500 mm/vit), periudhe të vogël thatësire, temperaturave të ulëta, mbulesë e pasur bimore me pyje Ahu dhe pjerresisë së madhe të shpateve. Thellësia e horizontit humusor varion nga 25-60 cm, janë të pasura me humus (9-15%) e azot. Këto toka janë të ndara në tre nën-tipe; toka të murrme pyjore të zakonshme, të murrme pyjore mbi shkëmbinj gëlqerorë, dhe toka të murrme pyjore mbi shkëmbinj ultrabazikë. Më të përhapura nga këto tre nëntipe janë ato të murrme pyjore të zakonshme dhe tokat e murrme pyjore mbi gëlqerorë, të cilat gjenden tek të gjithë grumbujt me pyje të vjetër Ahu. Përqindja e humusit në këto nëntipe zbret nga 15% në horizontet e sipërme (0-3 cm) në 0.5% në thellësinë mbi 100 cm. Ndërsa aciditeti (pH) i tyre varion nga 6 afër sipërfaqes në 5 në thellësinë 100 cm. Tokat kanë përbërje mekanike nga subargjilore e mesme në subargjilore të rëndë, ndërsa struktura e tyre paraqitet në granilore kokrrizore. Këto toka gjenden në të gjitha masivet me pyje të vjetër Ahu. Më pak të përhapura janë tokat e nën-tipit të murrme pyjore mbi shkëmbinj ultrabazikë, të cilët gjenden në Zall-Gjoçaj dhe Rrajcë. Për shkak të përmbajtjes së lartë të magnezit, cilësitë e këtyre tokave janë më të dobëta se ato të nëntipeve tjera.

Tokat primitive. Përfaqësohen prej tokave zallshtore dhe gurore. Konsistojnë në depozitime të trasha zhavorri, të përziera me gurë, mbi të cilën vendoset shtresa vegjetative me pyje Ahu. Toka të tilla takohen në pjesën e poshtme të luginës si në livadhin e Harushës dhe në livadhin e Zallit.

Kilma

Livadhi i Harushës, Curraj i Epërm, Lumi i Gashit dhe Lumi i Tropojës shtrihen në Alpet Shqiptare. Klima aty është mesdhetare malore, me dimër të ashpër e të lagësht, periudhë të gjatë me ngrica, reshje të pasura shiu e bore dhe verë të freskët dhe relativisht e lagësht.

Temperaturat e ajrit. Mesataret vjetore luhaten nga 7 °C në Vermosh, 10 °C në Curraj; dhe në Valbonë 10.7 °C. Mesatarja e muajit Janar luhetet nga 2.8 °C në Curraj, deri në -2.6 °C në Vermosh. Temperaturat mesatare të muajit Korrik luhaten nga 16 °C në Vermosh, në 20.4 °C në Valbonë.

Reshjet. Alpet janë krahina më e lagësht e Shqipërisë. Në Alpe bien çdo vit rreth 2,000-3,000 mm reshje, ku dallohet në veçanti Curraj i Epërm me 2,763 mm. Regjimi i reshjeve është mesdhetar. Thujse 70% e sasisë së përgjithshme vjetore e reshjeve bien gjatë gjysmës së ftohtë të vitit. Në dimër bien 36% e sasisë vjetore të reshjeve, në vjeshtë 31%, pranverë 22% dhe në verë vetëm 11%. Gjatë dimrit reshjet bien kryesisht në trajtë bore.

Zall-Gjoçaj; Klima e zonës është Mesdhetare malore (nënzona Mesdhetare-malore-lindore).

Temperatura mesatare vjetore varion nga 7-10 °C. Minimalet absolute luhaten ndërmjet -10 deri -15 °C (më rrallë në -18 deri -20 °C. Numri i ditëve me temperatura ≤ 0 °C është 120-150 ditë/vit. Sasia vjetore e reshjeve varion 1300-1800 mm/vit. Numri i ditëve me dëborë varion 60-80 ditë/vit. Rreth 70% e reshjeve bien në gjysmën e ftohtë të vitit (Tetor-Mars).

Rrajca; Zona e Rrajcës përfaqëson një luginë të vogël dhe të ngushtë, ku shtrirja e saj në drejtimin veri-jug e izolon atë në një masë të konsiderueshme nga klima mesdhetare. Për këtë arsye lugina gjendet kryesisht nën ndikimin e klimës kontinentale, me dimra të ftohtë dhe reshje relativisht të shumta shiu. Temperatura mesatare vjetore është 13.4 °C, ndërsa sasia vjetore e reshjeve (mesatare) vlerësohet të jetë rreth 1,360 mm/vit.

Biodiversiteti ne Pyjet e Vjetër të Ahut në Shqipëri

Fauna

Pyjet e vjetër të Ahut strehojnë një numër të madh llojesh të florës dhe faunës, duke u bërë kështu zona mjaft të ndjeshme dhe njëkohësisht të rëndësishme mjedisore. Këto pyje përfaqësojnë vende strehimi dhe ushqimi për një numër të madh speciejsh të rrezikuara, pjesë e listës së kuqe të IUCN dhe asaj të Shqipërisë. Pyjet e vjetër të Ahut janë të vetmet zona në vendin tonë ku takohen të tre llojet e mishngrënësve të mëdhenj: **Ariu** (*Ursus arctos*), **Ujku** (*Canis lupus*) dhe **Rrëqebulli** (*Lynx lynx ssp. balcanicus*) dhe të tre llojet e thundrakëve të mëdhenj: **Dhia e egër** (*Rupicapra rupicapra*), **Derri egër** (*Sus scrofa*) dhe **Kaprolli** (*Capreolus capreolus*). Në këto pyje gjenden **10 gjitarë, 13 shpendë, 3 amfibë, 12 insekte dhe 1 molusk**. Kjo i bën këto pyje si zona “hot spots” të biodiversitetit të vendit dhe me rëndësi kritike për të. Nga këto 6 lloje kanë statusin **CR** (i rrezikuar në mënyrë kritike), 2 lloje me status **DD** (të dhëna të pa mjaftueshme), 6 lloje me status **EN** (i rrezikuar), 9 lloje me status **LR** (Rrezik i ulët) **NT** – gati i rrezikuar, **LC** – me pak i rrezikuar, 16 lloje me statusin **VU** (i përkeqësuar);

Figura 6. Gjitarët në pyjet e vjetër të Ahut

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	Zonat me pyje të vjetër Ahu						Statusi i species
	Gjitarët		L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	
1	<i>Ursus arctos</i>	Ariu i murmë	+	+	+	+	+	+	VU(D1)
2	<i>Canis lupus</i>	Ujku	+	+	+	+	+	+	LC(nt)
3	<i>Lynx lynx balcanicus</i>	Rrëqebulli	+	+	+	+	+	+	CR(C2a)
4	<i>Felis silvestris</i>	Macja e egër	+	+	+	+	+	+	EN(C2a)
5	<i>Mustela putorius</i>	Qelbësi	+	+	+	+	+	+	EN(D1)
6	<i>Meles meles</i>	Baldosa	+	+	+	+	+	+	LR(lc)
7	<i>Sus scrofa</i>	Derri i egër	+	+	+	+	+	+	LR(nt)
8	<i>Rupicapra rupicapra</i>	Dhia e egër	+	+	+	+	+	+	VU
9	<i>Capreolus capreolus</i>	Kaprolli	+	+	+	+	+	+	VU(A1b)
10	<i>Lutra lutra</i>	Lundërza						+	LR(nt)

Figura 7. Shpendët në pyjet e vjetër të Ahut

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	Zonat me pyje të vjetër Ahu						Statusi i species
			Shpendët						
			L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	
1	<i>Acipiter gentilis</i>	Gjeraqina	+	+	+	+	+	+	VU
2	<i>Acipiter nisus</i>	Gjeraqina e shkurtës	+	+	+	+	+	+	EN
3	<i>Buteo buteo</i>	Huta	+	+	+	+	+	+	VU
4	<i>Aquila chrysaetos</i>	Shqiponja e malit	+	+	+	+	+	+	EN
5	<i>Falco tinnunculus</i>	Skifteri kthetrazi	+	+	+	+	+	+	VU
6	<i>Bonasa bonasia</i>	Pula me cafke	+		+	+			CR
7	<i>Tetrao urogallus</i>	Gjeli egër	+		+		+		CR
8	<i>Bubo bubo</i>	Bufi	+		+	+	+		CR
9	<i>Picus viridis</i>	Qukapiku i gjlbër	+		+	+	+	+	LC(1c)
10	<i>Dryocopus maritus</i>	Qukapiku i zi	+		+	+	+	+	LC(1c)
11	<i>Dendrocopus leucotos</i>	Qukapiku kurrizbardhe	+	+	+	+	+	+	LC(1c)
12	<i>Prmella collaris</i>	Dredhuesi i alpeve	+	+	+	+	+	+	DD
13	<i>Loxia curvirosta</i>	Sqepkryqi	+		+		+	+	DD

Figura 8. Amfibët në pyjet e vjetër të Ahut

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	Zonat me pyje të vjetër Ahu						Statusi i species
			Amfibët						
			L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	
1	<i>Rana balcanica</i>	Bretkosa ballkanike e ujit			+		+	+	LR(1c)
2	<i>Salamandra atra</i>	Salamandra e zezë		+	+	+			LR(nt)
3	<i>Bufo bufo</i>	Thithlopa			+	+	+	+	LC

Figura 9. Insektet dhe molusqet në pyjet e vjetër të Ahut

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	Zonat me pyje të vjetër Ahu						Statusi i species
			Insektet						
			L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	
1	<i>Libelloides longicornis</i>	Nu r o p t e r i arushës	+						VU(A1b)
2	<i>Carcharodus flocciferus</i>	Flociferja	+	+	+	+			VU(A1b)
3	<i>Parnassius apollo</i>	Apollonja	+	+					CR
4	<i>Parnassius mnemosyne</i>	Mnemosinja	+	+					VU
5	<i>Thecla betulae</i>	Bishtakja mështeknës	+						VU(A1b)
6	<i>Maculinea arion</i>	Kaltëroshja njollazezë		+					EN
7	<i>Coenonympha tullia</i>	Tulia		+					VU(A1b)
8	<i>Erebia aethiops</i>	Zijoshja etops		+					VU(A1b)
9	<i>Erebia medusa</i>	Ziojshja e pyllit		+					VU(A1b)

10	<i>Neohipparchia statilinus</i>	Statilinia		+					VU(A1b)
11	<i>Melitaea cinxia</i>	Cinksia	+		+				VU(A1b)
12	<i>Rosalia alpina</i>	Rosalia			+	+	+	+	CR
Molusqet									
1	<i>Helix secernenda</i>	Kërmilli	+	+	+	+	+	+	VU(A1c)

Flora

Edhe flora paraqitet mjaft e larmishme dhe me shumë lloje që janë pjesë e listës së kuqe të IUCN dhe asaj të vendit tonë. Në këtë mënyrë pyjet e vjetër të Ahut bëhen banesa më e rëndësishme e këtyre llojeve që janë të rrezikuara tashmë. Në vijim paraqitet lista e florës dhe faunës që gjendet në pyjet e vjetër si dhe statusi përkatës i çdo specie. Rreth 81 lloje me status të rrezikuar gjenden në këto pyje, nga të cilat 16 lloje janë me statusin **CR** (të rrezikuar në mënyrë kritike), 3 lloje janë me statusin **DD** (nuk ka të dhëna të plota për speciet), 24 lloje kanë statusin **EN** (të rrezikuara), 19 lloje kanë statusin **LR** (rrezik i ulët), 1 lloj me status **NE** (takson i pa vlerësuar), 18 lloje kanë statusin **VU** (i përkeqësuar);

Figura 10. Flora në pyjet e vjetër të Ahut

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	Statusi
1	<i>Achillea frasio</i>	Barpezmi i Frazit	+						CR(B3c)
2	<i>Aconitum lamarckii</i>	Akonit i Lamarkit	+						CR(B1)
3	<i>Alanna scardica</i>	Allkene e Sharrit	+						LR(cd)
4	<i>Alyssum bertoloni</i>	Serice e Bertolonit						+	LR(cd)
5	<i>Aquilegia vulgaris</i>	Kanilqyqe e rëndomtë	+						CR(A1b)
6	<i>Arabis bryoides</i>	Arabëz myshknjgashëm		+					CR(A1b)
7	<i>Arabis scopoliana</i>	Arabëz i Skopolit	+						CR(A1b)
8	<i>Arctostaphylos uva-ursi</i>	Rrush ariu	+	+					LR(cd)
9	<i>Arenaria gracilis</i>	Arenare e hajthshme	+						CR(A1b)
10	<i>Aster albanicus</i>	Asteri shqiptar						+	En (A1b)
11	<i>Athamanta turbith</i>	Atamente turbith				+	+		EN(A1b)
12	<i>Atropa belladonna</i>	Helmarina	+		+	+			CR(B2c)
13	<i>Aubrieta columnae</i>	Aubriete shtyllake	+						CR(A1b)
14	<i>Barbarea vulgaris</i>	Barbare e rëndomtë	+		+				VU(A1b)
15	<i>Berberis vulgaris</i>	Mëlqinjë					+		CR(C2a)
16	<i>Betula pendula</i>	Mështekna	+	+	+				CR(B2e)
17	<i>Bornumllera baldaccii</i>	Bornmulerë e Baldaçit						+	EN(A1b)
18	<i>Botrycium lunaria</i>	Sefir	+				+		En (A1b)
19	<i>Caltha palustris</i>	Lëpushtër	+				+	+	VU

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	Statusi
20	<i>Campanula albanica</i>	Lulekëmbane shqiptare				+			En (A1b)
21	<i>Cerastium dinaricum</i>	Cerast dinarik	+						VU(D2)
22	<i>Chamaecytisus tommasinii</i>	Kamecitzë e Tomazinit	+						EN(B2c)
23	<i>Cholcicum autumnale</i>	Xhërokull					+		LC
24	<i>Cistus albanicus</i>	Luleguri shqiptare						+	EN(B2C)
25	<i>Convallaria majalis</i>	Lot zoje	+						CR(B2c)
26	<i>Corylus columna</i>	Lajthia e egër			+				En (A1b)
27	<i>Crepis albanica</i>	Shmangë shqiptare				+			VU(A2b)
28	<i>Dianthus degenii</i>	Karafil i Degenit	+						En (A1b)
29	<i>Dianthus stribrhii</i>	Karafili i Stribernit	+						DD
30	<i>Digitalis lantana</i>	Lule togëz					+	+	LC
31	<i>Dryopteris filix-mass</i>	Fiermaskull	+	+			+	+	LC
32	<i>Edraianthus serpyllifolius</i>	Edraiant gjethelisre					+		LC
33	<i>Fraxinus excelsior</i>	Frashëri i zi		+					EN(A1b)
34	<i>Fritillaria messnensis</i>	Fritilare mesinezë		+					CR(A1b)
35	<i>Genista hassertiana</i>	Gjineshtër e Hasertit					+	+	NE
36	<i>Gentiana dinarica</i>	Genciane Dinarike	+		+	+			DD
37	<i>Gentiana lutea</i>	Bar zemre						+	EN(A1b)
38	<i>Geum heterocarpum</i>	Melake fryndryshme		+					VU(A1b)
39	<i>Haplophyllum boissierianum</i>	Haplofil i Buasierit						+	EN(A1b)
40	<i>Hutchinsia alpina</i>	Hutcinë alpine	+						EN(A1b)
41	<i>Hypericum perforatum</i>	Lulebasani	+	+	+	+	+	+	EN(A1b)
42	<i>Juniperus communis</i>	Dëllinja e zezë	+		+	+	+	+	VU(A1b)
43	<i>Juniperus foetidissima</i>	Bërsheni					+		EN(A1b)
44	<i>Juniperus oxycedus</i>	Dëllinjë e kuqe					+	+	VU(A1b)
45	<i>Ligusticum albanicum</i>	Vratik i Shqipërisë	+						CR(A1c)
46	<i>Lilium albanicum</i>	Zambak shqiptar						+	EN(A1b)
47	<i>Lunaria telekiana</i>	Lunare e Telekit		+	+	+			CR(B2c)
48	<i>Malcolmia illyrica</i>	Malkolmë ilirike					+		LC
49	<i>Minuartia bosniaca</i>	Alsinë boshnjake	+						LC
50	<i>Nartheicum scardicum</i>	Nartece e Sharrit						+	VU(A1b)
51	<i>Orchis albanica</i>	Salep shqiptar						+	EN(A1b)
52	<i>Orchis laxiflora</i>	Salepi					+		LC
53	<i>Orchis provincialis</i>	Salep krahinor					+		LC

Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri

Nr	Emertimi shkencor	Emri shqip	L.Harushës	C.Epërm	L.Gashit	L.Tropojës	Z.Gjoçaj	Rrajca	Statusi
54	<i>Origanum vulgare</i>	Rigoni i kuq	+	+			+	+	EN(A1b)
55	<i>Paeonia mascula</i>	Bozhurë mashkull		+					LC
56	<i>Pedicularis brachydonta</i>	Pedikulare dhembeshkurtër		+					LC
57	<i>Petasites doerfleri</i>	Llapua i Derflerit		+					EN(A1b)
58	<i>Phyllitis scolopendrium</i>	Tjegullore		+					VU(A1b)
59	<i>Picea abies</i>	Hormoq	+		+				CR(A1b)
60	<i>Pinus peuce</i>	Arneni			+		+	+	En (A1b)
61	<i>Pinus sylvestris</i>	Hartina			+				CR(A1b)
62	<i>Plantago reinformis</i>	Gjethedelli si veshkë		+					LC
63	<i>Polygonum albanicum</i>	Nejcë shqiptare			+				EN(A1a)
64	<i>Ramonda serbica</i>	Ramondë e Serbisë	+				+	+	VU(A1b)
65	<i>Salix aurita</i>	Shelgu veshëzor				+			VU(A1b)
66	<i>Salix hastana</i>	Shelgu heshtak			+				En (A1b)
67	<i>Sambucus racemosa</i>	Shtogu i kuq	+						VU(A1b)
68	<i>Satureja montana</i>	Trumëza					+	+	VU(A1c)
69	<i>Saxifraga scadrice</i>	Iriqëz e Sharrit	+						VU(A1b)
70	<i>Scrophphularia bosniaca</i>	Sarushë boshnjake	+	+					LC
71	<i>Sedum erythraeum</i>	Rrushqyqe e kuqe	+						DD
72	<i>Senecio thapsoides</i>	Pulith flom-ngjashëm	+	+					LC
73	<i>Silene schëarzenbergeri</i>	Klokëz e Sfarçenbergerit					+		VU(A1b)
74	<i>Silene tomasinii</i>	Klokëz e Tomazinit					+		En (A1b)
75	<i>Taxus baccata</i>	Tisi	+				+	+	LC
76	<i>Thlaspi bellidofolium</i>	Tlasp lulebukur				+			EN(A1b)
77	<i>Ulmus glabra</i>	Hidhës			+	+			VU(A1c)
78	<i>Vaccinium uliginosum</i>	Boronjë qeni			+	+			VU(A1c)
79	<i>Valeriana officinalis</i>	Haraqinë mjekësore	+						VU(A1c)
80	<i>Vincetoxicum hutëri</i>	Qenmbytëse e Huterit						+	LC
81	<i>Viola dukadjinica</i>	Manushaqe e Dukagjinit		+				+	LC

CR – i rrezikuar në mënyrë kritike, **EN** – i rrezikuar, **VU** – i përkeqësuar, **NT** – gati i rrezikuar, **LR**- Rrezik i ulët, **LC** – më pak i rrezikuar, **DD**-të dhëna të pa mjaftueshme, **NE**- takson i pa vlerësuar

Në këtë mënyrë grumbujt me pyje të vjetër Ahu përfaqësojnë zona me interes të veçantë për biodiversitetin e vendit, ndaj duhen hulumtime me të detajuara në secilën prej tyre në vijim.

Aktivitetet kryesore që mund të zhvillohen

Nuk rekomandohen shumë aktivitete në pyjet e vjetër te Ahut. Kjo për të mos sjellë shqetësime humane në këto zona të cilat do të përbënin rrezik për ekosistemet natyrore. Një arsye tjetër për të mos zhvilluar shumë aktivitete është edhe statusi ligjor i mbrojtjes që kanë aktualisht disa nga këto zona (Lumi i Gashit¹⁴ dhe Rrajca¹⁵). Përgjithësisht lista e aktiviteteve të propozuara dhe që mund të zhvillohen në pyjet e vjetër të Ahut janë të lejuara.

Për më tepër zonat kanë nevojë për eksplorime dhe hulumtime të metejshme, ndaj vizitat, ekspeditat dhe kërkimi shkencor duhet lejuar. Nga ana tjetër zonat kanë nevojë edhe për promovimin e tyre. Aktivitetet të cilat janë miqësore me mjedisin duhen lejuar por të kontrolluara në mënyrë strikte nga stafet e AKZM. Një listë me aktivitetet e propozuara jepen në figurën 11 në vijim;

Figura 11. Aktivitetet që mund të zhvillohen në pyjet e vjetër të Ahut

Aktivitetet	Zonat me pyje të vjetër Ahu					
	Livadhi i Harushës	Lumi i Gashit	Lumi i Tropojës	Curraj i Epërm	Zall-Gjoçaj	Rrajcë
Ecje në natyrë	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*
Kamping	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*

14 Ligji 81/2017, neni 15/2; Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I) – zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, pasi në të janë të ndaluara të gjitha aktivitetet njerëzore që mund ta dëmtojnë dhe ku objektivat kryesorë janë:

- Ruajtja e biodiversitetit të zonës duhet të jetë e arritshme nëpërmjet mbrojtjes dhe të mos kërkojë menaxhim aktiv ose manipulim të habitateve;
- Të minimizohen çrregullimet dhe shqetësimet nëpërmjet planifikimit të kujdesshëm të realizimit të kërkimit shkencor dhe të aktiviteteve të tjera të miratuara;
- Të kufizohen kontaktet e publikut me zonën dhe të përjashtohet përdorimi i saj për pushim e çlodhje;
- Të lejohet prania e vizitorëve pa mjete të motorizuara në atë nivel që ti shërbejë sa më mirë mirëqenies fizike dhe shpirtërore të tyre dhe të ruhet cilësia e natyrës së egër të zonës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

15 Ligji 81/2017, neni 16/2; Parku kombëtar (kategoria II) - Në "Parkun kombëtar" zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektivi të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

- Përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive;
- Nuk lejohet shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
- Janë të ndaluara ndërtimi i zonave urbane, i autostradave, hekurudhave, linjave të prodhimit të energjisë, si hidrocentrale, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë;
- Nuk lejohet ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- Çdo aktivitet që bie ndesh me objektivat e mbrojtjes së zonës dhe që përcaktohen në planin e menaxhimit.

<i>Alpinizëm</i>	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*	-
<i>Ecje me kalë</i>	+/*	+/*	+/*	-	+/*	+/*
<i>Rafting</i>	-	+/*	+/*	-	-	+/*
<i>Vrojtim zogjsh</i>	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*	+/*
<i>Edukimi</i>	+	+	+	+	+	+
<i>Kërkim shkencor</i>	+	+	+	+	+	+
<i>Eksplorim shpellash</i>	+	-	-	+	-	-
<i>Peshkim me grep</i>	-	+/*	+/*	-	-	+/*
<i>Ski</i>	+/*	+/*	+/*	+/*	-	+/*

* aktiviteti është sezonal

Të gjitha zonat e Ahut ofrojnë një gamë të madhe aktiviteteve me bazë natyrën. Aktivitete të tilla si; ecje në natyrë, kamping, alpinizëm, acje me kalë, rafting, vrojtim zogjsh, edukim, kërkim shkencor, eksplorim shpellash, peshkim me grep, ski etj. synojnë të promovojnë zonën, duke i bërë ato pika kryesore ku natyralistët mund të gjejnë veten e tyre përmes aktiviteteve atje. Këto pyje ofrojnë gjithashtu mundësi unike për edukim. Vetëm pak aktivitete (peshkimi, ski, eksplorimimi shpellave dhe rafting) nuk mund të zhvillohen në të gjitha zonat.



Zonat me Pyje të Vjetër Ahu në Shqipëri


Livadhi i Harushës

Skeda e zonës





Qarku	Shkodër
Bashkia/Nj.Ad.	Malësia e Madhe/Kelmend
Ekonomia pyjore	Livadhi i Harushës
Fshati	Vermosh
Emri popullor i zonës	Livadhi i Harushës
Autoriteti menaxhues	Bashkia Malësia e Madhe
Vendndodhja gjeografike	Veriu = 42°37'43.32" dhe Lindja = 19°44'7.91"
Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> - Sipërfaqja ku dominojnë pyje të vjetër Ahu = 1058.5 ha - Zona buferike = 1381.3 ha - Sipërfaqja totale = 2439.8 ha
Akset rrugore për të aksesuar zonën	Në Vermosh mund të shkohet nga; Tirana, Shkodra, Podgorica, Prishtina (Kosovë), Plava (Mali i Zi), Andrijevica (Mali i Zi)
Aksesi në rrugë këmbësore	Vermosh (Bashkim)-Livadhi i Harushës = 10 km, ose 3 orë. Vermoshi (Velipoja) -Livadhi i Harushës = 15 km, ose 6.5 orë. Kuti (Mali i Zi)- Livadhi i Harushës = 3.5 km, ose 1 orë)
Vlerat kryesore të zonës	<ul style="list-style-type: none"> - 36 lloje të florës dhe 28 lloje të faunës (pjesë e listës së Kuqë të IUCN dhe Shqipërisë). - Pyjet e vjetër me Ah, Rrobull, Bredh i bardhë dhe Hormoq. - Peizazhi unik i zonës. Tradita kulturore unike. - 2 monumente natyre (kategoria e III) - 25 maja malesh me lartësi mbi 2000 mnd
Rreziqet kryesore	Zjarret, prerja e pyjeve, kullotja, gjuetia, mbetjet, erozioni
Statusi aktual i mbrojtjes	Zona ka pjesërisht status mbrojtës; Lugu Akullnajor i Seferçes është Monument i Natyrës (kategoria e III)
Zonë potenciale për:	<ul style="list-style-type: none"> o UNESCO, o Wilderness Europe, o Park Kombëtar*, o Rrejtji Kombëtar i Pyjeve të Vjetër



*Në vitin 2016 është propozuar si zonë qendrore e Parkut Kombëtar "Alpet Shqiptare" (Kategoria e II), por që nuk është miratuar akoma

HARTA GJEOLGJIKE LIVADHI I HARUSHES SHKALLA 1 : 50 000



Shpjeguesi

-  Pleistocen - Holocen. depozitime të përziera aluviale - proluviale. rëra, zhavore, alevrite
-  Triasik i Mesëm. Rreshpe, gëlqerorë
-  Triasik i Poshtëm - i Mesëm. Rreshpe, gëlqerorë, gëlqerorë amonitikë
-  Triasik i Sipërm. Gëlqerorë me megalodonte, gëlqeror stromatolitikë, dolomite



0 1 2 4
Kilometers

0 20 40 60 80
Kilometers

LIVADHI I ARUSHES

Drawn By: ELSON SALIBAJ
Checked By: ABDULLA DUKI
Date: 04-04-2018

1:20,000
Sheet No. 1

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
Projection: Transverse Mercator
Datum: EDINBURGH
False Easting: 500 000 000
False Northing: 0 000 000
Scale Factor: 0.9996
Units: Meter

Legend/Legjenda
Livadhi i Arushes
Zona/ Zona

Core zone/ Zone genditore
Buffer zone/ Zone bujqesore

PSEDA - ILIRIA

"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"



Përshkrimi i zonës

Livadhi i Harushës (Arushës) shtrihet në skajin më verior të Shqipërisë. Kufiri verior dhe ai lindor i zonës përbën njëkohësisht edhe kufirin shtetëror me Malin e Zi. Përfaqëson një luginë të vogël akullnajore me shtrirje nga veri-perëndimi drejt jug-lindjes, pothuajse paralel me luginën e Vermoshit.

Në distancë ajrore gjendet rreth 6 km në veri-lindje të fshatit Vermosh. Fshati më i afërt me këtë luginë është Kuti (Mali i Zi) i cili gjendet rreth 5 km larg nga qendra e luginës (Livadhi i Harushës). Lugina ka formën e germës “V”, me gjerësinë maksimale të saj në pjesën e sipërme (veri) dhe që vjen duke u ngushtuar në fundin e saj, drejt jugut. Lugina e ka marrë emrin nga një prej dy livadheve që gjenden në fundin e saj; ‘Livadhi i Harushës’.



Nga pikëpamja e natyralitetit lugina përfaqëson një zonë pyjore thuajse të pashqetësuar nga njeriu, kryesisht për shkak të pamundësisë për ta aksesuar. Grumbulli pyjor dominohet nga Ahu, i cili paraqitet në formën e një pylli shumëmosharë, me kurorëndendësi të plotë dhe lartësi të ndryshme drurësh. Ka prezencë edhe të llojeve të tjera si Rrobulli, Hormoqi, Bredhi i bardhë, panjat, ndërsa më poshtë gjenden; Shkoza, Mëlleza, Frashëri etj.



Nëpër pyje ka shumë drurë të thatë, të rrëzuar dhe të kalbur (Ahu, Bredhi, Rrobulli etj.). Në disa sipërfaqe të luginës vërehen gjurmë të zjarreve të rëna vite më parë. Gjithashtu vërehen dhe çeltira pyjore të shkaktuara nga zjarret.

Sipërfaqia e mbuluar me Ah përreth Livadhit të Arushës shtrihet në të dy anët e përroit të Seferçes. Sipërfaqet e anës së majtë të rrjedhës së përroit përbëhen nga drurë Ahu, kurse ato të anës së djathtë të rrjedhës në lartësitë 50-60 m mbi nivelin e përroit

përveç drurëve të Ahut gjenden në sasi të vogla edhe drurë të tjerë si; *Acer pseudoplatanus*, *Betula pendula*, *Populus tremula*, *Salix caprea*, *Sorbus aucuparia*, *Cotoneaster tomentosa*, *Rhamnus alpinus* etj.

Habitati kryesor në Livadhin e Arushës, sipas Natura 2000, është ai me kod **91KO Pyje Ilirike me Ah (*Fagus sylvatica*)**. Këto pyje sintaksonomikisht bëjnë pjesë në klasën *Querco-Fagetea*; rendi *Fagetalia sylvaticae*, aleancat *Fagus sylvatica-Rhamnus alpinus*, *Luzulo-Fagion*.

Sipas botimit “Pyjet e Virgjër të Shqipërisë”, sipërfaqja pyjore e luginës rezulton me 954 ha, me një volum lënde drusore prej 273,000 m³, ose një volum mesatar prej 286 m³/ha.

Lartësia e luginës varion nga 1090 mnd në pjesën e poshtme të saj, deri në 2,174m në pjesën e sipërme të saj, në majën e Zhihovës.

Lugina e përroit të Harushës, është formuar si rezlutat i një thyerje tektonike. Fundi i saj ka karakter të shkallëzuar, me pragje tektonike, kurse shpatet janë asimetrike. Tiparet e morfologjisë akullnajore ajo i ruan nga burimi deri në Seferçe. Mbulesa bimore është e pasur dhe përfaqësohet nga kati i Ahut, ku rritet edhe Rrobulli (*Pinus heldreichii*) si dhe bimësia e kullotave alpine. Ndikimi i ekspozicionit ka bërë që kati i Ahut në shpatin jugor të ngrihet deri në 1700-1800 m lartësi, kurse në shpatin verior deri në 1500-1600 m. Kullotat alpine këtu janë nga më të pasurat e Alpeve, ku midis tyre përmenden kullotat e Seferçes, të Smutigorës, lugut të Dolit, Perbies etj.

Majat më të larta janë të vendosura në pjesën veriore dhe atë lindore të luginës. Disa nga këto maja janë ato të; Marules (2186.8 m), Mojanit (2168 m), Çardakut (2094 m), Lugu i Dolit 2173.2 m), Zhihovës (2174 m) dhe Domdekes (2098 m).

Në pjesën e poshtme të luginës, deri në lartësinë 1600-1700 mnd shtrihen tokat e murrme pyjore. Klima karakterizohet nga sasi e madhe reshjesh vjetore (shpesh herë mbi 2000 mm/vit), periudhë e vogël thatësire dhe temperatura të ulëta. Kjo bën që të ketë




një mbulesë të pasur bimore, ndërkohë që pjerrësia e shpateve varion nga 20-40°. Mbi lartësinë 1600-1700m vendosen tokat livadhore malore (brezi i kullotave alpine) ku dominon bimësia barishtore e kullotave alipne. Këto toka kanë përqindje të lartë të lëndës organike (humus) në rreth 25-30% të tyre, duke ju dhënë atyre tipare të ngjyrës së zezë. Në këto lartësi, në pjesën veriore të luginës janë të vendosura Bjeshkët e Seferçes. Ndërsa në pjesën perëndimore të luginës ndodhen bjeshkët e Kershit të Djegur.

Pjesa e poshtme e luginës vjen e sheshtë, dhe tokat aty janë gurishtore-zallishtore (toka primitive), të krijuara prej depozitimesh të trasha zhavorri (rrallë prej rëre të trashë), vende-vende të përziera me gurë të mëdhenj. Kjo vihet re më shumë në livadhin e Zallit dhe të Harushës.

Pjesa e sipërme e luginës – Seferçja, është shpallur monument natyre.

Në kuadër të propozimit (2016) për shpalljen e Alpeve Shqiptare si Park Kombëtar (kategoria e II), Livadhi i Harushës është propozuar si Zonë Qendrore e Parkut Kombëtar, duke gëzuar kështu statusin e një zone Strikte të Mbrojtur. Propozimi akoma nuk është miratuar nga MTM.



Gjeologjia dhe hidrogeologjia

Zona e Livazhit të Harushës nga pikpamja gjeologjike ndërtohet nga shkëmbinjtë terigjeno-karbonatikë, gëlqerorë dhe dolomite. Këto lloje shkëmbore janë të lidhura me moshën *Triasike*. Shkëmbinjtë me moshë më të re në këtë zonë janë depozitimet në terracat e vjetra lumore të cilat kanë përhapje të kufizuar dhe trashësi të vogël.

Shkëmbinjtë e *Triasikut të poshtëm*-të mesëm takohen në disa sektorë të veçuar në perëndim, në lindje dhe në veri të zonës (Seferçe). Këto shkëmbinj përfaqësohen nga reshpe argjilore dhe gëlqerorë. Shkëmbinjtë rrethues kanë kufij normal dhe tektonike. Trashësia e tyre varion nga 250-350 m.

Shkëmbinjtë e *Triasikut të mesëm* janë të përfaqësuara nga reshpe argjilo-ranore, gëlqerorë pllakore e dolomite. Ato kanë përhapjen më të gjerë në zonën e Livadhit të Harushës, thuhet në të gjithë anët e saj, nga qendra deri në veri dhe deri në Trojan, duke u shtrirë nga perëndimi deri në lindje, sipas kurrizores në veri të Vermoshit. Këto shkëmbinj kontaktojnë me shkëmbinjtë rrethues në forma të ndryshme: me kontakt normal, tektonik dhe mbihypës. Trashësia e tyre shkon deri në 500 m.

Shkëmbinjtë e *Triasikut të sipërm*, në këtë zonë takohen në një sektor shumë të vogël e të veçuar në veri të saj. Ato përfaqësohen nga gëlqerorë dhe dolomite. Kontaktet e tyre me shkëmbinjtë rrethues janë normale me formacionet kufizuese. Kanë shtrirje perëndim-lindje dhe rënie veriore. Trashësia e këtyre shkëmbinjve shkon deri në 750 m.

Historia e zhvillimit gjeologjik të zonës së Livadhit të Harushës është e lidhur me një pjesë të periudhës *Triasike*, nga 285-245 milion vite më parë, kur filluan të depozitohen në detin e asaj kohe terigjene e kryesisht sedimente karbonatike. Pas kësaj periudhe zona i është

nënshtruar veprimtarisë rrudhosëse e shkëputëse gjatë dy fazave tektogjenezash, që së bashku me veprimtarinë e faktorëve të jashtëm gjatë periudhës *Kuaternare*, 2 milion vite më parë e sot, i kanë dhënë relievit të saj një karakter klasik alpin me lugina të thella e maja të larta (mbi 2000m), duke e modeluar atë në pamjen që ka sot.

Hidrografia

Ujërat e luginës së Livadhit të Harushës derdhen fillimisht në lumin Lim (Mali i Zi) i cili nga ana e tij derdhet në Danub dhe më pas përfundojnë në Detin e zi.

Lugina e livadhit të Harushës ka pak burime ujore. Zona ka disa përrenj të vegjël të cilët në verë thuhet se thahen plotësisht si ato të Smutigorës, Seferçes, Mojanit, të cilët mbildhen dhe sëbashku formojnë përroit e Nakutit. Burimet më të rëndësishme ujore në luginë janë; burimi i Seferçes, burimi i Berovës dhe Gurra e Bishtrave.



Në luginën e Livadhit të Harushës drenojnë 4 burime me ujëra nëntokësore me prurje 0.3-20 l/s. Këto burime janë të lidhura me porozitetin çarje-karst të formuar nga tretja e shkëmbinjve gëlqerorë. Burimi me prurje më të madhe në këtë zonë është “Burimi i Livadhit të Harushës” me prurje 20 l/s.

Ujërat e burimeve kanë cilësi të mirë. Karakteristikë e tyre është se dalin në kuota të relativisht të larta 1300-1800 mnd, kanë temperatura të ulta që luhaten nga 3 në 5 °C, fortësi të përgjithshme me vlera nga 5 në 8 dH dhe mineralizim të përgjithshëm që luhatet nga 150 në 250 mg/l.

Habitatet kryesore në zonë

Habitati më kryesor në livadhin e Harushës është; 91K0 Pyje Ilirike me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion). Ky tip habitati përfshin pyje gjethegjërë acidofilikë ose pyje të përzier në pjesën e sipërme të tij me halorë, në të cilët Ahu është dominues. Habitati shtrihet vertikalisht nga 1090 m në pikën më të ulët të tij (afër kufirit malazez) deri në lartësitë 1600-1700 m. Mbi këto lartësi, Ahu zëvendësohet nga drurët e Rrobullit (*Pinus heldreichii*) dhe Bredhit të bardhë (*Abies alba*) të cilët më së shumti vendosen në anën e djathtë të rrjedhës së përroit si dhe në pjesët e sipërme të tij. Duhet theksuar që gjatë verës dhe vjeshtës së parë, përroi

përshkues i habitatit është thuajse i thatë, për shkak të sasisë së pakët të ujit dhe humbjes nga natyra e lartë karstike e terrenit. Përgjithësisht habitatit i mësipërm përfshin edhe shoqërimet bimore *Asperulo-Fagetum* dhe *Fagus sylvatica-Rhamnus alpinus*.

Në habitatin 91K0 - *Pyje liri* me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion) gjenden edhe këto specie treguese: *Acer pseudoplatanus*, *Cotoneaster tomentosa*, *Betula pendula*, *Populus tremula*, *Sorbus aucuparia*, *Salix caprea*, *Rubus ideaus*, *Sorbus graeca*, *Tilia tomentosa*, Drurët dhe llojet e tjera të këtij habitatit si; *Rhamnus alpinus*, *Lonicera alpigena*, *Sambucus racemosa*, *Viburnum* spp., si dhe *Vaccinium myrtillus*, bashkë me katin barishtor të tij (*Agrimonia eupatoria*, *Asperula odoratum*, *Allium ursinum*, *Brachypodium pinnatum*, *Brachypodium sylvaticum*, *Calamintha grandiflora*, *Campanula albanica*, *Dentaria eneaphyllos*, *Fragaria vesca*, *Hepatica triloba*, *Luzula luzuloides*, *L. sylvatica*, *Prenanthes purpurea*, *Oxalis acetosella*, *Poa nemoralis*, *Primula vulgaris*, *Solidago virg-aurea* etj.), që e bëjnë atë mjaft të rëndësishëm jo vetëm për larminë e llojeve bimore por edhe për botën e pasur shtazore që habitatit strehon.

Habitatit me Ah si dhe dy livadhet (Zallit dhe Harushës) të krijuara nga depozitimet aluvionale të përroit, janë strehë e një faune të pasur me krimba të rumbullakët; *Aporrectodea smaragdina*, *Lumbricus rubellus*; Fluturat si *Papilio machaon*, *Parnassius mnemosyne*, *Pieris brassicae*, *Plebejus argyrognomon*, *Pontia edusa*, *Pyronia tithonus*, *Leptidea sinapis*, *Satyrus ferula*, *Vanessa cardui*, *Argynnis paphia*, *Brenthis hecate*, *Melitaea didyma*, etj.

Habitatit me Ah është i rëndësishëm për gjitarët e mëdhenj si Ariu (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra balcanica*) dhe Kaprollin (*Capreolus capreolus*).





Habitate të tjera të rëndësishme që rrethojnë Pyjet Ilirike me Ah në Livadhin e Arushës dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në pasurinë biologjike të tij janë ato me kode: 6110 * Kullota shkëmbore gëlqerore ose bazofilike të aleancës Alysso-Sedion albi; 6170 Kullota alpine dhe subalpine në vende shkëmbore gëlqerore dhe ndër më të rëndësishmit në mes të pyllit të Ahut është habitat me kod 6520 ose *Livadhe të larta malore*, i cili shquhet për llojet barishtore si *Trisetum flavescens*, *Aconitum lamarckii*, *Astrantia major*, *Crepis mollis*, *Anthoxanthum odoratum*, *Crocus*



albiflorus, *Geranium phaeum*, *G. sylvaticum*, *Heracleum sphondylium*, *Malva moschata*, *Valeriana repens*, *Muscari botryoides*, *Phyteuma pseudorbiculare*, *Polygonum bistorta*, *Primula elatior*, *Viola calcarata* subsp. *zoysii* etj.

Vlerat kryesore të zonës

Vlerat kryesore të zonës së Livadhit të Harushës janë;

- **Masivi me pyje të vjetër Ahu.** Është një ndër masivet më të mira me pyje të vjetër Ahu që gjenden sot në Shqipëri. Aktualisht pyjet e Ahut janë thuajse të pa ndikuara nga njeriu dhe paraqiten në gjendjen e tyre natyrore. Ka shumë drurë të vjetër të tharë, të rrëzuar dhe të kalbur nëpër pyll. Në pjesë të ndryshme të sipërfaqes pyjore të zonës janë gjendur drurë të vjetër Ahu apo Bredhi me përmasa mbi normalen, si psh në koordinatat; V=42°36.847' dhe L=19°44.984', në lartësinë 1097 m perimetri i drurit është rreth 360 cm; V=42°36.846' dhe L=19° 44.948' në lartësinë 1098 m perimetri i drurit është rreth 410 cm; V=42° 37.144' dhe L=19° 44.596' në lartësinë 1120m perimetri i drurit është 380 cm; V=42°37.159' dhe L=19°44.577' në lartësinë 1125m perimetri i drurit është 494 cm etj. Në shumë raste lartësia e drurëve i kalon 30-35 m. Numri i drurëve të tharë dhe/apo kalbur vlerësohet nga 7-12 drurë/ha.
- **Prania e llojeve** të rëndësishme pyjore si; Rrobulli, Bredhi i bardhë, Hormoqi, Mështekna etj. shtojnë diversitetin e llove në zonë dhe vlerat natyrore të saj.
- **Peizazhi unik** i zonës, i cili mund të shihet më mirë nëse viziton majat që rrethojnë luginën. Një mënyrë tjetër për të përjetuar peizazhin është të vendosesh në dy livadhet e saj në pjesën e poshtme të luginës; Livadhin e Harushës ose të Zallit. Lugina rrethohet nga 25 maja malesh me lartësi mbi 2000 mnd.
- **Biodiversiteti.** Livadhi i Harushës është një zonë e pasur me lloje të rralla e të rrezikuara (lloje të listës së Kuqe të Shqipërisë dhe IUCN) me rreth 64 lloje.

Fauna: Në zonë gjenden 8 gjitarë të mëdhenj, 13 shpendë, 1 amfib, 12 insekte dhe 1 molusk. Zona strehon të gjithë gjitarët e mëdhenj që gjenden në Shqipëri; Ariu, Ujku, Rrëqebulli, Macja e egër, Derri i egër, Dhia e egër, Kaprolli etj.



Flora: në zonë gjenden rreth 36 drurë, shkurre dhe bimë endemike. Në këtë pikpamje zona përfaqëson një “hot-spot” të biodiversitetit të një rëndësie të madhe dhe me vlerë kombëtare dhe ndërkombëtare.

- **Lugu akullnajor i Seferçes.** Është monument natyre (kategoria e III). Përbën një lug të madh akullnajor të varur, të formuar në gëlqerorë mesosoikë përgjatë një shkëputjeje tektonike. Ka formën e një korite të përzgjatur rreth 1800-2000 m dhe gjerësi 400 m.
- **Kanioni i Bashkimit, Vermosh.** Ndodhet në fund të fshatit Vermosh, në lartësinë 900-950 mnd. Përfaqëson një grykë lumore shumë të ngushtë (kanion), i formuar nga gërryerja e ujërave të lumit të Vermoshit. Mund të ketë rol edhe procesi i karstit, pasi kanioni është formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë. Ka gjatësi 1000-1100 m, gjerësi 4-6 m, mure vertikale me lartësi 30-40 m. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik.
- **Traditat kulturore** të zonës së Vermoshit. Zona shquhet për traditat e mikpritjes, kuzhinën, arkitekturën tradicionale, veshjet popullore, si dhe ritet dhe zakonet e zonës të cilat janë unike dhe përbëjnë një aset të çmuar krahas vlerave të natyrës.

Rëndësia e zonës: Mbulesa pyjore me Ah në këtë habitat përbën një grumbull unik sa i përket natyralitetit dhe gjendjes së stadiit *klimaks* të pyllit. E gjithë lugina përfaqëson një zonë tërësisht natyrore me pyje të vjetër Ahu, Bredhi, Rrobulli, Hormoqi etj. Pyjet e zonës përbëjnë një strehë të rëndësishme për shumë specie të florës, midis të cilave dallohen speciet e mbrojtura nga direktiva e habitateve si *Buxbaumia viridis*, *Gentiana lutea* dhe *Galanthus nivalis*. Në zonë strehohen të gjithë gjitarët e mëdhenj që gjenden në Shqipëri, përfshirë edhe Rrëqebullin e Ballkanit (*Lynx lynx ssp. balcanicus*), një specie e rrezikuar sipas IUCN-së.

Udhërrëfyes për në zonë

Për të vizituar zonën duhet vajtur më parë në fshatin Vermosh. Vermoshi është fshati më i afërt shqiptar me luginën e Livadhit të Harushës. Ndaj të referencat për të vizituar zonën duhet të bazohen tek ky fshat. Ka disa mënyra për ta vizituar zonën, sipas akseve rrugore të treguara në tabelën nr. Në vijim;

Tabela 6. Akset rrugore për në Livadhin e Harushës

Aksi rrugor	Distanca, km	Gjendja e rrugës	Koha për ta përshkuar, orë
Tiranë-Shkodër-Hani i Hotit-Tamarë-Vermosh	200	Asfalt	3-3.5
Podgoricë-Dinosa-Grabom-Tamarë-Vermosh*	60	Asfalt	1
Podgoricë -Tuz-Hani i Hotit-Tamarë-Vermosh*	80	Asfalt	1.5
Rruga Plavë-Guci-Vermosh*	35	Asfalt	0.45
Andrijevicë-Kuti***	20	Asfalt	0.30
Prishtinë-Pejë-Rozhajë-Berane-Plavë-Guci-Vermosh***	220	Asfalt	5

* Rruga kalon nëpër kufirin shtetëror Shqipëri-Mali i Zi,
 ** Rruga kalon e gjitha nëpër territorin e Malit të Zi dhe distanca për të aksesuar Livadhin e Harushës është 5 km, por nuk ka pikë kalimi kufitar
 *** Rruga kalon nëpër territorin e Kosovës dhe Malit të Zi

Siç u theksua më sipër, në zonën e Livadhit të Harushës nuk ka rrugë makine. Ndaj e vetmja mënyrë për të shkuar aty është janë rrugët këmbësore nga fshati Vermosh. Aksesit i zonës në rrugë këmbësore bëhet nga tre drejtime kryesore;

- i. Duke ndjekur rrugën këmbësore Bashkim (pjesa e poshtme e fshatit Vermosh, e vendosur në afërsi të pikës kufitare me Malin e Zi)-Qafa e Lipovicës-Livadhi i Harushës. Rruga është e gjatë rreth 10 km dhe mund të përshkohet për 3 orë. Kjo përfaqëson edhe rrugën më të lehtë për të aksesuar Livadhin e Harushës. Ngjitja vertikale që duhet bërë është rreth 550 m. Rruga është e shënuar me shenjat përkatëse, e cila ndihmon vizitorët për tu orientuar përgjatë saj. Përgjatë rrugës gjenden 3 burime ujore. Në segmentin e fundit të saj (në afërsi të Livadhit të Harushës) rruga përshkon përroin e Livadhit të Harushës i cili ka ujë gjatë gjithë periudhës së vitit.
- ii. Duke ndjekur rrugën këmbësore nga Velipoja (pjesa e sipërme e fshatit Vermosh) – Varri i Memit-Qafa e Mojanit (2050 m)-Seferçe-Livadhi i Harushës. Rruga ka një gjatësi prej rreth 15 km, dhe duhen 6-7 orë për ta përshkuar. Duke përdorur këtë mundësi, vizitori duhet të bëjë një ngjitje vertikale prej rreth 1000 m (Vermoshi 1060 m deri në qafën e Mojanit 2050 m). Rruga ka disa burime ujore, pjesa kryesore e të cilëve është në dy anët e qafës së Mojanit. Kjo është një rrugë mjaft panoramike, duke qenë se kalon nëpër terrene të çveshura dhe në lartësi të madhe.
- iii. Nga fshati Kuti (Mali i zi) duke ecur përgjatë luginës deri në Livadhin e Harushës. Ka një distancë rreth 3.5 km dhe mund të përshkohet për rreth 1 orë. Ky është edhe varianti më i lehtë nga të gjithë variantet e mësipërme pasi ngjitja vertikale është vetëm 200 metra. Problemi qëndron se nëse ndiqet kjo rrugë nuk ka pikë të kalimit kufitar.




Figura 12. Drejtimit kryesore për në Livadhin e Harushës

Në Livadhin e Harushës gjendet një stan, i pajisur me disa enë të thjeshta dhe një sobë, i cili ofron pak mundësi gatimi dhe mbrojtje nga shiu apo bora. Në stan mund të strehohen deri në 10 veta (me pajisjet e tyre personale). Në afërsi të livadhit të Harushës ka burime ujore të cilat mbajnë ujë edhe në periudhën e thatë të vitit.


Lumi i Gashit

Skeda e zonës








Qarku	Kukës
Bashkia/Nj.Ad.	Tropojë/Tropojë
Ekonomia pyjore	Lumi i Gashit
Fshati	Begaj + fshatrat e tjerë të Nj.Ad. Tropojë
Emri popullor i zonës	Lumi i Gashit, Luma e Gashit
Autoriteti menaxhues	Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
Vendndodhja gjeografike	Veriu = 42°29'53.71 dhe Lindja = 20° 2'56.58"
Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> - Sipërfaqja ku dominojnë pyje të vjetër Ahu = 5228.8 ha - Zonë buferike = 4123.4 ha - Sipërfaqja totale = 9352.15 ha
Akset rrugore për të aksesuar zonën	Deri në afërsi (Sylbica, Çeremi, Begaj) zona mund të aksesohet nga; B.Curri, Tirana, Kukësi, Prishtina etj.
Aksesi në rrugë këmbësore	Zona aksesohet nga; Sylbica (5 km, 1 orë në këmbë). Nga fshati Çerem (14 km, 3.5 orë në këmbë), Begaj (12 km, 4 orë në këmbë)
Vlerat kryesore të zonës	<ul style="list-style-type: none"> - Pyjet e vjetër me Ah, Bredh të bardhë, Arnen, Rrobull dhe Hartinë. - Liqenet akullnajore të Dobërdolit (monument Natyre). - 43 lloje të rrezikuara të florës (15) dhe të faunës (28). - 50 maja me lartësi mbi 2000 mnd.
Rreziqet kryesore	Zjarret, ndërtimet, HEC-et, prerja e drurëve, gjuetia, mbetjet
Statusi aktual i mbrojtjes	<ul style="list-style-type: none"> o Zonë e trashëgimisë Natyrore Botërore të UNESCO o Rezervë Strikte Natyrore (kategoria I)
Zonë potenciale për:	<ul style="list-style-type: none"> o Wilderness Europe, o Park Kombëtar*, o Rrejtë Kombëtar i Pyjeve të Vjetër



*Në vitin 2015 është propozuar si zonë qendrore e Parkut Kombëtar "Alpet Shqiptare" (Kategoria e II), ende e pa miratuar

HARTA GJEOLOGJIKE LUMI I GASHIT SHKALLA 1 : 50 000



Shpjeguesi

-  Pleistocen - Holocen. depozitime të përziera aluviale - proluviale. rëra, zhavore, alevrite
-  Maastriktian. Ndërthurje flishoidale, argjilo - ranore - gëlqerore
-  Jurasik i pandarë. Gëlqeror pllakorë me silicorë, gëlqeror nyjor me amonite, gëlqeror me bivalvorë palajjikë, radiolarite silicore
-  Triasik i Sipërm. Gëlqerorë me megalodonte, gëlqeror stromatolitikë, dolomite
-  Triasik i Poshtëm - i Mesëm. Rreshpe, gëlqerorë, gëlqerorë amonitikë
-  Paleozoik i Sipërm. Formacioni vullkano - sedimentar, bazalte, andezite, dacite, rreshpe gëlqerore të mermerizuar.
-  Jurasik i Mesëm - i Sipërm. Granite kontinentale (granite, granodiorite, granosionite), trahite, trahiliparite



Lumë i Gashit
 Drawn By: ELSON HALIMAJ
 Checked By: ABULLA DMU
 Date: 05-04-2018

1:40,000
 Sheet No. 1

Coordinate System: UTM
 Projection: UTM
 Zone Number: 34N
 False Easting: 500,000
 False Northing: 0
 Zone Factor: 0.9996
 Datum: ED50
 Units: Meter

Legend/Legjenda
Lumë i Gashit
 Zonat
 Core zone
 Buffer zone
 Multi zone



"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"

Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri





Përshkrimi i zonës

Lumi i Gashit është i njohur në Shqipëri, si një ndër zonat me natyrën më të bukur dhe të pashqetësuar. Bën pjesë në Njësinë Administrative Tropojë, bashkia Tropojë. Shtrihet në pjesën lindore të Alpeve Shqiptare duke u kufizuar në veri me Malin e Zi dhe në veri-lindje me Kosovën.

Lumi i Gashit është shpallur si zonë e mbrojtur ‘Rezervë Strikte Natyrore’ (kategoria I) me VKM nr.102, datë 15.01.1996, me sipërfaqe 3,000 ha. Sa i përket mbrojtjes ligjore, zona ka nivelin më të lartë të mbrojtjes, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Që nga viti 2017, Lumi i Gashit është gjithashtu pjesë e rrjetit të Trashëgimisë Botërore të UNESCO, me një sipërfaqe të pyjeve të vjetër të Ahut prej 1,261.52 ha dhe zona buferike rreth këtyre pyjeve me një sipërfaqe prej 8,977.48 ha.

Lugina përfaqëson një shtrirje gjatësore veri-jug me gjatësi rreth 27 km, deri në bashkimin e saj me luginën e Valbonës poshtë fshatit Shoshan.

Në botimin “Pyjet e Virgjër të Shqipërisë”, Lumi i Gashit figuron me një sipërfaqe pyjore prej 3000 ha, dhe një volum lëndë drunore prej 756,000 m³, me volum mesatar prej 252 m³/ha.

Shoqërimet kryesore pyjore në zonë janë;

- *Abieto-fageto sylvaticae*
- *Fagetum oxalidosum*

Pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri

Lumi i Gashit përbën aktualisht një ndër zonat e pakëta në Shqipëri ku mund të gjenden pyje Ahu të klasave të para të prodhimit.

Në rrjedhën e poshtme të luginës, Lumi i Gashit përfshin pyje të përzier të cilat përfshijnë pothuajse të gjithë brezat pyjorë të vendit tonë, duke filluar që nga elementët mesdhetarë të tij të përfaqësuar nga Cermëdelli (*Cotinus coggygria*), dhe duke vazhduar me speciet e tjera si; Shkoza (*Carpinus* spp.), Dushqe (*Quercus* spp.), Lajthia (*Corylus avellana*), Lajthia e egër (*Corylus colurna*), Bliiri (*Tilia* spp.), Frashëri (*Fraxinus* spp.), Fshikarta (*Colutea arborescens*), Bërsheni (*Juniperus foetidissima*), Dëllinja e Kuqe (*Juniperus oxycedrus*), panjat e ndryshme (*Acer* spp.) etj. të cilat në lartësitë mbi 800 m në vartësi edhe të kundrejtimit ia lënë vendin habitateve me Ah dhe Halorë të tjerë. Për nga këndvështrimi fitocenologjik, Lugina e Gashit përfshin një vegjetacion kompleks, në të cilin hasen një sërë habitatesh të rëndësishme, bazë për larminë e lartë të bimësisë dhe specieve bimore e shtazore të tij.

Larmia e habitateve të florës dhe vegjetacionit në Luginën e Gashit i dedikohet larmisë së relievit, përbërjes gjeologjike, gjeomorfologjisë, si dhe depërtimit të klimës së lagësht sub-mesdhetare në atë kontinentale deri alpine në pjesët e sipërme të luginës. Pjesë e rëndësishme hidrografike e Luginës së Gashit është Lugina e Dobërdolit, e cila vendoset në veri-lindje të saj, në lartësitë mbi 1500 m.

Lugina rrethohet nga të paktën 50 maja me lartësi mbi 2000 mnd. Disa nga majat më të larta janë; Boronica 2011 m, Rupa 2266.7 m, Mullatcit 2031 m, Tërkuçit (2030 m), Valit 20118.4 m, Karajfilit (2075.8 m), Koshutica (2040 m), Kërshi i Ujkut (2273 m), Shpatit (2199.5 m), Bogicaj (2405m), Ali Çelës (2283.7 m), Dobërdolit (2238 m), Kërshi i Koçajve (2397 m), Kërshi i Zi (2425 m), Korita (2384 m), Tingëllimës (2338 m), Radesha (2312 m) etj.

Tokat janë të murrme pyjore (brezi i pyjeve të Ahut) dhe livadhore malore (brezi i kullotave alpine).






Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut

Të dhënat për strukturën e moshës së grumbullit janë marrë nga plani ekzistues i mbarështimit të ekonomisë pyjore. Grafiku në vijim paraqet një strukturë të moshës së pyjeve të ekonomisë pyjore “Lumi i Gashit”, kryesisht n/parcelat me pyje të vjetër Ahu;





Grafiku 7. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë "Lumi i Gashit"




Të dhënat e moshës janë në nivel n/parcele dhe nuk paraqesin moshën e drurëve të veçantë, e cila në shumë raste e tejkalon moshën mesatare të grumbullit të n/parcelës dy apo më shumë herë.

Nga disa matje të bëra në vitin 2016, nga 35 drurë të analizuar 9 prej tyre kanë rezultuar me moshën mbi 250 vjeçare (4 drurë me moshën 251-300 vjeç, 3 drurë 351-400 vjeç dhe 2 drurë me moshë 401-450 vjeç).

Këto janë të dhëna mjaft të rëndësishme lidhur me moshën e disa drurëve të vjetër të zonës. Fakti që janë evidentuar nëntë drurë (nga 35 të analizuar) me moshë mbi 250 vjeçare, si dhe drurë me moshë mbi 400 vjeçare, e bën këtë zonë unike në Shqipëri. Ky është tregues i një pasurie të jashtëzakonshme natyrore, e cila duhet evidentuar, hulumtuar më tej, promovuar dhe mbrojtur si e tillë.

Grafiku në vijim paraqet shpërndarjen e sipërfaqes së pyjeve të vjetër të Ahut (në %), sipas klasave të moshës;



Siç shihet nga grafiku, rreth 74% e sipërfaqes së pyjeve të Ahut në zonë kanë moshë mbi 140 vjeçare. Kjo, përveç vlerave të tjera natyrore, e bën zonën mjaft të rëndësishme sa i përket edhe sipërfaqes së konsiderueshme të grumbujve të vjetër që gjenden aty. Nga pikpamja e sipërfaqes që zënë grumbujt e Lumit të Gashit **përbëjnë** masivin më të madh me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri.



Gjeologjia dhe hidrogeologjia e zonës

Në bazenin e lumit të Gashit përhapen shkëmbinjtë me moshë gjeologjike nga më të vjetrit në Shqipëri. Ato përfaqësohen nga shkëmbinj terigjenë, vullkano-sedimentar dhe gëlqerorë pak të metamorfizuar. Shkëmbinjtë terrigjenë e vullkanikë i ndan masivi granodiorit i Torkuzit. Depozitimet me moshë më të re janë depozitimet në tarracat e vjetra lumore.

Shkëmbinjtë terigjenë përhapen kryesisht në pjesën jugore të zonës në trajtën e një brezi nga lindja në perëndim dhe ndërtohet nga ndërthurje flishoidale argjilo-ranore me gëlqerorë të moshës *Kretak i sipërm*. Këto shkëmbinj kanë përhapje gjithashtu në trajtë të një dalje të kufizuar në anën verilindore të zonës ku ndërtohet nga konglomerato-ranorët e kuqërremtë të moshës Permo-Triasike.

Shkëmbinjtë vullkano-sedimentar kanë përhapje të madhe në gjithë pjesën qendrore të zonës së Lumit të Gashit. Ata përbëhen nga horizonte me rreshpe karbonatike, alevrolitike dhe ranoro-kuarcore me linza vullkanitesh dhe njihen si formacioni sedimentaro-vullkanogjen i Çeremit me moshë *Silurian-Devoniane*. Këto shkëmbinj në pjesën lindore të zonës përbëhen nga vullkanite bazike në përgjithësi. Ato paraqiten shumë të metamorfizuar deri në të shëndërruar në shkëmb tjetër (porfiride) dhe kalojnë në mënyrë graduale në shkëmbinj andezite e dacite (vullkanite mesataro-acide).

Në gjysmën veriore të zonës, nga Torkuzi e deri në Dobërdol sipas drejtimit jugperëndim-verilindje përhapen shkëmbinj gabro-plagjiogranitik të Torkuzit që përfaqëson një unitet shkëmbor me kalime graduale nga gabrot, granodioritet e plagjiogranitet. Ata kanë çarë shkëmbinjtë me moshë më të vjetër, duke krijuar me to marrdhënie intruzive.

Shkëmbinjtë karbonatikë kanë shtrirje në gjithë pjesën jugore të zonë së lumit të Gashit. Ato përfaqësohen nga gëlqerorë, konglomerate rreshpe argjilore të rikristalizuara me moshë të *Triasikut* të poshtëm dhe gëlqerorë me gjenezë të ndyshme me moshë *Triasiku* i sipërm. Këto shkëmbinj ndërtojnë edhe malin më të lartë të zonës, malin e Shkëlzenit.

Historia e zhvillimit gjeologjik në zonën e lumit të Gashit fillon rreth 430 milion vite më parë kur në pjesën veriore të lumit të Gashit, filluan të depozitohen në detin e asaj kohe sedimente karbonatike, alevrolitike dhe

ranoro-kuarcore të ndërthura me vullkanite. Sedimentet fillimisht janë depozituar në det të cekët, i cili me kalimin e kohës ka vazhduar të thellohet. Në pjesën jugore të lumit të Gashit, në fillim ka pasur sedimentim karbonatik rreth 240 milion vite më parë, që ka kaluar nga sedimentim karbonato-terrigjen në terrigjeno-flishor. Që prej 50 milion vite më parë, zona e lumit të Gashit ka qenë e ngritur mbi sipërfaqen e ujit dhe ka shërbyer si trevë ushqyese terrigjene për zona të tjera që ndodheshin nën ujë. Në *Kuaternar*, 2 milion vite më parë e sot, veprimtaria e faktorëve të jashtëm i kanë dhënë relievit të saj përgjithsisht një karakter alpin me lugina të thella e maja të larta (mbi 2000 m), duke e modeluar atë në pamjen që ka sot.



Hidrografia

Lugina e Lumit të Gashit shtrihet në verilindje të Alpeve tona dhe fillon në pjesën e sipërme të saj me lugun akullnajor të Dobërdolit (*Dobërdol – ka kuptimin luginë e bukur*).

Lumi i Gashit dallohet për një regjim relativisht të rregullt uhor. Kjo shpjegohet me faktin se lumi rrjedh në pjesën më të madhe nëpër një zonë rreshpore të papërshkueshme si dhe me ushqimin e tij nga ujërat e borës që shkrin gradualisht në kreshtat alpine.

Në pjesën e sipërme të luginës (bjeshkët e Dobërdolit) nga ana lindore e saj gjenden disa liqene akullnajore, më i madhi prej të cilëve është Liqeni i Dashit. Ai vendoset në një lartësi prej 2175 mnd, dhe është ndër liqenet akullnajore më të mëdhenj të Alpeve tona.



Në bjeshkët e Dobërdolit ka shumë burime uji, duke bërë që një baitat shumë i veçantë të jetë prezent në pjesën e sipërme të luginës; habitati me kod *7110* Moçalishte me ngritje aktive*, i krijuar nga prania e ujit dhe procesi mijëra vjeçar i dekompozimit të myshqeve dhe bimësisë



tjetër që rritet në zona të tilla të lagëta. Toka në këto habitate paraqitet e butë (si sfungjer) kur e shkel dhe ka përmbajtje të lartë lënde organike. Habitata të tilla ka kryesisht në pjesën e sipërme të luginës.

Në zonën e lumit të Gashit drenojnë rreth 10 burime me ujëra nëntokësore me prurje nga 0.2 deri në 15 l/s. Burimet lidhen me porozitetin e çarjeve të shkëmbinjve vullkano-sedimentarë të granodioritve të Torkuzit, por edhe me karstin në rastin e shkëmbinjve gëlqerorë. Ujërat e burimeve kanë cilësi të mirë. Karakteristikë e tyre është se dalin në kuota të larta nga 1300 deri në

2100 mnd, kanë temperatura të ulta që luhaten nga 3.6 deri në 8 °C, fortësi të përgjithshme të ulët nga 2 deri në 8 dH dhe gjithashtu mineralizim të përgjithshëm të ulët që luhatet nga 50 deri në 170 mg/l.

Habitatet kryesore

Habitatet kryesore në lumin e Gashit janë:

91K0 Pyje liriike me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion). Habitatet me Ah, përgjatë Luginës së Gashit, nga pikpamja e strukturës fitocenologjike janë komplekse për shkak të ndërthurjes së tij me elementë të bimësisë halore në lartësitë mbi 1000 m dhe gjethgjerë sub-mesdhetare në rrjedhën e poshtme të saj. Sipërfaqja e mbuluar me Ah në Luginën e Gashit, shtrihet pothuajse

mbi nivelin e kanalit të marrjes së ujit në të. Pjesa e mesit të rrjedhës së Lumit përbën dhe qendrën e habitatit të Ahut, për shkak se në pjesën e poshtme mbizotërojnë drurët e tjerë gjetherënës. Në pjesën e sipërme, mbi 1300-1400 m, Ahu zëvendësohet me pyjet e rrobullit (*Pinus heldreichii*), Bredhit të bardhë (*Abies alba*) dhe të Arnenit (*Pinus peuce*), mjaft të dukshme në Torkuz, Balçinë, Pagajë dhe Lugun e Vocit. Sidoqoftë në shumë zona të Luginës, Ahu dhe halorët e tjerë, përzihen në mes tyre duke formuar pyje të përzierë, çka e bëjnë të gjithë luginën mjaft interesante nga këndvështrimi peizazhor dhe larmia e ngjyrave, e shtuar kjo sidomos gjatë pranverës dhe vjeshtës, me pjesmarrjen e Boronicës (*Vaccinium myrtillus*), e cila mbulon sipërfaqe të mëdha mbi katin e pyllit.



Në habitatin e Ahut, bashkë me të ose në çeltirat e pyllit gjenden gjithashtu edhe speciet e tjera drunore ose barishtore si; *Acer pseudoplatanus*, *Sorbus aucuparia*, *Cotoneaster tomentosus*, *Rhamnus alpines*, *Lonicera alpigena*, *Aremonia agrimonioides*, *Aconitum lamarckii*, *Aconitum pentheri*, *Bromus erectus*, *Fragaria vesca*, *Luzula luzuloides*, *Lilium martagon*, *Prenanthes purpurea*, *Sanicula europaea*, *Salvia glutinosa*, *Doronicum columnae*, *Mycelis muralis*, *Cardamine enneaphyllos*, *Malva moschata*, *Calamintha grandiflora*, *Sorbus spp.*, *Thalictrum minus*, *Viola tricolor* etj. të cilat e bëjnë florën e Luginës së Gashit mjaft të pasur.



Lugina e Gashit dhe Habitatet me Ah, përfshirë shoqërimet e tij me *Galium odoratum* ose me *Luzula sylvatica*, janë shumë të rëndësishme për shkak se pylli i Ahut është i pa ndikuar nga njeriu dhe natyrisht është i virgjër. Shoqërimet e përziera të tij me Rrobull, Arnen ose Bredh të bardhë e bëjnë atë një habitat plot larmi dhe gjallëri. Mbi brezin e halorëve, shoqërimet me Dëllinjë dhe Rrush ariu (*Junipero nanae-Arctostaphylletum*) ose me Boronicë, sidomos në Markofçe, Torkuz dhe Dobërdol, krijojnë larmi të komuniteteve bimore dhe strehë ushqimore për gjitarët e mëdhenj dhe fluturave të shumta të hasura si; *Leptidea sinapis*, *Vanessa cardui*, *Aglais urtica*, *Polygonia c-album*, *Argynnis paphia*, *Argynnis aglaja*, *Argynnis niobe*, *Melitaea cinxia*, *Melitaea didyma*, *Melitaea athalia*, *Lybithea celtis*, *Melanargia galathea*, *Maniola jurtina*, *Coenonympha arcania*, *Lasiommata megera*, *Satyrrium ilicis*, *Callophrys rubi*, *Lycaena phlaeas*, *Lampides boeticus*, *Maculinea alcon*, *Aricia agestis*, *Lycaeides idas*, *Plebejus argus*, *Lysandra amanda*, *Ochlodes sylvanus*, *Pyrgus malvae*.

3220 Lumenjtë alpinë dhe bimësia barishtore përgjatë brigjeve të tyre. Ky tip habitati gjendet në pjesën e mesit dhe të poshtme të rrjedhjes së lumit të Gashit. Vegjetacioni i lumenjve përfaqësohet nga formacione shelgjesh dhe Vërrini (*Salicetum eleagni* dhe *Alnetum incanae*) dhe të dominuara nga *Salix elaeagnos*, dhe nga drurë e bimë barishtore shumëvjeçare si;

Alnus incana, *Rhamnus alpinus*, *Arunco dioicus* etj. Lumi është i rëndësishëm si habitat jo vetëm sepse në të rriten dhe jetojnë disa specie peshqish (përfshirë troftën e Drinit, *Salmo trutta fario*, e cila është vlerësuar si e rrezikuar - Vulnerable, për faunën shqiptare), insektesh dhe kërmij tokësorë por edhe sepse regjimi uhor i tyre është i rëndësishëm për rregullimin e lagështirës ajrore dhe temperaturave (klimës) brenda ujëmbledhësve të tyre.

4060 Shqopishte alpine dhe të borealit. Ky tip habitati shtrihet sipër kufirit të pyjeve të Ahut (*Fagus sylvatica*) ose atyre halorë (*Pinus heldreichii*, *P. peuce* dhe *A. alba*). Habitatat dominohet nga shqopishte të shkurtëra si ato me; *Dryas octopetala*, Dëllinja, Boronica dhe Gjineshtra (*Genista*). Shqopishte alpine dhe të borealit shtrihen nga 1350 deri 2300 m lartësi, pavarësisht se sipërfaqet më të mëdha ato i zënë në rajonin alpin ku formojnë edhe “tapete” të gjelbra me lartësi 10 cm (*Dryas octopetala*) ose edhe më shumë se 0.5 m, si në rastin e dëllinjave *Juniperion nanae* dhe *Juniperion sabinæ* ose në rastin e Boronicës (*Vaccinium myrtillus*).

6230* Kullota me prani të lartë të *Nardus stricta* në substrate silicore të zonave malore. Ky tip habitati mbulon sipërfaqe shumë të vogla brenda ujëmbledhësit të luginës së Gashit. Habitatat shquhet për shoqërimet me *Pulsatillo-Nardetum* dhe *Leontodonto-Nardetu* dhe specie e rralla dhe të rrezikuara si *Alchemilla alpina*, *Alkanna scardica*, *Antennaria dioica*, *Carex* spp., *Dianthus cruentus*, *Edraianthus montenegrinus*, *Lilium albanicum*, *Nardus stricta*, *Plantago reniformis*, *Jovibarba* sp., *Salix retusa*, *Vaccinium myrtillus* etje.

8210 Shpate shkëmbore gëlqerore me vegjetacion hasmofitik. Këto habitate banohen nga një vegjetacion specifik i klasës *Asplenetea trichomanis* me dominancë të shoqërimeve si: *Saxifrago-Potentilletum speciosa*, *Ramondo-Seslerietum tenuifoliae*, *Sedo-Asperuletum doerfleri*, *Potentilletalia speciosae* ose *Campanulion versicoloris*. Ky tip Habitati haset në zonën e mesit dhe të poshtme të Luginës së Gashit.





91L0 *Pyje Ilirikë me dushk dhe shkozë (Erythronio-Carpinion)* dhe **91M0** *Pyje gjetherënës Ballkano-Panonikë me dushqe*. Të dy tipet e mësipërme të habitatit ndodhen në pjesën e poshtme të rrjedhës së Lumit të Gashit, dhe paraqesin rëndësi të veçantë sepse janë vazhdimi i pyjeve të zonës së sipërme dhe njëkohësisht sigurojnë vazhdimësi mbrojtjeje përgjatë gjithë luginës, jo vetëm për speciet bimore por edhe gjallesave shtazore.

9180* *Pyje të aleancës Tilio-Acerion të shpateve shkëmbore, çakëllishteve dhe luginave të thata*. Ky tip habitati prioritar është i përhapur në të dy anët e zonës së poshtme të luginës, dhe kryesisht midis habitatit me dushqe të pyjve gjetherënës Ballkano-Panonikë. Është i rëndësishëm sepse dallohet për larmi shumë të lartë të drurëve dhe shkurreve si Cermëdelli (*Cotinus coggygria*), dhe duke vazhduar me speciet e tjera si Shkoza (*Carpinus* spp.), dushqet (*Quercus* spp.), Lajthia (*Corylus avellana*), Lajthia e egër (*Corylus colurna*), Bliri (*Tilia* spp.), Frashëri (*Fraxinus* spp.), Fshikarta (*Colutea arborescens*), Bërsheni (*Juniperus foetidissima*), Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), panjat e ndryshme (*Acer* spp.) etj.

91BA *Pyje Moesianë me Bredh*. Shoqërimet me bredh dhe Arnen (*Abieto-Piceetum bertisceum sensu lato*) me dominancë të Bredhit të bardhë (*Abies alba*) ose të Arnenit (*Pinus peuce*) përzier me Ahun (*Fagus sylvatica*) dhe halorë të tjerë mbulojnë sipërfaqe jo shumë të mëdha brenda territorit të luginës. Pyjet me Bredh të bardhë janë të fragmentuara, dhe të pozicionuar kryesisht në faqet veriore të maleve, në toka acide dhe të drenuara mirë dhe me lagështi të lartë. Ngastrat e këtij habitati ndodhen në lartësitë mbi 1200-1300 mnd.

95A0 *Pyje pishash të larta të zonave malore të Mesdheut*. Ky tip habitati përfshin pyjet me pishën endemike të Rrobullit (*Pinus heldreichii*) dhe pishën relikte të Arnenit (*Pinus peuce*), pozicionohen mbi pyllin e Ahut ose në përzierje me të. Shoqërimet bimore me *Pinetum heldreichii* dhe *Pinetum peucis* gjenden në mjedise më të ftohta, shpesh në faqet shkëmbore



me shtresë të hollë dheu, nga 1100 m në pikën e bashkimit të ujrave të Pagajës me ato që vijnë nga Dobërdoli. Ndër speciet barishtore më të kudondodhurat janë: *Astragalus angustifolius*, *Calamagrostis arundinacea*, *Brachypodium pinnatum*, *Cephalanthera rubra*, *Crepis* spp., *Helianthemum nummularium*, *Hieracium villosum*, *Luzula luzuloides*, *Luzula sylvatica*, *Thymus longicaulus*, *Trifolium alpestre* etj.

Rëndësia e këtij habitati qëndron në atë që vetëm në Luginën e Gashit, Dobërdolit dhe Turkuz, Arneni i bardhë si specie halore është duke u zhvendosur në lartësi në shoqërimet me Boronicë. Kjo zhvendosje në lartësi i dedikohet kryesisht shkakut të ndryshimeve klimatike.

Vlerat kryesore të zonës

Vlerat më kryesore natyrore për zonën janë;

- **Ekositemi natyror.** Zona përfaqëson ekosistemin më të mirë dhe më të madh pyjor në gjendje natyrore (virgjër) që gjendet në Shqipëri.
- **Pyjet e vjetër të Ahut.** Përfaqësojnë grumbullin më të madh, më cilësor dhe më natyror që gjenden aktualisht në Shqipëri. Natyra dhe ekosistemet pyjore të zonës janë thuajse të pa ndikuara nga njeriu dhe paraqiten në gjendjen e tyre natyrore, duke na ofruar sot gjendjen e pyllit në stadin *klimaks* të tij. Në zonë janë evidentuar 4 drurë me moshë 251-300 vjeç; 3 drurë 351-400 vjeç dhe 2 drurë 401-450 vjeç.

Prezenca e drurëve me moshë 400-450 vjeçare është një vlerë e jashtëzakonshme dhe tregues i natyralitetit të zonës, të pandikuar nga njeriu.

- **Prania e llojeve** të rëndësishme pyjore si; Ahu, Bredhi i bardhë, Hormoqi, Rrobulli etj.
- **Peizazhi unik** i zonës, i cili mund të **vërehet** nëse udhëton duke e përshkruar vertikalisht luginën. Mënyra më e mirë për të përjetuar natyrën e zonës është duke ecur përgjatë lumit të Gashit. Ndërsa për të përjetuar peizazhin e zonës është duke vizituar majat e larta që rrethojnë luginën. Lugina e Lumit të Gashit rrethohet nga 50 maja malesh me lartësi mbi 2000 mnd.
- **Vlerat e biodiversitetit.** Në zonë gjendet një numër i madh llojesh të rrezikuara që janë pjesë e listës së kuqe të Shqipërisë dhe IUCN, të **përmbledhura më poshtë;**

Flora; në lumin e Gashit gjenden 15 lloje drurësh, shkurresh e bimësh të ndryshme.

Fauna; zona paraqitet si vend strehimi, ushqimi dhe shumimi për të paktën 8 gjitarë, 13 shpendë, 3 amfibë, 3 insekte, dhe 1 molusk. Zona strehon të gjithë gjitarët e mëdhenj; Ariu, Ujku, Rrëqebulli, Macja e egër, Derri i egër, Dhia e egër, Kaprolli etj. si dhe disa shpendë të rëndësishëm si; Gjeli i egër dhe Pula me çafkë. Në këtë pikpamje zona përfaqëson një njësi unike në vend edhe për sa i përket vlerave të diversitetit biologjik

dhe vlen të konsiderohet si një 'hot spot' i biodiversitetit të vendit tonë.

- **Liqenet akullnajore të Dobërdolit** (monumente natyre, kategoria e III). Nndodhen në pjesën e sipërme të luginës së Gashit, në bjeshkët e Dobërdolit. Gjenden 7 liqene, por ai i Dashit është më i madhi. Gjatësia e tij është 200-250 m, gjerësia 150-200 m, ndërsa sipërfaqja rreth 3 ha.
- **Traditat kulturore.** Zona e Tropojës shquhet për traditat e mikpritjes, gatimet e veçanta, arkitekturën tradicionale, veshjet popullore, këngët dhe vallet, ritet që përbëjnë një aset të çmuar krahas vlerave të natyrës.



Rëndësia pse duhet të mbrohet: Larmia e tipeve të habitateve me Ah, halorë të tjerë dhe Boronicë dhe pyjet e virgjër përbëjnë një strehë të rëndësishme për shumë lloje të florës, midis të cilave dallohen lloje të rralla ose të mbrojtura nga direktiva e habitateve si; *Aconitum lamarckii*, *Aconitum pentheri*, *Crepis bertiscea*, *Hieracium waldsteinii*, *Viola calcarata* subsp. *zoysii*, *Geum bulgaricum*, *Buxbaumia viridis*, *Campanula scheuchzeri*, *Gentiana lutea* dhe *Pulsatilla alpina*, pa përmendur këtu prezencën e Salamandrës së zezë (*Salamadra atra*) si dhe të gjithë gjitarëve të mëdhenj (*Ariu*, *Ujku*, *Rrëqebulli*, *Derri i egër*, *Dhia e egër*, *Kaprolli etj.*).



Udhërrëfyes për në zonë

Mënyra më e mirë për ta vizituar zonën është duke u futur në luginë nga pjesa e sipërme e saj. Rekomandohet mundësia duke përshkuar me makinë rrugën e sapo ndërtuar; Tropojë e vjetër-bjeshkët e Sylbicës. Kjo rrugë është ndërtuar përgjatë luginës së lumit të Tropojës. Është një rrugë e cila kalohet me vështirësi dhe vetëm nga automjete të mëdha Rruga është e kalueshme vetëm në periudhën e verës. Rruga shkon deri në afërsi të liqenit të Sylbicës, në qafën e Dobërdolit dhe më tej duhet përshkuar në këmbë. Pastaj lëvizet poshtë duke ndjekur rrjedhën e ujit të Lumit të Gashit. Udhëtimi përfundon në pjesën e poshtme të luginës pasi del nga kanioni i ngushtë në fundin e saj, në fshatin Begaj.

Në krye të luginës (bjeshkët e Dobërdolit) kalon një rrugë makine por ajo është jashtë çdo standarti dhe thuajse e pakalueshme. Ky është një aks shumë i vështirë (veçanërisht segmenti Çerem-Sylbicë) që përshkon rrugën Valbonë-Çerem-Dobërdol-Sylbicë-Tropojë e vjetër. Kjo rrugë bëhet duke shkuar nga fshati Çerem, në bjeshkët e Markofçes drejt staneve të Torkuzit ose Bjeshkëve të Dobërdolit dhe pastaj duke zbritur poshtë në luginën e Lumit të Gashit ose duke ndjekur drejtimin e kundërt; Tropojë e vjetër-Sylbicë-Dobërdol.




Figura 13. Drejtimit kryesore për në “Lumin e Gashit”

Mund të vizitohet edhe duke ecur në këmbë nga fshati Begaj, duke lëvizur drejt luginës **lart**, përgjatë lumit të Gashit drejt bjeshkëve të Dobërdolit.


Lumi i Tropojës

Skeda e zonës








Qarku	Kukës
Bashkia/Nj.Ad.	Tropojë/ Tropojë
Ekonomia pyjore	Lumi i Tropojës
Fshati	Papaj/Myhejan + fshatrat e tjerë të Nj.Ad. Tropojë
Emri popullor i zonës	Lumi i Tropojës
Infrastruktura në zonë	Zona ka rrugë makine dhe këmbësore
Autoriteti menaxhues	Bashkia Tropojë
Vendndodhja gjeografike	Veriu = 42°28'35.60" dhe Lindja = 20° 9'8.33"
Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> - Sipërfaqja ku dominojnë pyje të vjetër Ahu = 1243.6 ha - Zonë buferike = 2973.8 ha - Sipërfaqja totale = 4217.5 ha
Akset rrugore për të aksesuar zonën	Zona mund të aksesohet me rrugë makine (që e përshkon luginën mes për mes) nga; Tirana, Kukësi, Prishtina
Aksesi në rrugë këmbësore	Rruga Papaj për në luginën e lumit të Tropojës është rreth 8 km, ose 2 orë në këmbë. Nga fshati Myhejan distanca është 10 km, 2.5 orë
Vlerat kryesore të zonës	<ul style="list-style-type: none"> - Masivi pyjor me pyjet e vjetër me Ah dhe Rrobull. - 36 lloje të rralla e të rrezikuara (pjesë e listës së Kuqe të IUCN dhe Shqipërisë) - Liqenet akullnajore të Sylbicës (monument natyre). - 24 maja me lartësi mbi 2000 mnd. Maja më e lartë Shkëlzeni (2405.5 mnd)
Rreziqet kryesore	Zjarret, prerja e pyjeve, ndërtime, gjuetia, mbetjet, HEC-et
Statusi aktual i mbrojtjes	Nuk ka asnjë status mbrojtje aktualisht
Zonë potenciale për:	<ul style="list-style-type: none"> o Wilderness Europe o Park Kombëtar* o Rrejtji Kombëtar i Pyjeve të Vjetër o Pyje me funksion mbrojtës



*Në vitin 2016 është propozuar si zonë qendrore e Parkut Kombëtar "Alpet Shqiptare" (kategoria e II), por nuk është miratuar ende

SHKALLA 1 : 50 000



Shpjeguesi

-  Pleistocen - Holocen. depozitime të përziera aluviale - proluviale. rëra, zhavore, alevrite
-  Maastriktian. Ndërthurje fliashoidale, argjilo - ranore - gëlqerore
-  Triasik i Mesëm - Jurasik i Poshtëm. Gëlqerorë pllakorë me silicorë
-  Triasik i Sipërm. Gëlqerorë me megalodonte, gëlqeror stromatolitikë, dolomite
-  Ladinian. Gëlqerorë algorë, gëlqerorë me gastropodë, dolomite
-  Triasik i Mesëm. Rreshpe, gëlqerorë
-  Paleozoik i Sipërm. Formacioni vullkano - sedimentar, bazalte, andezite, dacite, rreshpe gëlqerore të mermerizuar.



1:25,000
Sheet No. 1

Coordinate System: UTM
Projection: UTM
Zone: 38N
Datum: ED50
Scale Factor: 0.9996
False Easting: 500,000
False Northing: 0
Units: Meter



Legend/Legjenda
Lumë i Tropojës
Zona
 Qark
 Rreth



Lumë i Tropojës

Drawn By: ELSON HALIMAJ
Checked By: ABDULLA DUKU
Date: 05-04-2018

"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"



Lumë i Tropojës
 Drawn By: ELSON HALIMAJ
 Checked By: ABDULLA DUKU
 Date: 05-04-2018

1:25,000
 Sheet No. 2

Coordinate System: UTM
 Projection: UTM
 Zone Number: 38N
 False Easting: 500,000.0000
 False Northing: 0.00000000
 Scale Factor: 0.9996
 Datum: WGS 84
 Units: Meter

Legjenda/Legjenda
Lumë i Tropojës
 Zone
 Red box: Oak
 Yellow box: Beech



"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"



Përshkrimi i zonës

Lumi i Tropojës shtrihet përgjatë kufirit verilindor të vendit tonë me Kosovën. Ai përbën degën e tretë të Lumit të Valbonës, i cili e merr burimin e vet nga liqenet e Sylbicës, duke formuar kështu lumin e Tropojës. Ndahet nga Lugina e Lumit të Gashit nëpërmjet kurrizit të Dobërdolit, dhe mbledh ujrën e Sylbicës, shpateve lindore të Malit të Shkëlzenit dhe shpateve perëndimore të Ujezë-Padeshit.

Zona bën pjesë në Njësinë Administrative Tropojë, bashkia Tropojë.

Brezi i Ahut në këtë Luginë zë fill në lartësitë 800-900 m, dhe ngjitet deri në lartësitë 1600-1800 m, në të dy shpatet anësore të Lumit. Lartësitë më të mëdha hipsometrike të Ahut në këtë luginë gjenden **në Ujezë të Padeshit. Habitatit kryesor i Ahut edhe në këtë luginë është ai me kod 91K0.**


Lugina rrethohet nga te paktën 24 maja mbi 2000 mnd. Maja më e lartë është ajo e Malit të Shkëlzenit (2405.5 m), e cila përbën edhe pjesën jugore të brezit të majave të Alpeve shqiptare.

Zona aktualisht nuk ka asnjë status mbrojtës. Në vitin 2015 është propozuar që lugina e Tropojës (sipërfaqja me pyje të vjetër Ahu) të jetë Zonë Qendrore e Parkut Kombëtar “Alpet Shqiptare” (kategoria II), propozim i cili nuk është miratuar ende nga MTM.

Tokat janë të murrme pyjore (brezi i pyjeve të Ahut) dhe livadhore malore (brezi i kullotave alpine).

Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut


Sipas planit të Inventarizimit të ekonomisë pyjore “Lugina e Tropojës”, rezultojnë se zona ka një grumbull pyjor me sipërfaqe rreth 500 ha me pyje të vjetër Ahu me moshë mbi 120 vjeçare. Madje, një grup n/parcelash pyjore raportohet të jenë me moshë mesatare mbi 200 vjeçare (n/parcelat; 68/a, 69/a, 70/a, 71/a, 72/a, 73/a, 74, 75, 76, 77/a, 78/b etj).



Grafiku 9. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Lugina e Tropojës”

Kjo i bën këto grumbuj me pyje Ahu ndër më të vjetrit dhe më të rëndësishmit që gjenden aktualisht në Shqipëri.

Sa i përket shpërndarjes së grumbujve pyjore të Ahut bazuar në klasat e moshës kemi këtë gjendje;



Grafiku 10. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, “Lugina e Tropojës”

Nga grafiku vërehet se 92% e grumbujve të kësaj ekonomie pyjore kanë moshë mbi 120 vjeçare, duke i klasifikuar kështu si një ndër burimet më të vjetra gjenetike të pyjeve të Ahut në vend.

Gjeologjia dhe hidrogjeologjia

Në bazenin e lumin të Tropojës kanë përhapje shkëmbinjtë vullkano-sedimentar, terigjenë dhe gëlqerorë. Shkëmbinjtë me moshë më të re në këtë zonë janë depozitimet në tarracat e vjetra lumore.

Shkëmbinjtë vullkano-sedimentar kanë përhapje shumë të gjerë në lumin e Tropojës dhe njihen me emrin “formacioni vullkanogjeno-sedimentar Rupe-Sylbicë”. Ato zenë rreth 2/3 e sipërfaqes së luginës. Në pjesën më të madhe këto shkëmbinj kanë dalje në sipërfaqe, por në luginën e lumit të Tropojës ato janë të mbuluar nga depozitime të reja *kuaternare* me trashësi të vogël. Shkëmbinjtë ndërtohen kryesisht nga vullkanite bazike, shumë të metamorfizuar deri në të shëndërruar në shkëmb tjetër (porfiride) dhe kalojnë në mënyrë graduale në shkëmbinj bazalte, andezite e dacite (vullkanite mesataro-acide). Brenda zonës vullkano-sedimentare takohen edhe shkëmbinj argjiloro-silicore dhe nivele të gëlqerorëve të petëzuar që thërrmohen lehtë (rreshpe) në përgjithësi mjaft të rikristalizuar.



Shkëmbinjtë terigjenë përhapen kryesisht në pjesën jugore të zonës të lumit të Tropojës në trajtën e një brezi nga lindja në perëndim, që rrethon edhe malin e Shkëlzenit. Shkëmbinjtë terigjen ndërtohen nga ndërthurje të argjilla-ranore me gëlqerorë (flish i imët) të moshës *Triasik i mesëm* dhe *Kretak i sipërm*.

Shkëmbinjtë karbonatikë kanë përhapje në gjithë pjesën jugore të zonës së lumit të Tropojës dhe shtrihen në trajtë brezash sipas drejtimit lindje-perëndim. Ato përfaqësohen nga rreshpe gëlqerorë silicorësh të rikristalizuara e dolomite të *Triasikut të mesëm* dhe nga gëlqeror pllakor me silicorë të moshës *Trias i sipërm-Jurasik*.

Historia e zhvillimit gjeologjik në zonën e lumit të Tropojës fillon rreth 300 milion vite më parë kur në pjesën veriore të tij, filluan të depozitohen në detin e asaj kohë vullkanite të përfaqësuar me bazalte, andezite e dacite dhe sedimente karbonatike, alevrolitike dhe ranoro-kuarcore. Sedimentet fillimisht janë depozituar në det të cekët, i cili me kalimin e kohës ka vazhduar të thellohet. Në pjesën jugore të lumit të Tropojës, në fillim ka pasur sedimentim karbonatik rreth 240 milion vite më parë, që ka kaluar nga sedimentimi karbonato-terrigjen në terrigjenoflishor i cili ka zgjatur deri në rreth 140 milion vjet më parë. Që prej 50 milion vite më parë zona e lumit të Tropojës ka qenë e ngritur mbi sipërfaqen e ujit dhe ka shërbyer si trevë ushqyese terigjene për zona të tjera që ndodheshin nën ujë. Në *kuaternar*, 2 milion vite më parë e sot, veprimtaria e faktorëve të jashtëm i kanë dhënë relievit të saj përgjithësisht një karakter alpin me lugina të thella e maja të larta (mbi 2000 m), duke e modeluar atë në pamjen që ka sot.



Hidrografia

Lugina e Lumit të Tropojës fillon në lugun akullnajor të Sylbicës. Pjesa e sipërme e luginës zihet nga liqeni i madh i Sylbicës, në lartësinë 2050 mnd. Liqeni ka një gjatësi rreth 300 m, gjerësi maksimale 200 m, kurse thellësia arrin 1.5-1.6 m. Liqeni ushqehet kryesisht nga reshjet e borës dhe si i tillë ka regjim alpin. Lugina rrethohet nga varmale të fuqishme, të cilët parqiten në formën e tyre tipike alpine. Pjesa e poshtme e luginës ngushtohet shumë duke formuar një kanion mjaft të ngushtë në një gjatësi rreth 3.5-4 km.

Lumi i Tropojës nga ku ka marrë emrin lugina, ka një gjatësi të përgjithshme prej 21 km. Buron nga Liqeni i Madh i Sylbicës dhe ruan një drejtim të përgjithshëm veri-jug deri në fshatin Tropojë e vjetër më pas merr drejtimin jugperëndimor deri në Bujan ku bashkohet me Valbonën.

Lumi i Tropojës ka një rrjedhje të pasur falë reshjeve të mëdha të shiut dhe të borës që bien në pellgun e tij.

Në bjeshkët e Sylbicës ndodhet edhe një habitat i veçantë përreth burimeve ujore; habitatit prioritar me kod *7110* Moçalishte me ngritje aktive*.

Në zonën e lumit të Tropojës drenojnë 7 burime me ujëra nëntokësore me prurje nga 0.3 deri në 12 l/s. Burimet lidhen me porozitetin e çarjeve të shkëmbinjve vullkano-sedimentar dhe me karstin e zhvilluar në shkëmbinj të gëlqerorë. Ujërat e burimeve kanë cilësi të mirë. Karakteristikë e tyre është se dalin në kuota të larta nga 900 deri në 2100 mnd, kanë temperatura të ulta që luhaten nga 3.5 deri në 8.5 °C, fortësi të përgjithshme të ulët nga 1.5 deri në 7 dH dhe gjithashtu kanë mineralizim të përgjithshëm të ulët që luhatet nga 50 deri në 250 mg/l.

Habitatet kryesore në zonë





Habitatet më kryesore në Luginën e Lumit të Tropojës janë;

91K0 Pyje liriike me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion). E krahasuar me tipet e Habitave të hasura në Luginën e Gashit, larmia fitocenologjike e kësaj luginë është pak më e ndryshme për shkak të mbizotërimit të substrateve silicore, dhe mungesë-prezencës së Bredhit të bardhë (*Abies alba*) dhe të Arnenit (*Pinus peuce*).

Sipërfaqja e mbuluar me Ah (*Fagus sylvatica*) në lumin e Tropojës shtrihen pothuajse në substratet silicore dhe flishore të shpateve perëndimore të luginës kurse shpatet me kundrejtimit lindor përbëhen nga shoqërime të Ahut me Rrobull (*Pinus heldreichii*), të cilët sëbashku formojnë pyje të përziera sidomos në substratet shkëmbore gëlqerore të saj. Struktura fitocenologjike e habitave të Ahut është pothuajse e njëjtë me atë të Luginës së Gashit, por në çeltrirat midis drurëve të Ahut, struktura pyjore dhe barishtore është e ndryshme nga ajo e Luginës së Gashit. Në ndryshim nga Lugina e Gashit, në çeltrirat pyjore të substrateve silicore hasen shoqërime bimore të *Bruckenthalia spiculifolia*, krahas shoqërimeve me Boronicë (*Vaccinium myrtillus*), e cila haset edhe në Luginën e Gashit.

Një habitat i rëndësishëm i “Lumit të Tropojës” është dhe ai me kod **3240: Lumenj alpine** dhe bimësia e tyre drunore me *Salix elaeagnos*, ku Vërrini formon galeri të vërteta dhe të rëndësishme për jetën e insekteve, shpendëve dhe gjitarëve. Vegjetacioni i lumenjve përfaqësohet nga formacione shelgjesh dhe Vërrini (*Salicetum eleagni* dhe *Alnetum incanae*) dhe të dominuara nga *Salix elaeagnos* dhe *Salix purpurea*.



Në Lumin e Tropojës gjendet gjithashtu Trofta e Drinit (*Salmo trutta fario*) kurse shpatet e thepisura të Shkëlzenit dhe të Ujezës strehojnë Dhinë e egër dhe Ariun e murrinë, ndërsa lugina ka edhe gjitarë të tjerë.



Habitatet të tjera janë;

4060 Shqipishte alpine dhe të borealit.

6230* Kullota me prani të lartë të *Nardus stricta* në substrate silicore të zonave malore.

6520 Livadhe malore të lartësive.

95A0 Pyje pishash të larta të zonave malore të Mesdheut.

8210 Shpate shkëmbore gëlqerore me vegjetacion hasmofitik. Këto shpate banojnë nga një vegjetacion specifik i klasës *Asplenetea trichomanis* me dominancë të shoqërimeve; *Saxifraga-Potentilletum speciosa*, *Ramondo-Seslerietum tenuifoliae*, *Sedo-Asperuletum*

doerfleri ose *Potentilletalia speciosae*. Habitatet është strehues i disa specieve relikte të akullnajave, si dhe i specieve endemike dhe subendemike me territor të kufizuar përhapjeje si psh.; *Amphoricarpus autariatus*, *Asperula doerfleri*, *Campanula albanica*, *Omalotheca pichleri*, *Iberis sempervirens*, *Potentilla speciosa*, *Ramonda serbica*, *Saxifraga grisebachii*, *S. marginata*, *Veronica aphylla*, *Wulfenia carinthiaca* etj.

Vlerat kryesore të zonës

Disa nga vlerat më kryesore natyrore të lumit të Tropojës janë;

- **Ekositemi natyror.** Zona përfaqëson një ekosistemin interesant natyror, ku kombinohen pyjet e vjetër të Ahut me masivet e kullotave alpine dhe liqenet akullnajore të Sylbices.
- **Pyjet e vjetër të Ahut.** Përfaqësojnë një grumbull pyjorë me drurë ndër më të vjetërit që gjenden në vend. Natyra dhe ekosistemet pyjore të zonës janë thujtse të pa ndikuara nga njeriu dhe përgjithësisht paraqiten në gjendjen e tyre natyrore.
- **Prania e llojeve** të rëndësishme pyjore si; Rrobulli, Ahu etj.



- **Peizazhi unik** i zonës i cili mund të përjetohet nëse udhëton duke e përshkruar vertikalisht luginën përgjatë lumit të Tropojës. Ndërsa për të shijuar peizazhin mënyra më e mirë është ecja nëpër majat e larta që rrethojnë luginën.
- **Vlerat e biodiversitetit.** Lumi i Tropojës është një zonë mjaft e rëndësishme sa i përket biodiversitetit. Në vijim jepen të dhëna vetëm për llojet e rrezikuara me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare (lloje të rralla, me status mbrojtës dhe që janë pjesë e listës së kuqe të Shqipërisë dhe IUCN). Lista e detajuar e tyre, statusi i secilit lloj janë paraqitur në kapitujt më sipër.

Flora; në zonë gjenden rreth 12 lloje drurësh, shkurrësh dhe bimësh të rrezikuara.

Fauna; Në zonë gjenden 8 gjitarë, 11 shpendë, 2 amfibë, 2 insekte dhe 1 molusk me status të rrezikuar. Vlen të theksohet se zona strehon të gjithë gjitarët e mëdhenj; Ariu, Ujku, Rrëqebulli, Macja e egër, Derri i egër, Dhia e egër, Kaprolli etj. si dhe disa shpendë të rëndësishëm si; Gjeli i egër dhe Pula me çafkë.

- **Malet e larta.** Në zonë janë rreth 24 maja malesh me lartësi mbi 2000 mnd.
- **Liqenet akulljanore të Sylbicës** (monumente natyre, kategoria e III). Nodhen në lartësinë 1900-2000 mnd, në pjesën e sipërme të luginës. Në këtë luginë ka morena dhe 8 liqene akullnajore. Liqeni më i madh është ai i Sylbicës në lartësinë 2050 mnd. Ka një gjatësi rreth 300 m dhe gjerësi maksimale 200 m.
- **Traditat kulturore.** Zona e Tropojës shquhet për traditat e mikpritjes, gatimet e veçanta, arkitekturën tradicionale, veshjet popullore, këngët dhe vallet, ritet që përbëjnë një aset të çmuar krahas vlerave të natyrës.





Rëndësia pse duhet të mbrohet: Shpatet gëlqerore të luginës janë mjaft të rëndësishëm, sidomos ato me vegetacion hazmofitik ku spikat Lulekambana Shqiptare dhe Ramonda e Serbisë. Gjithashtu, lugina e ‘Lumit të Tropojës’ është mjedisi i rritjes së disa specieve të rralla dhe të rrezikuara. Në pjesën më të ngushtë të Luginës ku edhe pylli i Ahut merr jetë, gjendet *Locuss classicus* i species Lunare e Telekit (*Lunaria telekiana*). Speciet më të rëndësishme të rralla ose të mbrojtura nga direktiva e habitateve të Lumit të Tropojës janë: *Campanula albanica*, *Lunaria telekiana*, *Sempervivum kosaninii*, *Narthecium scardicum*, *Ramonda serbica*, *Aconitum lamarckii*, *Aconitum pentheri*, *Crepis bertiscea*, *Hieracium waldsteinii*, *Bruenthalia spiculifolia*, *Geum bulgaricum* dhe *Campanula scheuchzeri* etj.





Udhërrëfyes për në zonë

Lugina e Tropojës nuk paraqet shumë vështirësi për tu vizituar. Në fundin e luginës në fshatin Myhejan (Njësia Administrative Tropojë) fillon rruga e makinës e cila duke përshkuar të gjithë luginën e Tropojës përfundon në krye të saj në bjeshkët e Sylbicës. Në qafën e Dobërdolit ndahet me luginën e Gashit (bjeshkët e Dobërdolit). Rruga vazhdon edhe me tej drejt bjeshkëve të Dobërdolit për në fshatin Çerem dhe luginën e Valbonës. Por ai segment rrugor (nga qafa e Dobërdolit deri në Çerem) është në kushte shpesh herë të pa kalueshme. Rruga Tropojë (Myhejan)-Sylbicë nuk është në gjendje shumë të mirë por kalohet me vështirësi. Për ta aksesuar si rrugë duhen mjete të mëdha. Rruga është e kalueshme vetëm në periudhën e verës pasi në periudhat e tjera të vitit nuk mirëmbahet dhe është e bllokuar.




Figura 14. Drejtimi kryesor për në Luginën e Tropojës


Rruga për deri në qendër të Nj.Adm. Tropojë (Tropojë e vjetër) është e mirë dhe kalohet me vetura. Ndërsa për të lëvizur nga Tropoja drejt luginës së Tropojës dhe më tej drejt Sylbicës duhen mjete të mëdha.

Curraj i Epërm

Skeda e zonës

Qarku	Kukes
Bashkia/Nj.Ad.	Tropojë/ Lekbibaj
Ekonomia pyjore	Curraj i Epërm
Fshati	Curraj i Epërm
Emri popullor i zonës	Mbi Curraj të Epërm, Plá
Autoriteti menaxhues	Bashkia Tropojë
Vendndodhja gjeografike	Veriu 42°21'42.29"N dhe Lindja = 19°51'39.58"
Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> - Sipërfaqja me pyje të vjetër Ahu = 1644.1 ha - Zonë buferike = 895.8 3 ha - Sipërfaqja totale = 2539.9 ha
Infrastruktura rrugore në zonë	Zona nuk ka rrugë automobilistike, por vetëm rrugë këmbësore. Vendi më i afërt me rrugën auto është fshati Peraj
Rrugët automobilistike për të aksesuar zonën	Tirana, Kukësi, Prishtina
Aksesi në rrugë këmbësore	Nga fshati Peraj deri në Curraj i Epërm është 10 km, ose 3 orë në këmbë. Distanca Curraj i Epërm - zona me pyje të vjetër Ahu është 5.5 km, 1.5-2 orë
Vlerat kryesore të zonës	<ul style="list-style-type: none"> - Pyjet e vjetër me Ah dhe Rrobull. - Peizazhi unik i zonës. - 42 lloje të florës dhe faunës, pjesë e librit të kuq të IUCN dhe Shqipërisë. - 42 maja me lartësi mbi 2000 mnd. - Tradita kulturore unike - 4 Monumente natyre dhe një kulture
Reziqet kryesore	Zjarret, prerja e drurëve, gjuetia, erozioni
Statusi aktual i mbrojtjes	Nuk ka asnjë mbrojtje ligjore për momentin
Zonë potenciale për:	<ul style="list-style-type: none"> o Ëlderness Europe o Park Natyror Bashkiak

SHKALLA 1 : 50 000




Shpjeguesi




Triasik i Sipërm. Gëlqerorë me megalodonte, gëlqeror stromatolitikë, dolomite



Triasik i Mesëm i Sipërm. Gëlqerorë të zinj me silicorë



Ladinian. Gëlqerorë algorë, gëlqerorë me gastropodë, dolomite



Curraj i Epërm
 Drawn By: ELSON HALIMAJ
 Checked By: ABDULLA DUKU
 Date: 05-04-2018



1:15,000
 Sheet No. 1

Coordinate System: UTM
 Projection: UTM
 Zone Number: 32Q
 False Easting: 500,000.0000
 False Northing: 0.000000
 Zone Factor: 0.999600
 Units: Meter

Legend/Legjenda
Curraj i Epërm
Zone/ Zona
 Core zone/ Zone qendrore
 Buffer zone/ Zone buferike



"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"



Curraj i Epërm
 Drawn By: ELSON HALIMAJ
 Checked By: ABDULLA DUKI
 Date: 05-04-2018

1:15,000
 Sheet No. 2

Coordinate System: UTM
 Zone: 38N
 Projection: UTM
 Datum: WGS 1984
 Spheroid: Everest
 Prime Meridian: 0
 False Easting: 500,000.0000
 False Northing: 0.000000
 Zone Factor: 0.999600
 Units: Meter
 Units Used in Diagram: 0.0000

Legend/Legjenda
Curraj i Epërm
Zone/ Zona
 Core zone/ Zone qendrore
 Buffer zone/ Zone buferike



"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Rruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"





Përshkrimi i zonës

Curraj i Epërm bën pjesë në Njësinë Administrative Lekbibaj, bashkia Tropojë. Shtrihet në pjesën qendrore të Alpeve shqiptare në shpatet jugore të tyre. Aktualisht përbën një ndër fshatrat më të izoluar të vendit. Lekbibaj njihet edhe me emrin Nikaj-Mërtur, dy fiseve kryesore që kanë populluar zonën; Nikaj dhe Mërturi. Përfaqëson një luginë të vogël me shtrirje veri-jug, ujrat e së cilës derdhen në liqenin e Komanit. Pyll i vjetër i Ahut shtrihet brenda Parkut¹⁶ (të propozuar) Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur dhe vendoset midis lartësive 900-1700 mnd i gjithi mbi substrate gëlqerore.

Pellgu i Nikaj-Mërturit dhe malet përreth formojnë njësinë më të madhe të Alpeve Lindore dhe një nga më të mëdhatë, më të lartat dhe më madhështoret e kreu Alpeve Shqiptare. Kjo njësi shtrihet midis luginës së Valbonës në veri dhe lindje, luginës së Drinit në jug dhe luginës së Shalës në perëndim, me një gjatësi veri-jug prej rreth 30 km, dhe gjerësi lindje-perëndim rreth 24 km. Harku i fuqishëm malor, që ka trajtën e një amfiteatri vigan nis me koren e Mërturit (1758 m), qafën e Kolçit (1260 m), ngrihet menjëherë në Shtyllën e Grisë (2095m), duke kulmuar në majën e Hekurave (2559.5 m). Në majën e Hekurave vargmali ulët serish në Qafën e Droçkës (2108 m), vazhdon drejt majës së Gavanit (2505 m), dhe tek grykat e Hapta (2625 m) duke zbritur për në Majën e Brijasit (2529.4 m) merr drejtimin lindje-perëndim duke kaluar nëpër majën e Zhapores (2561 m) dhe Suka e Zhapores (2337 m). Në majën e Boshit (2416 m) vargmali kthehet drejt jugut, duke ruajtur lartësitë e mëdha si Maja e Kakisë (2359 m), Ndërmajat (2250 m), Maja e Ershelit (2066 m). Pellgu ka një shtrirje vertikale nga 170 m në liqenin e Komanit deri në Majën e Grykave të Hapta (2625 m), me një altitudë që shkon në afro 2400 m.

Zona e Nikaj-Mërturit rrethohet nga rreth 42 maja malesh me lartësi mbi 2000 mnd. Nga pikpamja e natyralitetit Curraj i Epërm përfaqëson një zonë pyjore fare pak të shqetësuar

¹⁶ Në vitin 2014 zona me pyje të vjetër është propozuar si zonë qendrore e Parkut Natyror Rajonal “Nikaj-Mërtur” (kategoria e IV), propozim ky ende i pa miratuar nga MTM.

nga njeriu për shkak të mungesës së rrugës automobilistike dhe largimit të popullsisë nga zona. Në disa zona vërehen sipërfaqe me drurë të rinj, pasojë e dukurive natyrore në zonë (rrëzime drurësh nga era, bora etj.

Lloji kryesor në zonë është Ahu i cili ndërthuret me Rrobullin në disa zona, por më së shumti në pjesët e sipërme të brezit pyjor.

Lartësia e luginës ku janë vendosur pyjet e vjetër të Ahut varion nga 930 m mbi nivelin e detit në pjesën e poshtme të saj, deri në 1800 m në pjesën e sipërme të brezit pyjor.




Si kudo tjetër ku shtrihen pyjet e Ahut, tokat janë të murrme pyjore. Mbi lartësinë 1700 m vendosen tokat livadhore malore (brezi i kullotave Alpine) ku dominon bimësia barishtore.

Në kuadër të projektit CABRA¹⁷ zona e Nikaj-Mërturit është propozuar për tu shpallur si Park Natyror Rajonal¹⁸ (kategoria IV). Në këtë kuadër është hartuar Plani i Menaxhimit (2014) i cili ende nuk është miratuar. Zona ku shtrihen pyjet e vjetër të Ahut janë përfshirë në Zonën Qendrore të Parkut të propozuar.

Plani i Menaxhimit për parkun e propozuar nuk është i miratuar ende, dhe për pasojë zona aktualisht nuk ka ndonjë status të veçantë mbrojtës.

Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut

Struktura e moshës së pyjeve të Ahut, bazuar në të dhënat e planit të inventarizimit të ekonomisë pyjore “Curraj Epërm” jepet në grafikun në vijim;



Grafiku 11. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë “Curraj Epërm”


17 Projekti I GiZ ‘Conservation of the Agro-biodiversity in Rural Areas of Albania’ – CABRA i mbështetur nga qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GOPA (Gjermani) dhe Diava Consulting (Shqipëri).
 18 Sipas ligji 81/2017 për “Zonat e mbrojtura”, neni 24 - emertimi është Park Natyror Bashkiak.

Grafiku tregon se;

- Në zonë ka një n/parcelë pyjore me moshë 180 vjeçare
- 14 n/parcela janë me moshë 120-140 vjeçare
- 14 n/parcela janë me moshë 100-120 vjeçare

Nga matjet e bëra në vitin 2016, nga 32 drurë të analizuar në Curraj të Epërm, kanë rezultuar 4 drurë me moshën 251-300 vjeç, dhe 4 drurë me moshën 301-350 vjeç. Ky është një fakt i rëndësishëm lidhur me moshën e drurëve të zonës dhe tregues i natyralitetit të saj.

Grafiku i shpërndarjes së sipërfaqes pyjore sipas klasave të moshës jepet në vijim;



Grafiku 12. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, "Curraj i Epërm"

Nga grafiku vërehet se sasia e pyjeve të vjetër me moshë mbi 120 vjeçare është rreth 40% e sipërfaqes së përgjithshme me pyje Ahu. Por është e nevojshme që të bëhen hulumtime të mëtejshme në drejtim të vlerësimit të moshës së pyjeve të kësaj zone pasi të dhënat në nivel n/parcelle nuk mjaftojnë.

Gjeologjia dhe hidrogeologjia

Curraj i Epërm është pjesë e zonës së Alpeve Shqiptare dhe në të kanë përhapje shkëmbinjtë terigjeno-karbonatikë, gëlqerorë dhe dolomite. Këto lloje shkëmbore janë të lidhura me moshën *Triasike* (*Anazinian*, *Ladinian* dhe *dhe triasik i sipërm*). Shkëmbinjtë me moshë më të re në këtë zonë janë depozitimet në terracat e vjetra lumore, të cilat kanë përhapje të kufizuar dhe trashësi të vogël.

Thuajse në gjysmën e zonës Curraj i Epërm, në veri të lumit të Pajës, kanë përhapje shkëmbinjtë me moshë *Triasik i mesëm*. Ato përfaqësohen kryesisht nga gëlqerorë pa shtresëzim (masivë). Këto shkëmbinj kanë tashësi që luhatet nga 200-500m.



Shkëmbinjtë terrigjeno-karbonatikë dalin në sipërfaqe në anën juglindore të kësaj zone dhe kanë përhapje të kufizuar. Në pjesën e poshtme këto shkëmbinj kanë një shtresë konglomeratike me copa ranorësh, gëlqerorësh e më rrallë silicorësh që shëndrrohen më lart në terrigjeno-karbonatike dhe ndërtohen nga ndërthurje e rreshpeve argjilore me gëlqerorë. Në pjesën jugore të zonës Curraj i Epërm kanë përhapje të gjerë shkëmbinj mergelorë shtresë hollë, e sipër tyre vendosen shkëmbinj gëlqerorë e dolomite të *Triasikut të sipërm*.

Historia e zhvillimit gjeologjik në Curraj i Epërm është e lidhur me një pjesë të periudhës *Triasike* nga 260 deri në 245 milion vite më parë kur filluan të depozitohen në detin e asaj kohë terigjene e kryesisht sedimente karbonatike. Pas kësaj periudhe zona i është nënshtruar veprimtarisë rrudhosëse e shkëputëse gjatë dy fazave tektogjenezash, që së bashku me veprimtarinë e faktorëve të jashtëm gjatë periudhës *Kuaternare*, 2 milion vite më parë e sot, i kanë dhënë relievit të saj një karakter klasik alpin me lugina të thella e maja të larta (mbi 2000 m), duke e modeluar atë në pamjen që ka sot.

Hidrografia

Pavarësisht nga një nivel i lartë i reshjeve vjetore, zona vuan nga thatësira gjatë çdo sezoni të verës. Gjeologjia nëntokësore e ndërtuar nga gëlqerorë, është pjesë e formimit karstik të harkut Dinarik që karakterizohet nga pamundësia për të mbledhur dhe për të mbajtur ujë. Në zonë ka dy lumenj të përhershëm; lumi i Currajt dhe ai i Nikajt. Të dy këta lumenj të vegjël bashkohen në Currajt e poshtëm dhe formojnë lumin kryesor të zonës që është lumi i Currajt, me një gjatësi rreth 19 km dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 145 km². Lumi i Nikajt fillon në burimet e Vranës ndërsa ai i Currajt fillon me burimet e shpellës së Drelës që shtrihet ndërmjet majave të Kakisë dhe Boshit. Ushqimi kryesor i këtyre lumenjve dhe burimeve në zonë e përbëjnë reshjet e borës dhe ata të shiut si dhe burimet karstike.



Zona përshkohet nga disa përrenj të vegjël si ; Zojkut, Boshit, Marashit të cilët formojnë pjesën e sipërme të lumit të Pajës (Plaja) dhe me poshtë të Currajt.

Në Curraj i Epërm drenojnë 4 burime me ujëra nëntokësorë me prurje të përgjithshme $2.41\text{m}^3/\text{s}$. Dy nga këto burime kanë prurje mesatare vjetore të mëdha, mbi $1\text{ m}^3/\text{s}$ secili. Zona është pjesë e akuiferit karstik të njohur të Alpeve Shqiptare. Në këtë zonë, që përfaqëson një rast akuiferi tipik karstik, dukuritë karstike janë të shprehura me praninë e gërryerjeve të relievit, me puse, hinka, shpella, e forma të tjera karstike.

Ujërat e burimeve kanë cilësi të mirë. Burimet lidhen me porozitetin çarje-karst të formuara nga tretja e shkëmbinjve gëlqerorë. Karakteristikë e tyre është se dalin në kuota të relativisht të larta 900 deri në 1200 mnd, kanë temperatura të ulta rreth $5\text{ }^\circ\text{C}$, fortësi të përgjithshme të ulët rreth 5 dH dhe gjithashtu mineralizim të përgjithshëm të ulët, rreth 150 mg/l .

Habitatet kryesore në zonë

Edhe pse një zonë e vogël dhe mjaft e izoluar Nikaj-Mërturi përfshin pothuajse diversitetin e plotë të peizazheve dhe ekosistemet e territoreve veriore malore të Shqipërisë. Për shkak të shtrirjes vertikale të territorit me mbi 2400 metra zona përfaqëson një shumëllojshmëri drurësh dhe bimësh. Më të veçanta janë ato të pyjeve të vjetër të Ahut dhe Rrobullit;

91K0 Pyje llirike me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion). Ky habitat përbën një nga habitatet më të pastra me Ah që ndodhen në vendin tonë për shkak se nuk përzihet me tipe të tjera habitatesh, përjashtuar vetëm kufirin ndarës të tij me Rrobullin në lartësitë 1500-1700 m të shpateve të anës së djathtë të rrjedhës së lumit. Përgjithësisht i gjithë masivi i Ahut ruhet në gjendjen e natyrore. Struktura fitocenologjike e habitatit të Ahut është pothuajse

e njëjtë me atë të Luginës së Gashit, Livadhit të Harushës dhe Lumit të Tropojës duke u dalluar vetëm në disa shoqërime bimore të cilat nuk hasen në zonat e përshkruara më sipër. Në habitatin e Ahut takohen shoqërimet *Fagus sylvatica-nudum* ose shoqërimet e tij me *Sanicula europaea* dhe shoqërimet me *Oxalis acetosella* ose *Luzula sylvatica*.

Në habitatin Pyje Ilirike me *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion) hasen këto specie treguese: *Acer pseudoplatanus*, *Populus tremula*, *Sorbus aucuparia*, *Rubus ideaus*, *Rhamnus alpinus*, *Lonicera alpigena*, si dhe kati barishtor i tij me *Asperula odoratum*, *Allium ursinum*, *Anemone nemorosa*, *Brachypodium pinnatum*, *Brachypodium sylvaticum*, *Cardamine enneaphyllos*, *Fragaria vesca*, *Hepatica triloba*, *Lamiastrum galeobdolon*, *Oxalis acetosella*, *Luzula sylvatica*, *Prenanthes purpurea*, *Oxalis acetosella*, *Solidago virgaurea* etj.

Habitatet e tjera në zonë;

3240 *Lumenj alpinë dhe bimësia e tyre drunore me Salix elaeagnos.*

Përgjatë shtratit të lumit rriten formacione shelgjesh (*Salicetum eleagni*), të dominuara nga *Salix elaeagnos*, të cilat janë strehë e insekteve, kryesisht efemerpterë si dhe e species relikte të post akullnajave, Klokëza lulegjatë (*Heliosperma macrantha*). Trofta e malit (*Salmo trutta fario*), si edhe disa lloje të tjerë peshqish janë gjithashtu elementë të rëndësishëm të faunës ujore të lumit.

4060 *Shqipishte alpine dhe të borealit.*





8210 *Shpate shkëmbore gëlqerore me vegjetacion hasmofitik.*

Shpate shkëmbore gëlqerore me vegjetacion hasmofitik banohen nga *Amphoricarpus autariatus*, *Asperula doerfleri*, *Campanula albanica*, *Omalotheca pichleri*, *Petasites doerfleri* dhe *Wulfenia baldaccii* etj.

9150 *Pyje Ahu Medio-Europiane* mbi gëlqerorë të aleancës *Cephalanthero-Fagion*, përbën një habitat i cili përfshihet në Pyjet Ilirike të Ahut në të cilën dominojnë specie e *Brachypodium pinnatum*, *Carex flacca*, *Carex montana*, *Sesleria albicans* dhe *Cephalanthera rubra* dhe *Neottia nidus-avis*. Në kufirin ndarës me kullotat alpine, habitat i Ahut paraqitet i copëzuar, ku çeltrirat kullosore depërtojnë më në

brendësi të tijë. Sipërfaqet dhe të çarat shkëmbore, bashkë me bimësinë dhe florën e shtratit lumor ose të faqeve shkëmbore përgjatë tij, përbëjnë habitate të tjera të rëndësishme brenda habitatit me Ah në Curraj të Epërm.

Nikaj-Merturi përfaqëson një seri të plotë të peizazheve tipike të Alpeve Shqiptare, duke përfshirë të gjitha format e peizazheve dhe formave tipike të përdorimit tradicional të tokës.



Vlerat kryesore të zonës

- **Zona me pyje të vjetër Ahu.** Është një ndër masivet e pakëta me pyje të vjetër Ahu që gjenden aktualisht në Shqipëri. Pyjet e Ahut paraqiten thuajse në gjendjen e tyre natyrore, me drurë të vjetër, të tharë, rrëzuar, kalbur etj. si dhe drurë të rinj. Ka rezultuar se zona ka drurë me moshë 251-350 vjeçare.
- **Prania e llojeve** të rëndësishme pyjore si; Ahu dhe Rrobulli.
- **Peizazhi unik** i zonës, rrethuar nga rreth 42 maja malesh mbi 2000 mnd në një sipërfaqe mjaft të vogël. Zona përfaqëson një ndër peizazhet më të bukura të vendit, ku kombinimi i liqenit të Komanit me majat më të larta të alpeve Shqiptare bashkohen pikërisht në Nikaj-Mërtur. Zona i ngjan një amfiteatri gjigand duke filluar me majat më të larta të maleve në veri dhe duke përfunduar poshtë në jug, në liqenin e Komanit.
- **Vlerat e biodiversitetit.** Për shkak të pranisë së rrallë të aktiviteteve njerëzore, zona paraqitet si një oaz natyror për florën dhe faunën e vendit. Në vijim jepen të dhëna vetëm për llojet e rrezikuara që gjenden në zonë (lloje të rralla, me status mbrojtës dhe që janë pjesë e listës së kuqe të Shqipërisë dhe IUCN).

Flora; 18 lloje drurësh, shkurresh dhe bimësh të rrezikuara gjenden në Curraj të Epërm dhe zonën përreth.

Fauna; në zonë gjenden 7 gjitarë, 7 shpendë, 1 amfib, 8 insekte dhe 1 molusk me status të rrezikuar. Zona strehon të gjithë gjitarët e mëdhenj; Ariun, Ujkun, Rrëqebullin, Macen e egër, Derrin e egër, Dhinë e egër etj. Gjithashtu gjendet edhe Shqiponja e malit. Zona përfaqëson në vetvete një njësi mjaft të rëndësishme territoriale sa i përket vlerave të biodiversitetit.





- **Traditat kulturore** të zonës. Traditat e mikpritjes, kuzhina, arkitektura tradicionale, veshjet popullore, ritet dhe zakonet unike të zonës përbëjnë një aset të çmuar krahas vlerave të natyrës. Veçohen; Kënga majë krahu, Gjama e burrave, Eposi i Kreshnikëve etj.

- **Shpellat.** Zona ka një nga komplekset më të mëdha të shpellave në vend. Shpellat më kryesore janë; Bira e zezë, Shpella e Shkamit të Rajës, Drelës, Shpella e Kakverrit

etj. Deri më sot asnjë shpellë nuk është e hapur për publikun dhe ende nuk ka studime të plota shkencore për moshën, formën, shtrirjen, florën dhe faunën e tyre. Deri tani disa shpella si “Bira e zezë” kanë filluar të eksploroehen dhe të përshkruhen paksa. Lloje të veçanta të insekteve, merimangave dhe jo kurrizoret e tjerë, si dhe disa lloje lakuriqësh nate mund të gjenden në ato shpella.

Rëndësia pse duhet të mbrohet: Shpatet gëlqerore të Luginës sidomos ato me vegetacion hazmofitik, ku spikat Lulekambana Shqiptare (*Campanula albanica*) dhe Klokëza lulegjatë (*Heliosperma macrantha*), kurse përreth shkëmbinjve gëlqerorë të pjesës alpine të habitatit janë edhe specie relikte dhe endemike si Vulfenia e Baldaçit (*Wulfenia baldaccii*) dhe Llapua i Dërflerit (*Petasites doerfleri*). Speciet të tjera të rralla ose të mbrojtura nga direktiva e habitateve janë: *Crepis bertiscea*, *Crepis albanica*, *Hieracium waldsteinii* dhe *Geum bulgaricum* etj.

Vlera të tjera natyrore dhe kulturore të zonës

Në Nikaj-Mertur ndodhen katër monumente natyre që janë kategoria e III e zonave të mbrojtura dhe një monument kulture (Kulla e Thepit) të pëshkruar në vijim;

Rrasa e Currajt: Ndodhet në afërsi të fshatit Curraj i Poshtëm, 830 m mbi nivelin e detit.

Burimi karstik i Qereshit: Ndodhet në në luginën e përroit të Qeresh-Mulaj, në lartësinë 930 mnd. Përbën një burim të madh karstik që del në rrëzën e greminës gëlqerore të shpatit jugperëndimor të majës së Alshinës.



Ahishta Gurra e Hasan Gashit (Mërtur). Ndodhet në malin e Mërturit në Alpet Lindore, në lartësinë rreth 1200 mnd. Përfaqëson një pyll Ahu në të cilin drurët kanë lartësi mbi 25 m, diametër të trungut mbi rreth 40 cm.

Shkëmbi i Forcës: Gjendet në afërsi të fshatit Curraj i Epërm 1700 mnd. Përbën një thepisje të linjës së shkëputjes, që në reliev shprehet me një gur gëlqeror, me formë të veçantë (gjysëm harku).

Kulla e ngujimit në Curraj të Epërm:

Gjendet në mes të fshatit Curraj i Epërm pranë urës që bashkon dy anët e lumit Curraj. Ajo është ndërtuar rreth viteve 1840-1850 dhe konsiderohet si njëra nga kullat e gurit më të vjetra në malësitë e veriut. Ndryshe njihet edhe si “Kulla e Thepit”.

Vlera të tjera të zonës janë;

Fshati Curraj i Epërm: përbën një ndër perlat e bukurisë së natyrës shqiptare. I vendosur në një lartësi 800-900 mnd rrethuar nga pyje dhe malet e larta – ndër to maja e Hekurave 2559.5 m, ka një peizazh të pakrahasueshëm. Një ndër figurat e shquara të kombit – Bajram Curri origjinën e tij e kishte nga ky fshat¹⁹. Për momentin Curraj i Epërm është atraksioni kryesor për vizitorët në zonë (kryesisht të huaj). Sipas shumë studiuesve thuhet se origjina e poezisë epike shqiptare, ndër të tjera edhe këngët e Mujit dhe Halilit apo ajo e Gjergj Elez Alisë është zona e Nikaj-Mërturit²⁰.

Liqeni i Komanit: Pavarësisht se është një liqen artificial përfaqëson tashmë një burim të rëndësishëm të faunës ujore, habitateve të vendeve të lagëta, peizazhit dhe njëkohësisht një burim atraksioni për aktivitetet turistike (shëtitjet me varkë) dhe ato të peshkimit.

Lumi i Currajt: Përbën një burim të rëndësishëm ujqor për zonën, ku kthjelltësia e tij nuk prishet edhe në rastin e shirave të rrembyeshëm. Është i rëndësishëm gjithashtu edhe për faunën ujore të tij, ku trofta e mermertë (*Salmo marmoratus*) gjendet ende aty. Gjithashtu lloje të tjera si; Troftë mali (*Salmo trutta fario*), Merenë e egër (*Cobitis taenia*) dhe Mustaku i Lumit (*Oxynoemacheilus pindus*) mendohet se gjenden në ujrat e lumit.

Parqet kombëtare: Nikaj-Mërturi kufizohet me Parqet Kombëtare “Lugina e Valbonës” dhe “Thethi” (kategoria e II).



19 S. Drini – ‘Bajram Curri’, Sh.B. “8 Nentori”, Tirane 1993

20 Frrok Vukaj – “Krenari për vendlindjen”



Udhërrëfyes për në zonë

Curraj i Epërm është fshati më i izoluar në Shqipëri përse i përket aksesit me rrugë makine. Mundësia më e mirë është duke ndjekur rrugën automobilistike Lekbibaj-Peraj. Nga Lekbibaj deri në fshatin Peraj rruga ka një distancë rreth 8 km dhe është në gjendje jo të mirë. Për ta përshkuar atë duhen mjete të mëdha.

Një tjetër mundësi është edhe rruga nga Curraj i poshtëm. Nga të dy këto fshatra rruga për në Curraj të Epërm dhe më tej për tek masivi me pyje të vjetër Ahu bëhet në këmbë. Ndaj në vijim jepen disa referenca për të vizituar zonën deri në afërsi të saj me makinë (qendra e Nj.Adm. Lekbibaj).

Ka disa mënyra për të ardhur në Lekbibaj, sipas akseve rrugore të paraqitura në vijim;

Tabela 7. Akset rrugore për në Curraj të Epërm

Aksi rrugor	Distanca, km	Gjendja e rrugës	Koha për ta përshkuar, orë
Tiranë-Kukës-Has-Tropojë-Lekbibaj	260	Asfalt	5
Tiranë/Shkodër-Vau i Dejës-Fierzë-Lekbibaj*	180/95	Asfalt	5/4
Tiranë/Shkodër-Pukë-Fushë-Arrëz-Fierzë-Lekbibaj	240/165	Asfalt	6/5
Prishtinë-Gjakovë-Lekbibaj**	142	Asfalt	3
*Një pjesë e rrugës (Koman-Fierzë) bëhet me anije. ** Rruga kalon nëpër pikën kufitare të Morinit (Tropojë)			

Rruga deri në Lekbibaj (qendra e Nj.Ad.) është e mirë (e asfaltuar).




Figura 15. Drejtimet kryesore për në Curraj të Epërm

Nga Lekbibaj për të aksesuar pyjet e vjetër të Ahut janë dy drejtime kryesore (në këmbë);


- Duke ndjekur rrugën këmbësore Peraj-Curraj i Epërm, rruga është e gjatë rreth 10 km dhe mund të përshkohet për 3 orë. Kjo përfaqëson edhe rrugën më të lehtë për të aksesuar pyjet e vjetër të Ahut. Me tej ndiqet rruga këmbësore Curraj i Epërm – pyjet e vjetër të Ahut (rreth 5-6 km, 2 orë). Ngjitja vertikale me këtë opsion është rreth 500 m.
- Duke ndjekur rrugën këmbësore nga fshati Curraj i Poshtëm drejt Curraj të Epërm, rruga ka një gjatësi prej rreth 10 km, duhen afro 4 orë për ta përshkuar. Rruga ndjek rrjedhën e lumit të Currajt dhe ka një ngjitje vertikale (deri tek pyjet e vjetër të Ahut) prej 900 m.



Zall-Gjoçaj

Skeda e zonës

Qarku	Dibër
Bashkia/Nj.Ad.	Mat /Derjan dhe Macukull
Ekonomia pyjore	Mbasdejë
Fshati	Zall-Gjoçaj, Vig, Macukull
Emri popullor i zonës	Zall-Gjoçaj, Mbas Deje (mbas Malit të Dejës), Mamusha
Autoriteti menaxhues	Bashkia Mat
Vendndodhja gjeografike	Veriu 41°43'29.36" dhe Lindja = 20° 9'34.54"
Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> - Sipërfaqja me pyje të vjetër Ahu = 792.2 ha - Zonë buferike = 1652.9 ha - Sipërfaqja totale = 2445.1 ha
Rrugët automobilistike për të aksesuar zonën	Në afërsi të zonës (rreth 4 km) ekziston një rrugë (aksi Lurë-Mbasdejë) sezonale e cila mund aksesohet nga Tirana, Burreli dhe Peshkopia
Aksesi në rrugë këmbësore	Distanca më e afërt për të aksesuar zonën është Fusha e Pelave (Lurë), rreth 10 km (2 orë në këmbë). Nga Macuklli distanca është rreth 15 km (3 orë në këmbë).
Vlerat kryesore të zonës	<ul style="list-style-type: none"> - Pyjet më të vjetër me Ah, Bredh, Arne, Pishë të zezë dhe Rrobull që gjenden në Shqipëri. - 48 lloje që janë pjesë e listës së kuqe (IUCN dhe Shqipërisë); 24 lloje të florës dhe 24 lloje të faunës. - Peizazhi unik i zonës. Afërsia me Parkun Kombëtar të 'Lurës' dhe 'Zall-Gjoçaj'. - 5 Maja të larta malesh mbi 2,000 mnd, ku dominon mali i Dejës me lartësi 2,246 mnd. - 3 monumente natyre dhe një monument kulture.
Rreziqet kryesore	Zjarret, prerja e drurëve, HEC-et, gjuetia, mbetjet,
Statusi aktual i mbrojtjes	Nuk ka asnjë mbrojtje ligjore për momentin
Zonë potenciale për:	<ul style="list-style-type: none"> o UNESCO, o Wilderness Europe o Park Kombëtar o Pjesë e Rrjetit Kombëtar të Pyjeve të Vjetër, o Pyje me funksion mbrojtës (Ligji 9385, dt. 4.5.2005, i #)

SHKALLA 1 : 50 000





Legend/Legjenda

- Zall Gjocaj**
Zona e vjetër
 Zona e vjetër
 Zona e re

Coordinate System: UTM
 Zone: 38N
 Datum: WGS 1984
 Spheroid: GRS 1980
 Prime Meridian: Greenwich
 False Easting: 500 000
 False Northing: 0
 Scale Factor: 0.9996
 Zone Number: 38
 Units: Meter



1:22,000
 Sheet No. 1

Zall Gjocaj

Drawn By: ELSON HALILAJ
 Checked By: ABDULLA DMU
 Date: 05-04-2018

"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të ahut në Shqipëri"





Legend/Legjenda

- Zall Gjoçaj**
 Zonë Zonë
 Zonë Zonë
 Zonë Zonë
- Zonë Zonë
 - Zonë Zonë

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
 Projection: UTM
 Datum: WGS 1984
 Area Unit: Square Meter
 Area Scaled: 100,000,000
 False Easting: 500,000,000
 False Northing: 0
 Zone Number: 34
 Zone Polar: S
 Units: Meter
 Units M of Origin: 0,0000
 Units Scale: 1

1:22,000
 Sheet No. 2

Zall Gjoçaj

Drawn By: ELSON HALIMAJ
 Checked By: ABDULLA DUKU
 Date: 05-04-2018

"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të ahut në Shqipëri"





Përshkrimi i zonës

Zona përfaqëson një sipërfaqe të vogël me pyje të vjetër Ahu, Bredhi të bardhë, Rrobulli dhe Pishë të zezë që shtrihet mbi fshatin Zall-Gjoçaj dhe që gjendet në anën veriore të malit të Dejës. Ekonomia pyjore që përfshin pyjet e vjetër të Ahut është “Mbasdeja”. Vetë emërtimi ‘Mbasdeje’ ka kuptimin mbas-Dejës. Deja është një mal me lartësi 2246 mnd dhe që dominon për nga lartësia luginën e Matit në perëndim të tij dhe atë të Drintit në lindje.

Nga pikpamja ekologjike zona përfaqëson një sipërfaqe unike në Shqipëri sa i përket drurëve të Ahut përmasave dhe moshës së tyre. Nga përlogaritjet e bëra për zonën (treguesit e Patërsonit), rezulton se kushtet e stacionit pyjor në Zall-Gjoçaj kanë potencial për rritjen e pyjeve me një vëllim mesatar drunor prej 500-600 m³/ha. Kushtet ekologjike të zonës e kanë bërë atë unike sa i përket sasisë së vëllimit të lëndës drunore për hektarë duke arritur në nivelet e 600 m³/ha në pyjet e Ahut në moshën 180-200 vjeçare, 650 m³/ha për pyjet e Ahut me Bredh të bardhë në moshën 180-200 vjeçare, 823 m³/ha për pyjet e Pishës së zezë me Ah në moshën 100-120 vjeçare.

Të dhënat e mësipërme e bëjnë sipërfaqen pyjore të kësaj zone më uniken dhe më të rëndësishmen për Shqipërinë për shkak të potencialit të lartë ekologjik që ofrojnë kushtet e tokës dhe klimës aty. Zona ku ndodhen pyjet e vjetër të Ahut ka formën e një pllaje me pjerrësi drejt veriperëndimit. Zona fillon në pjesën jugperëndimore të fshatit Zall-Gjoçaj dhe shtrihet drejt jugut duke u kufizuar nga ana perëndimore e tij me masivin shkëmbor të Malit të Dejës. Zona ka një shtrirje më të gjerë nga ana e malit të Dejës. Kundrejtimi i përgjithshëm i sipërfaqes me pyje të vjetër Ahu është verior. Sipërfaqja me pyje të vjetër Ahu ndodhet rreth 300 metra mbi fshatin Zall-Gjoçaj në një lartësi mesatare 1400 m mbi nivelin e detit.

Bazuar në gjendjen aktuale të pyjeve (struktura, përbërja, ripërtëritja, forma e trungut dhe kurorave), procesi i eliminimit natyror të drurëve paraqet një situatë tërësisht natyrore të grumbullit pyjor. Nisur nga kjo pyjet e vjetër të Ahut si dhe disa sipërfaqe të vogla me pyje tjera (Rrobulli) mund të thuhet se kanë arritur në gjendjen e tyre *klimaks*.



Lugina e Zall-Gjoçajt në fillimin e saj është shumë e gjerë dhe grumbullon të gjithë ujrat mbrapa Malit të Dejës. Duke zbritur poshtë drejt perëndimit në fshatin Zall-Gjoçaj lugina fillon ngushtimin e

menjëhershëm të saj. Duke filluar nga fundi i fshatit Zall-Gjoçaj drejt atyre; Lami i Madh, Gjoçaj, Dukagjin e deri në afërsi të Bruçit lugina merr formën e një kanioni të thellë dhe mjaft të ngushtë. Ujërat që vijnë nga Zalli i Gjoçaj përfundojnë në lumin Mat (liqenin e Ulzës).


Tokat janë të murrme pyjore (*Humic Cambisoils*). Profilët e tokave janë të diferencuar mirë sipas horizonteve; A₀, A, B, C. Vlera e pH luhatet në 5.5-6 duke i klasifikuar ato si pak acide. Tokat janë të pasura me azot, fosfor dhe kalium. Mbi tokat e murrme pyjore shtrihet brezi i tokave livadhore malore (mbi 1700 m) në të cilën shtrihen kullotat alpine të zonës. Këto toka më së shumti janë të vendosura në anën perëndimore të malit të Dejës dhe më pak në shpatet lindore të tij.

Në jug të zonës me pyje të vjetër Ahu (*Mamusha*), me V.K.M nr.102 datë 15.01.1996 një sipërfaqe prej 140 ha është shpallur Park Kombëtar 'Zall-Gjoçaj' (kategoria II). Parku kombëtar përbëhej nga lloje drunore si; Arneni, Rrobulli, Bredhi i bardhë, Ahu etj. Për shkak të prerjes masive të pyjeve dhe zjarreve të viteve të fundit ky park thuhet nuk ekziston më.



Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut

Të dhënat mbi strukturën e moshës së grumbujve janë marrë nga Plani i Mbareshtimit të Ekonomisë pyjore "Mbasdeje" (2004). Në grafikun në vijim paraqitet struktura e pyjeve të Ahut në masivin pyjor 'Mamusha', Zall-Gjoçaj, ekonomia pyjore "Mbasdeje".




Grafiku 13. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë "Mbasdeje"

Nga grafiku vërehet se në zonë gjenden;

- 5 n/parceta pyjore ku mosha e grumbullit është mbi 250 vjeçare,
- 4 /parceta me moshë 200-250 vjeçare,
- 4 n/parceta me moshë 150-200 vjeçare dhe
- 2 n/parceta me moshë 100-150 vjeçare.

Nisur nga të dhënat e volumit dhe strukturës së moshës së këtyre grumbujve, rezulton se pyjet e Ahut këtu, janë padyshim unike në Shqipëri, duke rezultuar si më të vjetrit që ekzistojnë aktualisht, njëkohësisht edhe si pyjet me volumin më të madh për njësi (ha), në vend.

Përqindja e sipërfaqes pyjore sipas klasave të moshës jepet në vijim;



Grafiku 14. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, "Mbasdeje"

Nga grafiku shihet se 95% e sipërfaqes me pyje të vjetër Ahu në 'Zall-Gjoçaj' janë me moshë mbi 140 vjeçare. Pyjet e Ahut në këtë zonë janë grumbuj shumë të vjetër dhe me strukturë natyrore e të virgjër.

Gjeologjia dhe hidrogeologjia

Zona e Zall-Gjoçajt ndërtohet nga shkëmbinjtë gëlqerorë konglomeratikë e konglomerate, gëlqerorë të dolomitizuar, gëlqerorë shtresorë e pllakorë dhe shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë. Shkëmbinjtë me moshë më të re në këtë zonë janë depozitimet në terracat e vjetra lumore të cilat kanë përhapje të kufizuar dhe trashësi të vogël.

Shkëmbinjtë gëlqerorë konglomeratik të moshës *Kretak i poshtëm* kanë përhapje të kufizuar dhe takohen në pjesën më jugperëndimore të zonës që përkon me anën perëndimore të Malit të Dejës. Ato përfaqësohen nga lloji terrigjeno-konglomeratike dhe karbonatike, që ndryshojnë gjatë shtrirjes përbërjen dhe trashësinë e tyre. Në fillim janë formuar shkëmbinjtë e llojit gëlqerorë konglomeratik, ranore e konglomerate, e më pas shkëmbinjtë gëlqerorë.



Në *Kretakun e sipërm* u formuan shkëmbinj që përfaqësohen nga gëlqerorë shtresë mesëm deri masive të formuara në det të cekët dhe gëlqerorë pllakorë që janë vazhdim i serisë karbonatike të *Kretakut të poshtëm*. Në zonën e Zall-Gjoçaj këto shkëmbinj përhapen në trajtë të një brezi të ngushtë në gjithë pjesën jugperëndimore të saj nga mali i Dejës deri në Melth të Zall Gjoçaj.

Shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë kanë përhapjen më të madhe midis të gjithë llojeve shkëmbore që përhapen në zonën e Zall-Gjoçajt. Ato shtrihen në të gjithë anën perëndimore të zonës, në Mbas-Dejë dhe janë pjesë e masivit ultrabazik të Lurës.

Shkëmbinjtë me moshë më të re (*Kuaternare*) kanë përhapje të kufizuar në formë të germës "V" në skajin veriperëndimor gjatë lumit të Zall-Gjoçaj. Këto shkëmbinj janë të përbërë nga aluvione e proluvione dhe përfaqësohen nga rëra, zhavore e alevrite dhe kanë trashësi të vogël.



Hidrografia

Për shkak edhe të formacioneve shkëmbore që përbëjnë substratin e saj zona është e pasur në burime ujore. Burimi kryesor uhor është ai i përroit të Zall-Gjoçajt. Ky e fillon rrjedhjen e tij në Hurdhën e Thellë tek burimi Gjurma e Ftohtë (burimi më i madh uhor i zonës). Zona ka edhe disa përrenj të tjerë si; Livadhiti të Gjonit, Cidhnakes, Farkës, Bruzhllave, Mamushës, Gjymrajës etj.

Në vijë ajrore zona me pyje të vjetër Ahu (Mamusha) ndodhet rreth 3-5 km larg liqeneve akullnajorë dhe të famshëm të Lurës (liqeni i Luleve 3.4 km, Kallabekes 3.5 km, liqeni i Zi 3.8 km, liqeni i Thatë 4 km, i Hotit 4.8 km etj.)

Në Zall-Gjoçaj drenojnë 3 burime me ujëra nëntokësorë me prurje 0.2 deri në 10 l/s. Këto



burime janë të lidhura me porozitetin dhe çarjet e shkëmbinjve ultrabazikë. Burimi me pruje më të madhe në këtë zonë është burimi në Zallin-Gjoçajt me pruje 10 l/s.

Burimet lidhen me porozitetin çarje të formua kryesisht pas formimit të shkëmbinjve ultrabazikë nga veprimtaria përjruese e tektonike. Ujërat e burimeve kanë cilësi të mirë. Karakteristikë e tyre është se dalin në kuota të larta 1350 deri në 1500 mnd kanë temperatura të ulta që luhaten nga 5.5 në rreth 9 °C, fortësi të përgjithshme rreth vlerës 7.5 dH dhe mineralizim të përgjithshëm rreth 240 mg/l.

Vlerat kryesore të zonës

Disa prej vlerave më kryesore të zonës janë:

- **Zona me pyje të vjetër Ahu dhe Rrobulli.** Zall-Gjoçaj është masivi më i vogël, por njëkohësisht ai që mbart pyjet më të vjetër të Ahut që gjenden në Shqipëri. Pyjet e Ahut paraqiten thujt në gjendjen e tyre natyrore, me drurë të vjetër, të tharë, të rrëzuar, të kalbur si edhe strukturë shumë moshare drurësh. Zona ka gjithashtu drurë mjaft të vjetër me Rrobull. Pyjet me Rrobull janë vendosur kryesisht në rrëzën e malit të Dejës, në shpatet shkëmbore nga ana lindore dhe veriore e tij. Për nga parametrat dendrometrike (lartësia dhe diametri), moshja si dhe volumi për njësi (ha), pyjet e vjetër të Ahut në Zall Gjoçaj janë më uniket dhe më të rëndësishmet në Shqipëri.
- **Prania e llojeve** të rëndësishme pyjore si; Rrobulli, Bredhi, Arneni, Pisha e zezë.
- **Peizazhi unik** i zonës. I vendosur ndërmjet liqeneve akullnajore dhe të famshëm të Lurës dhe Malit të Dejës, zona ka një peizazh të pa krahasueshëm. Mali i Dejës nga ana lindore e tij ngrihet thikë mbi zonën me pyje Ahu, duke ofruar një pamje magjepëse. Mali i Dejës ka një seri majash të larta, të cilat bashkë me atë të Runjës bëjnë 5 maja me lartësi mbi 2000 mnd.





- **Vlerat e biodiversitetit.**

Për shkak të pranisë së pakët të njerëzve, zona paraqitet si një oaz natyror për florën dhe faunën e vendit. Aty gjenden lloje të rezikuara dhe që janë pjesë e listës së kuqe të Shqipërisë dhe IUCN.

Zona ka në total 48 lloje që janë pjesë e listës së kuqe të IUCN dhe Shqipërisë;

Flora; 24 lloje drurësh, shkurrësh dhe bimësh të rralla gjenden në zonë, ndërkohë që Mali i Dejës dhe Zall-Gjoçaj mbeten ende ndër zonat më të pa eksploruara në Shqipëri.

Fauna; në zonë gjenden 8 gjitarë, 12 shpendë, 1 insekt, 2 amfibë dhe 1 molusk. Zona strehon të gjithë gjitarët e mëdhenj që gjenden në Shqipëri; Ariun, Ujkun, Rrëqebullin, Macja e egër, Derri i egër, Dhia e egër, Kaprolli. Për shkak të lartësisë dhe formës së përshtatshme të Malit të Dejës, në zonë gjendet edhe Shqiponja e Malit. Ashtu si dhe zonat e tjera me pyje të vjetër, edhe Zall-Gjoçaj përfaqëson një ndër zonat më të rëndësishme në Shqipëri sa i përket biodiversitetit dhe natyrës sonë.

- **Vlerat kulturore.** Zona ka disa monumente natyre, si dhe vende të rëndësishme të historisë dhe kulturës së vendit. Traditat e mikpritjes, kuzhina, arkitektura tradicionale, veshjet popullore, ritet dhe zakonet unike të zonës përbëjnë një vlerë të shtuar krahas atyre të natyrës.
- **Parqet Kombëtare të “Lurës” dhe “Zall-Gjoçajt”.** Pavarësisht se të dëmtuar shumë nga prerjet dhe zjarret masive të viteve të fundit, sërish dy parqet vazhdojnë të ruajnë ende pjesë nga peizazhet unike dhe më mahnitese që mund të ekzistojnë. Pikerisht këto dy parqe, që ndodhen në afërsi, ja shtojnë edhe më shumë vlerat natyrore zonës me pyje të vjetër Ahu. ‘Zall-Gjoçaj’ përfaqëson gjithashtu një ‘ishull’ të izoluar të natyrës floristike të vendit tonë.

Rëndësia pse duhet të mbrohet: Zall-Gjoçaj ka një pozicion mjaft strategjik për shkak të vendosjes së tij thuasje në zonën qendrore të vendit. Në këtë mënyrë habitati i Ahut në Zall-Gjoçaj, përbën një korridor të rëndësishëm në afërsi të Parkut Kombëtar të Lurës, dhe si i tillë, mbrojtja e tij siguron vazhdimësinë e habitateve dhe një rrugë kalimi të sigurtë të shpendëve dhe gjitarëve nga lindja drejt perëndimit dhe nga veriu drejt jugut të vendit, dhe anasjelltas.

Habitatet kryesore në zonë

Pyjet e Ahut të Shqipërisë Lindore, klasifikohen si vazhdim i pyjeve të Evropës qendrore. Për këtë arsye, më e saktë do të ishte përfshirja e tyre nën kodin **91W0**, ose si *Pyje ahu Moesianë*. Prandaj pyjet e Ahut në Zall-Gjoçaj dhe Rrajcë po përfshihen në kodin 91W0.

Klasifikimi sintaksonomik

Querco-Fagetea Br.-Bl. et Vlieger in Vlieger 1928

Fagetalia sylvaticae Pawtowski et al. 1928

Doronico orientalis-Fagion (Raus ex Bergmeier 1990) Dierschke 1997

Doronico columnae-Fagenion Dzëonko et al. 1999

Asyneumo pichleri-Fagetum (Em 1961) Dzwonko et al. 1999 corr. Matevski

91W0 *Pyje Ahu Moesianë*. Pyjet me Ah në zonën e Zall-Gjoçaj, mbulojnë kryesisht sipërfaqet në rrëzë të Malit të Dejës, ose më saktë në veri-lindje të këtij mali. Speciet dominuese të këtij habitati janë *Fagus sylvatica*, *Acer pseudoplatanus*, *Fragaria vesca*, *Oxalis acetosella*, *Fagus sylvatica*, *Luzula luzuloides*, *Luzula sylvatica*, *Calamagrostis arundinacea*, *Prenanthes purpurea*, *Orthilia secunda*, *Daphne mezereum*, *Galium odoratum*, *Cardamine bulbifera*, *Lamium galeobdolon*, *Mercurialis perennis*, *Symphytum tuberosum*, *Sanicula europea*, *Hieracium bifidum*, *Saxifraga rotundifolia*, *Lonicera alpigena* ssp. *formanekiana* dhe *Allium ursinum*.





Shoqërimet kryesore të ahut në këtë habitat janë: *Fagetum subalpinum scardo-pindicum* dhe *Asperulo-Fagetum*.

Me mjaft rëndësi, për këtë zonë janë edhe habitatet rrethuese të ngastrave me Rrobull dhe Pishë të zezë.

Formacionet kryesore të pyjeve në zonë janë;

- **Pyjet me Ah** (*Fagetum sylvaticae*). Shpesh herë formojnë pyje të pastër (homogjene), vetëm me llojin Ah. Në disa raste të tjera, Ahu dominon sërish si lloj kur gjendet i përzier me lloje të tjera si psh me Bredhin e bardhë, Pishën e zezë dhe Rrobullin. Pyjet e pastër me Ah dhe pjesën më kryesore të grumbullit me pyje të vjetër Ahu e gjejmë në vendin e quajtur “Mamushë”.



- **Pyje me Pishë të zezë** (*Pinetum nigrae*). Gjenden në periferi të pyjeve të Ahut, kryesisht në anën veriore të tyre. Këto përfaqësojnë pyje të dëmtuara për shkak të zjarreve të rëna dhe prerjeve. Në disa n/parcела pyjore, pisha gjendet e përzier me Ahun, por edhe lloje të tjera (dushqet, Rrobullin etj.).
- **Pyje me Bredh të bardhë** (*Abietum albae*). Shtrihen në një sipërfaqe të kufizuar, kryesisht në anën jugore të masivit me pyje të vjetër Ahu. Këto pyje formojnë grumbuj të përzier me Ahun, Pishën e zezë, dhe më pak me Rrobullin.
- **Pyjet me Rrobull** (*Pinetum leucodermis*). Gjenden në formën e grumbujve të thjeshtë, ose të përzier me lloje të tjera (Ahun, Pishën e zezë, dushqet etj.). Gjenden përreth masivit me pyje të vjetër Ahu, si dhe në shpatin lindor të Malit të Dejës, në pjeset më të thepisura të tij.
- **Pyje me Arnen** (*Pinetum peuceae*). Kanë një shtrirje të kufizuar në zonë, më shumë në formë drurësh apo grupe drurësh, si dhe të përzier me lloje të tjera pyjore.



Shoqërimet kryesore pyjore në zonë janë;

- *Asperulo-Fagetum*. Me llojet; *Fagus sylvatica*, *Pinus leucodermis*, *Pinus peuce*, *Abies Alba*, *Asperula odorata*, *Oxalis acetosella*.

- *Fageto-Pinetum leucodermis*. Përfaqësohet nga sipërfaqe me dominancë të *Pinus leucodermis*, kryesisht në shpatet lindore dhe të pjerrëta të malit të Dejës.

- *Daphno-fagetum*. Elementet fitosociologjikë këtu janë; *Fagus sylvatica*, *Daphne mezereum*, *Micelis muralis*, *Euphorbia amygdaloides*, *Abies alba* etj. Për shkak të dëmtimeve, në zonë janë shfaqur *Erica herbacea*, *Scabiosa atropurpurea*, *Stachys germanica*, *Thymus longicaulis* etj.

- *Pinetum leucodermis patuletorum*. Përfaqëson një shoqërim pyjor të vendosur në shpatet e pjerrëta, domnuar nga *Pinus leucodermis*.

- *Erico-Pinetum*. Llojet më kryesore të këtij shoqërimit janë; *Pinus leucodermis*, *Pinus peuce*, *Pinus nigra*, si dhe lloje të tjera shoqëruese si; *Erica herbacea*,

Juniperus communis ssp nana, *Daphne oleoides*, *Brachypodium sylvaticum*, *Festuca tenuifolia*, *Asperula aristata*, *Thymus preacox* etj.

- *Erico-Pinetum mixtum*. Llojet karakteristike janë; *Pinus nigra*, *Erica herbacea*, *Juniperus communis*, *Daphne oleoides* etj.

- *Gensito – Pinetum leucodermis*. Përfaqëson një shoqërim tipik shqiptar me bimën endemike *Genista hasertiana*, dhe që shoqërohet me llojet; *Pinus leucodermis*, *Juniperus oxycedrus*, *Erica herbacea*, *Daphne oleoides*, *Festuca gigantea*, *Festuca tenuifolia*, *Potentilla micrantha*, *Thymus preacox*.



- *Festucpos – Pinetum leucodermis*

- *Quercu-Frainetum*. Përfaqësohet nga pyje të trajtuara si cungishte (prodhim dru zjarri dhe kullotje). Llojet më kryesore janë; *Quercus cerris*, *Carpinus orientalis*, *Juniperus oxycedrus*, *Acer obtusatum*, *Fraxinus ornus*, *Colutea arborescens* etj.

- *Quercetum trojanae*. Vendoset në terrene të degraduara dhe paraqitet si stad i degradimit të pyjeve me Qarr dhe Shparth (*Quercus frainetum* Q. *Cerris*) - stadi klimaks i tyre.

Vlerat natyrore dhe kulturore të zonës

Në zonë ndodhen disa monumente natyre (kategoria e III);

1. *Kepi i Skënderbeut Varosh*. Gjendet në Mbasdejë, në afërsi të fshatit Vig, 800 mnd. Njihet edhe me emrin Kalaja e Skënderbeut. Përbën një gur gëlqeror, me formë të veçantë, afërsisht formën e një kërpudhe dhe është pasojë e veprimit të agjentëve të jashtëm atmosferik dhe atyre tektonik. Legjenda e lidh me Skënderbeun, që e ka përdorur atë si pikë vrojtimi.
2. *Maja e Boshtrës (Macukull)*. Ndodhet në afërsi të fshatit Macukull në Mat, 1118 mnd. Përbën një gur ranor me moshë tortoniane, me formë të veçantë (piramidale), i formuar nga proceset e erozionit dhe era. Është i gjatë deri në 900 m, 500 m i gjerë dhe 100 m i lartë.
3. *Tisat e Mbasdejës*. Ndodhen në afërsi të fshatit Vinjoll, Nj.Ad. Lis e bashkisë Mat, 1500 mnd. Përbën një grup drurësh Tisi **që rrezikohen të zhduken, me trung dhe kurorë të veçantë (piramidë)** me lartësi 10-13 m, diametër 18-20 cm, ndërsa mosha 70 vjeçare.
4. *Kalaja e Stelushit*, e shpallur monument kulture (1963), shtrihet në lartësinë 1225 mnd. Ndodhet në fshatin Vig (Nj.Ad. Macukull). Stelushi, mendohet se ka qenë seli e rëndësishme e Kastriotëve. Nga banorët e zonës vendi ku ndodhet kalaja quhej ndryshe edhe Varosh (*Varosh* ka kuptimin – qendër qyteti) ose qyteti i Skendërbeut në Mat.
5. *Fshati Macukull*, përbën një kompleks banesash (kulla) të ndërhuara me mure guri 2-3 katëshe, me arkitekturë tradicionale. Gjithashtu traditat e zonës (mikpritja, bujaria, gatimi, veshjet, këngët, ritet etj) janë unike në vend.



Udhërrëfyes për në zonë

Zall-Gjoçaj është një zonë krejt e izoluar prej rrugëve automobilistike. Për këtë arsye, fshati sot thuhet është i braktisur nga banorët. Vetëm pak familje kthehen në verë për të qëndruar 3-4 muaj në fshat, kryesisht për tu marrë me blegtori. Ndaj dy mundësitë kryesore për të shkuar në zonë janë nga Mati ose nga Dibra.



- Rruga e vetme nga Mati është duke ndjekur aksin rrugor nga fshati Vig (Nj. Ad. Macukull, bashkia Mat) drejt Lurës. Ky është një variant rruge që dikur përdorej nga ndërmarrjet e shfrytëzimit të pyjeve, por që sot është në kushte të mjerueshme. Përveç mjeteve 4x4, rruga është e pa kalueshme për mjetet e tjera. Ky aks është më i vështiri për tu përshkuar, por si distancë është më i shkurtri.
- Nga Dibra zona arrihet duke përshkuar akset që kalojnë nga Lura (Peshkopi-Lurë-Mbasdejë), ndërsa nga Tirana opsioni më i mirë është aksi Rrëshen-Lurë-Mbasdejë;



Tabela 8. Akset rrugore për në Zall-Gjoçaj

Aksi rrugor	Distanca, km	Mjetet për ta përshkuar	Koha për ta përshkuar, orë
Tiranë-Milot-Burrel-Lis- Mbasdejë	145	4x4	5
Tiranë-Milot-Rrëshen-Kurbnesh-Lurë-Mbasdejë	160	4x4	5.5
Prishtinë-Rrëshen- Mbasdejë	270	4x4	7
Peshkopi-Lurë- Mbasdejë	80	4x4	5





Figura 16. Drejtimet kryesore për në Zall-Gjoçaj

Në afërsi të Zall-Gjoçajt, nëse ndiqet rruga Lurë- Mbasdejë, pika më e afërt e rrugës auto me zonën, por dhe më e përshtatshme është fusha e Pelave (Lurë). Nga fusha e Pelave për në zonën me pyje Ahu distanca është rreth 6-7 km dhe duhen 2 orë në këmbë për ta përshkuar. Nëse ndiqet aksi tjetër Vig (Qafë-Murrë) drejt Lurës, vendi më i përshtatshëm është nga Qafa e Tanës, duke ndjekur në këmbë një rrugë që kalon në rrëzë të Malit të Dejës (ana juglindore e tij), drejt masivit pyjor “Mamusha”. Rruga është rreth 5 km dhe përshkohet në këmbë për rreth 1 orë.





Rrajca



Skeda e zonës

Qarku	Elbasan
Bashkia/Nj.Ad.	Përrenjas /Rrajcë
Ekonomia pyjore	Rrajcë
Fshati	Skënderbej
Emri popullor i zonës	Rrajcë, Skënderbej
Autoriteti menaxhues	Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
Vendndodhja gjeografike	Veriu 41°11'45.58" dhe Lindja = 20°31'13.00"
Sipërfaqja	<ul style="list-style-type: none"> - Sipërfaqja me pyje të vjetër Ahu = 1730.0 ha - Zonë buferike = 1025.4 ha - Sipërfaqja totale = 2755.4 ha
Rrugët automobilistike për të aksesuar zonën	Zona aksesohet deri në afërsi (fshati Skënderbej) si nga Tirana ashtu dhe nga Korça
Aksesi në rrugë këmbësore	Distanca më e afërt për të aksesuar zonën është pjesa e sipërme e fshatit Skënderbej, rreth 6 km (1.5 orë në këmbë).
Vlerat kryesore të zonës	<ul style="list-style-type: none"> - Pyjet të vjetër me Ah, Bredh të bardhë, Arnen, dhe Pishë të zezë. - 49 lloje që janë pjesë e listës së kuqe të florës (26) dhe faunës (23) së Shqipërisë dhe IUCN gjenden në zonë. - Pyjet e vjetër të Ahut, pjesë e trashëgimisë Botërore Natyrore të UNESCO-s. - Zona është Park Kombëtar (kategoria e II) - 3 Monumete natyre (kategoria e III)
Rreziqet kryesore	Zjarret, prerja e drurëve, gjuetia, mbetjet
Statusi aktual i mbrojtjes	Rrajca është pjesë e UNESCO-s (2017) Park Kombëtar (kategoria e II), që nga viti 2008
Zonë potenciale për:	<ul style="list-style-type: none"> o Wildernes Europe; o Pjesë e Rrjetit Kombëtar të Pyjeve të Vjetër



Shpjeguesi

- 
Pleistocen - Holocen. depozitime të përziera aluviale - proluviale. rëra, zhavore, alevrite
- 
Triasik i Sipërm - Jurasik i Poshtëm. Gëlqerorë me megalodonte, gëlqeror stromatolitikë, gëlqeror me O.Praecursor, gëlqeror dhe dolomite
- 
Jurasik i Sipërm. Silicorë, apoka e trepele, rreshpe argjilore dhe gëlqerorë
- 
Jurasik i Mesëm. Dunite.



Rajca

Drawn By: ELSON HALIMAJ
 Checked by: ABDULLA DUKU
 Date: 05-04-2018

1:20,000

Sheet No. 1

Coordinate System: UTM
 Projection: UTM
 Zone Number: 38N
 False Easting: 500,000
 False Northing: 0
 Scale Factor: 0.9996
 Units: Meter

Legend/Legendja

Rajca


Zone

Zone sub-zone

Sub-zone



"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"



Rajca

Drawn By: ELSON HALILAJ

Checked by: ABDULLA DUKU

Date: 05-04-2018

1:20,000

Sheet No. 2

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
 Projection: UTM
 Datum: WGS 1984
 False Easting: 500,000.0000
 False Northing: 0.00000000
 Zone Factor: 0.99960000
 Units: Meter

Legend/Legendja

Rajca

Zone Zone

Zone Zone
 Zone Zone



"Preservation and Promotion of the Old Beech Forests in Albania"
"Ruajtja dhe promovimi i pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri"



Përshkrimi i zonës

Pyjet e vjetër të Ahut në Rrajcë janë të vendosur në dy anët e lumit të Bushtricës, i cili buron nga shpatet lindore të malit të Shebenikut. Zona përfaqëson një luginë që shtrihet në kufirin lindor të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë.

Lugina e Rrajcës rrethohet nga dy varqmale të larta; në lindie në kufirin me Maqedoninë rrethohet nga majat e Retit të kurorës (1945.1 m) dhe duke vazhduar drejt veriut në kuotat; 1920.9m, 1857.1m, 1861.7m, 1985m, 1922.5m, Qafa e Koklit (1883.7m), 2029.6m, 2132.2m, Boga e Kuqe (2065.9), ndërsa nga perëndimi lugina kufizohet nga kurrizi malor i Shebenikut (2251.2m) dhe zbret drejt jugut në majën e Fursit (2194m), në kuotën 2086m, maja e Gurit të Pikës 2062.3 m, maja e Lartë (1964 m) etj.



Lugina ka një shtrirje gjatësore në drejtimin pothuajse veri-jug, me pjesën e sipërme të luginës paksa të spostuar nga veriperëndimi dhe fundi i saj drejt juglindjes.

Shebenik-Jabllanica (përshin edhe Rrajcën) është shpallur Park Kombëtar (kategoria e II), me VKM nr. Nr.640, datë 21.5.2008, me sipërfaqe 33,927.66 ha. Pyjet e vjetër të Ahut në Rrajcë u shpallën pjesë e listës së Trashëgimisë Botërore Natyrore të UNESCO-s (2017). Sipërfaqja e shpallur si zonë e UNESCO-s është 2129.52 ha (nga të cilat; pyll =1202.5 ha; kullota =807.27 ha, sipërfaqe ujore =44 ha dhe inproduktive =76 ha), ndërsa zona buferike përreth saj është 2569.85 ha.





Figura 17. Harta e zonës së UNESCO-s, Rrajca

Në këtë drejtim, zona përfaqëson një ndër masivet pyjore dhe peizazhistike më interesante dhe më të vlerësuara nga pikpamja e trashgimisë natyrore që ajo mbart.

Struktura e pyjeve të vjetër të Ahut

Të dhënat për strukturën e moshës së pyjeve të Ahut në Rrajcë, janë marrë nga plani i inventarizimit të kësaj ekonomie pyjore. Planin në raste të tilla jep të dhëna për moshën mesatare të sipërfaqes pyjore në nivel n/parcele, dhe jo për drurë të veçantë.




Grafiku 15. Struktura e moshës së grumbujve pyjorë "Rrajca"

Nga grafiku vërehet se në zonë gjenden;

- 5 n/parcele pyjore me moshë mbi 200 vjeçare dhe
- 14 të tjera me moshën 150-200 vjeçare.

Lidhur me shpërndarjen e sipërfaqes sipas klasave të moshës, grafiku në vijim jep të dhënat përkatëse;



Grafiku 16. Pyjet e vjetër të Ahut sipas moshës dhe sipërfaqes, "Rrajca"

Nga grafiku shihet se 82% e sipërfaqes së grumbujve janë me moshë mbi 120 vjeçare duke i bërë këta pyje një ndër masivet më natyrore dhe më të vjetrat që kemi aktualisht në Shqipëri.

Gjeologjia dhe hidrogeologjia

Rajca ndërtohet nga shkëmbinj gëlqerorë, silcorë, rreshpe argjilore dhe gëlqerore si dhe shkëmbinj magmatikë ultrabazikë. Shkëmbinjtë me moshë më të re në këtë zonë janë depozitimet në tarracat e vjetra lumore të cilat kanë përhapje të kufizuar dhe trashësi të vogël.

Shkëmbinjtë gëlqerorë të *Triasik i sipër-Jurasik i poshtëm* kanë përhapje në trajtën e një brezi të ngushtë nga veriu në jug të zonës. Ato përfaqësohen nga gëlqerorë shtresë trashë, ngjyrë gri, hiri në të zezë dhe rrallë të bardhë. Këto shkëmbinj janë formuar në kushtet e një deti të cekët.

Shkëmbinjtë silicorë e rreshpet argjilore të *Jurasikut të sipërm* ndërtohen kryesisht nga copëra shkëmbinjsh ultrabazikë dhe gëlqerorësh me moshë më të vjetër.

Shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë kanë përhapjen të madhe në anën perëndimore të zonës. Në anën lindore të saj këto shkëmbinj në sipërfaqe shfaqen në trajtë daljesh të veçuara. Këto shkëmbinj janë pjesë e masivit ultrabazik të Shebenikut.



Shkëmbinjtë me moshë më të re (*Kuaternare*) kanë përhapje të kufizuar, kryesisht vendosen në pjesën qendrore të zonës, në të dy anët e lumit Bushtrica. Këto shkëmbinj janë të përbërë nga aluvione e proluvione dhe përfaqësohen nga rëra, zhavore e alevrite dhe kanë trashësi të vogël.

Hidrografia

Për shkak të substratit të saj zona konsiderohet si mjaft interesante sa i përket burimeve ujore. Burimi kryesor uhor është lumi i Bushtricsës. Ky e fillon rrjedhjen e tij tek liqenet akullnajore të Rrajcës (monument natyre, kategoria e III). Ka disa përrenj që e furnizojnë lumin, të tillë janë ai i Kunjtit, Peshkut, Arlirit, Pulës, Gjollit, Shkëmbit të Bardhë etj. Bushtrica bashkohet me lumin Shkumbin në Qukës.

Në distancë ajrore zona me pyje të vjetër Ahu ndodhet rreth 3 km larg liqeneve akullnajorë të Rrajcës, nga liqenet akullnajore të Shebenikut (monument natyre) rreth 4 km larg.



Në Rrajcë drenojnë 4 burime me ujëra nëntokësorë me prurje 0.2 deri në 3 l/s. Këto burime janë të lidhura me porozitetin dhe çarjet e shkëmbinjve ultrabazikë. Burimet me prurje më të madhe në këtë zonë janë burimi në verilindje të majës së Shebenikut dhe burimi në lindje të liqenit të Rrajcës me prurje nga 3 l/s secili.

Burimet lidhen me porozitetin dhe çarjet e krijuara kryesisht pas formimit të shkëmbinjve ultrabazikë, nga veprimtaria perajruese e tektonike. Ujërat e burimeve kanë cilësi të mirë. Karakteristikë e burimeve është se dalin në kuota të larta 1500 deri në 2050 mbi nivelin e detit, kanë temperatura të ulta që luhaten nga 3.2 në 5.5°C, fortësi të përgjithshme të ulët në vlera nga 3 në 3.7 dH dhe mineralizim të përgjithshëm të ulët në vlerat rreth 110 mg/l.

Vlerat kryesore të zonës



- **Pyjet e Vjetër të Ahut.** Që nga Korriku 2017 pyjet e vjetër të Rrajcës janë pjesë e UNESCO-s. Kjo përbën një vlerësim maksimal për vetë vlerat natyrore që ka zona. Nga ana tjetër sipërfaqja në të cilën shtrihen pyjet e vjetër të Ahut, është zonë qendrore e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (kategoria e II). Këtu pyjet e Ahut paraqiten në gjendjen e tyre natyrore me drurë të vjetër, të tharë, të rrëzuar, të kalbur dhe në disa zona edhe me drurë të rinj të ardhur prej zjarreve të rëna vite më parë.

- **Prania e llojeve** të rëndësishme pyjore si Ahu, Bredh të bardhë, Arnen, dhe Pishë të zeze të cilët ndërthuren në një asambël natyror në luginën e Rrajcës.

- **Peizazhi i zonës.** Zona vendoset në lindje të malit të Shebenikut në të cilën gjenden liqenet akullnajorë të Rrajcës dhe Shebenikut, monumente

natyre (kategoria III). Liqenet në Rrajcë janë të vendosura në një cirk të madh kompleksi akullnajor, rreth 1900-2000 mnd. Janë katër liqene akullnajore, me gjatësi e gjerësi mesatare 100-200 m dhe 80-100 m. Janë të veçuara nga njëri tjetri prej depozitimesh morenike. Liqeni i Shebenikut ndodhet në shpatet lindore të Shebenikut, në lartësinë 2000 mnd, i vendosur në një cirk të madh kompleksi akullnajor.

- **Vlerat e biodiversitetit.** Zona paraqet vlera të larta nga pikpamja e diversitetit biologjik që ofron. Kjo për shkak se aktivitetet njerëzore nuk kanë qenë shumë shqetësuese për ekositetin natyror të zonës. Në vijim jepen të dhëna vetëm për listën me llojet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare (lloje të rralla e të rrezikuara që janë pjesë e listës së kuqe të Shqipërisë dhe IUCN). Lista e detajuar e tyre statusi i secilit lloj, emrat përkates janë paraqitur në kapitujt më sipër. Zona ka në total 49 lloje të rrezikuara - pjesë e listës së kuqe të florës dhe faunës së Shqipërisë dhe IUCN.

Flora; 26 lloje drurësh, shkurresh dhe bimësh të rralla gjenden në Rrajcë.

Fauna; në zonë gjenden 9 gjitarë, 10 shpendë, 1 insekt, 2 amfibë dhe 1 molusk. Zona strehon të gjithë gjitarët e mëdhenj; Ariu, Ujku, Rrëqebulli, Derri i egër, Dhia



e egër, Kaprolli. Lugina rrethohet nga maja e kurrize malore të larta, shpeshherë mbi 1800 mnd.

- **Sofra e Skënderbeut.** Është monument natyre (kategoria e III) dhe ndodhet në skajin jugor të malit të Shebenikut, në lartësinë 1376 mnd. Është i gjatë rreth 1 km dhe i gjerë rreth 800 m. Ka kreshtë të sheshtë të mbushur me forma të shumta karstike dhe shpate të thepisura. Përbën një bllok guri gëlqerori me formë të veçantë (sofër e rrumbullakët) të vendosur mbi ultrabazikë. Legjenda thotë se mbi këtë gur ushqehet ushtria e Skënderbeut nga ku ka marrë edhe emrin.

Rëndësia pse duhet të mbrohet: Pylli i Ahut në Rrajcë si pjesë përbërëse e PK Shebenik- Jabllanicë dhe zonë e UNESCO-s, është vazhdimësi e Parkut në pjesën Maqedonase të kufirit. Prandaj ruajtja dhe mbrojtja e zonës është me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Mjediset serpentinore sidomos habitatet livadhore dhe kullosore në brendësi ose periferi të

pyllit të Ahut strehojnë disa specie bimore të rëndësishme jo vetëm në nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar. Ndër to përmenden *Festucopsis serpentina*, *Lilium albanicum*, *Viola dukadjinica*, *Cerastium smolikanum* ose *Orobancha nowackiana*. Habitatet e Ahut dhe llojeve të tjera të rëndësishme në brendësi ose periferi të tij duhen mbrojtur për të siguruar qetësinë e nevojshme për gjitarët e mëdhenj, sidomos të Rrëqebullit por edhe të shpendëve. Por mbi të gjitha rëndësi qëndron për të siguruar ekzistencën e një prej masiveve më të mira me pyje të vjetër Ahu në Shqipëri.

Habitatet kryesore në zonë

Habitatet më kryesore të pyjeve në zonë janë;

91W0 Pyje ahu Moesianë. Pyjet e Ahut në Rrajcë, ndodhen brenda Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Ato shtrihen në lartësitë 1000-1800 m dhe ndodhen kryesisht në substrate serpentinore ose ultrabazike përjashtuar sipërfaqet e vogla të Ahut që ndodhen në anën e majtë të rrjedhës së përroit të Rrajcës. Pylli dominohet nga drurët e Ahut (*Fagus sylvatica*), por në mes tyre gjenden edhe Bredh i bardhë (*Abies alba*). Kati barishtor i pyllit përbëhet nga specie tipike të Ahut si; *Sanicula europaea*, *Actaea spicata*, *Asperula odoratum*, *Anemone nemorosa*, *Calamintha grandiflora*, *Cardamine bulbifera*, *Helloborus odorata*, *Galium odoratum*, *Solidago virgaurea*, *Prunella vulgaris*, *Satureja montana*, *Symphytum bulbosum* *Hepatica nobilis*, *Brachypodium pinnatum*, *Brachypodium sylvaticum*, *Melica uniflora*, *Allium ursinum* etj. Në çelirat pyjore të Ahut hasen edhe



shkurreta të Boronicës (*Vaccinium myrtillus*), Grathatelit (*Erica herbacea*) dhe të Xerxelës së Bllagajt (*Daphne blagayana*). Në mjediset me pjerrësi të lartë gjenden speciet; *Geranium macrorrhizum*, *Asplenium trichomanes* ose *Achillea frassii* etj.

4060 Shqopishte alpine dhe të Borealit. Habitati me shqopishte përfaqësohet kryesisht nga Dëllinja e rrëgjuar (*Juniperus communis* ssp. *alpina*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*), Grathateli (*Erica herbacea*), Xërxele (*Daphne oleoides*) etj. Ky habitat është i rëndësishëm sepse strehon shumë bimë të tjera barishtore si; *Potentilla erecta*, *Plantago lanceolata*, *Anthemis arvensis*, *Trifolium* sp., *Koeleria splendens*, *Molinia coerulea*, *Prunella laciniata*, *Sesleria comosa*, *Phleum alpinum*, *Agrostis rupestris*, *Alopecurus gerardii*, *Festuca paniculata*, *Arabis alpina*, *Nardus stricta*, *Anthoxanthum odoratum*, etj.

6520 Livadhe të larta malore. Habitata të cilat shpesh gjenden edhe në brendësi të pyllit të Ahut strehojnë specie të rëndësishme dhe të rralla të florës sonë si; *Festucopsis serpentini*, *Narcissus poeticus*, *Lilium albanicum*, *Viola dukadjinica*, *Cerastium smolikanum* ose *Orobanche noëackiana*.

92A0 Galeri apo breza pyjore me *Salix alba* dhe *Populus alba*. Ky tip habitati e ndan mjedisin serpentinator dhe atë gëlqeror në mes, dhe kompozohet kryesisht nga speciet *Salix alba* dhe *Populus alba*. Përgjatë shtratit lumor mund të gjenden edhe *Salix elaeagnos*, *Populus nigra*, *Hedera helix*, *Ranunculus ficaria*, *Helleborus odoratus*, *Arum italicum*, *Brachypodium sylvaticum*, *Dactylis glomerata* ose *Pteridium aquilinum*.

Habitatet të tjera në zonë janë;

- 91K0 - Pyjet ilire *Fagus sylvatica* (Aremonio-Fagion)
- 3240 - Lumenj alpinë dhe bimësia e tyre drunore me *Salix elaeagnos*
- 6430 - Bashkësi barishtesh hidrofile të larta të fushës dhe malit të niveleve alpine
- 95A0 - Pyje të larta me pisha oro-mesdhetare
- 62D0 - Livadhe acidofile oro-mesiane
- 7230 - Moçalishte Alkaline
- 6210 - Livadhe gjysmë-natyrore të thata dhe faqe shkurre në nënshtresa gëlqerore
- 4090 - Shqopishte me gjineshtër endemike oro-mesdhetare
- 5130 - Formacione të *Juniperus communis* në shqopishte ose livadhe gëlqerore
- 8210 - Shpate shkëmbore gëlqerore me bimësi kasmofitike
- 8140 - Gurishte mesdhetare lindore



Udhërrëfyes për në zonë

Ndër të gjithë masivet me pyje të vjetër Ahu Rrajca përbën zonën më të lehtë për tu aksesuar. Kjo falë pjerrësisë së ulët gjatësore që ka lugina. Vizitori nuk duhet të bëjë më shumë se 250 metra ngjitje vertikale gjatë rrugës që do përshkojë në këmbë.



Rruga automobilistikenga Përrenjasi për në Rrajcë (fshati Skënderbej) është relativisht e mirë dhe përshkohet me mjete të mëdha. Rruga shkon deri në pjesën fundore të fshatit, në afërsi me zonën pyjore ku fillojnë pyjet e vjetër të Ahut.

Ka dy mënyra për ta vizituar zonën sipas akseve rrugore të paraqitura në vijim;

Tabela 9. Akset rrugore për në Rrajcë

Aksi rrugor	Distanca, km	Mjetet për ta përshkuar	Koha për ta përshkuar, orë
Tiranë-Përrenjas-Rrajcë- Skënderbej	110	4x4	3
Korçë-Përrenjas-Rrajcë- Skënderbej	82	4x4	2.5





Figura 18. Drejtimet kryesore për në Rrajcë

Nga fshati Skënderbej deri tek grumbulli me pyje të vjetër Ahu distanca është rreth 6 km, dhe mund të përshkohet për 1.5 orë në këmbë. Rruga këmbësore është mjaft e mirë dhe shumë e përshtatshme (me pak pjerrësi në ngjitje) për ecje në këmbë.

Mund të vizitohet edhe nga ana veriore e zonës duke ndjekur rugën Librazhd-Kosharisht-Qarrishtë por distanca që duhet përshkuar në këmbë është më e madhe dhe rruga paraqet më shumë vështirësi.

Tokat janë të murrme pyjore (shtrihen në brezin 1200-1700 m). Mbi këtë brez shfaqet brezi i tokave livadhore malore (mbi 1700 m) në të cilën shtrihen kullosat alpine të zonës. Këto toka më së shumti janë të vendosura dy anët e luginës në lartësitë maksimale të saj.



Rreziqet kryesore për pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri

Ashtu si çdo pasuri tjetër edhe pyjet e vjetër të Ahut rrezikohen prej aktiviteteve që zhvillohen në afërsi të këtyre zonave apo në brendësi të tyre. Ndikimi i aktiviteteve mund të jetë i drejtpërdrejtë ose jo por që në vetvete çdo aktivitet sjell një rrezik të caktuar për zonën. Disa nga këto rreziqe janë;

- **Zjarret.** Zjarret mbeten kërcënimi më i madh për masivet pyjore. Sasia e madhe e lëndës organike që gjendet në tokat pyjore, i bëjnë këto zona shumë të ekspozuara ndaj rrezikut të zjarreve. Nga ana tjetër zonat janë shumë të izoluara dhe është e pamundur që të bëhet në kohë organizimi i punës për shuarjen e zjarreve. Ka pak banorë që jetojnë në afërsi apo përreth këtyre zonave dhe gjetja e personave që mund të merren me shuarjen e zjarreve shpeshherë është e pamundur. Në disa raste fshati me i afërt me zonat me pyje të vjetër është 4-5 orë në këmbë (Livadhi i Harushës dhe Lumi i Gashit) dhe kjo e bën aspak efektivitetin e shuarjes së zjarreve atje.
- **Prerja e pyjeve.** Zonat me pyje të vjetër janë të izoluara dhe nuk ka mbërrihen me rrugë makine. Kjo e përjashton aktualisht rrezikun e prerjeve masive të pyjeve të vjetër të Ahut atje. Por nëpër zona vihen re drurë të prerë, kryesisht Bredh, Arnen dhe Rrobull të cilët banorët i përdorin si materiale ndërtimi për mbulimin e çatave apo prodhimin e mobiljeve. Ndaj prerjet mbeten një rrezik për disa lloje halorësh të cilët preferohen më shumë nga banorët. Shfrytëzimi i pyjeve (grumbujt e vjetër të Ahut apo pyjet në afërsi të tyre) mbetet një opsion që diskutohet shpesh për këto masive pyjore nga bashkitë dhe kompanitë private. Hapja e rrugëve (edhe për qëllime të tjera) në afërsi të grumbujve me pyje të vjetër do të ekspozonte këto pyje para rrezikut të prerjes së tyre duke kërcënuar seriozisht ekzistencën e tyre.
- **Kullotja.** Mbetet një ndër rreziqet kryesore. Më së shumti për bimësinë barishtore dhe lloje të rralla e të rrezikuara që gjenden në zonat me pyje të vjetër Ahu apo përreth tyre. Një tjetër problem që lidhet me kullotjen është rreziku i përhershëm që ekziston lidhur me zjarret që shkaktohen në kullota të cilat me pas mund të përshkojnë edhe pyjet. Gjithashtu konfliktet e pronësisë për zonat kullosore mbeten një problem që duhet vlerësuar.
- **Gjuetia dhe peshkimi.** Thuajse në të gjitha zonat dallohen shenja të gjuetisë. Në përgjithësi banorët preferojnë më shumë gjuetinë e Derrit të egër, Dhisë dhe Kaprollit, ndërsa më pak ato të shpendëve. Meqenëse zonat janë të izoluara dhe shumë larg qendrave të banuara mundësia e kontrollit dhe parandalimit të gjuetisë janë të kufizuara. Peshkimi nuk përbën problem për momentin por shenja të tij po shfaqen në Lumin e Gashit. Por peshkimi mund të jetë problem edhe në disa zona të tjera si lumi i Tropojës dhe më pak në Rrajcë.
- **Mbetjet.** Nëpër zona vërehen mbetje të lëna aty-këtu nga banorët apo vizitorët e ndryshëm. Megjithëse për momentin ky nuk është një shqetësim i madh me rritjen e numrit të vizitorëve në këto zona pritet të rritet edhe rreziku i ndotjes nga mbetjet.

- **Erozioni.** Në disa nga zonat me pyje të vjetër Ahu ka shenja të erozionit të tokës. Raste të tilla shfaqen në Livadhin e Harushës, Lumin e Gashit dhe Lumin e Tropojës, në pjesën e sipërme të luginave përkatëse. Kjo e shkaktuar prej zjarreve të rëna, hapjes së rrugëve si dhe prezencës së shtuar të blegtorisë atje.
- **Hapja e rrugëve automobilistike.** Disa nga zonat me pyje të vjetër Ahu janë të pa aksesueshme aktualisht prej rrugëve automobilistike. Përjashtim bën masivi pyjor i luginës së Tropojës të cilin rruga auto e përshkon mes për mes. Një rrugë sezonale kalon dhe në krye të luginës së Gashit (bjeshkët e Dobërdolit) por për momentin është larg masivit pyjor. Ka tendenca që rruga të shtrihet poshtë nëpër luginë drejt masivit me pyje të vjetër Ahu. Edhe në Zall-Gjoçaj dhe Rrajcë rruga auto është fare pranë grumbujve pyjorë atje. Në të gjitha rastet prezenca e rrugëve të tilla përbën rrezik serioz për pyjet e vjetër dhe ekosistemet natyrore atje pasi prerja e pyjeve do ishte lehtësisht e mundur pastaj. Duke qenë se shpatet e luginave ku shtrihen pyjet e vjetër kanë pjerrësi të madhe nga hapja e rrugëve do të dëmtohej në mënyrë të pakthyeshme edhe peizazhi i zonave. Efekti tjetër i rrugës është ai i ndarjes dhe zvogëlimit të habitatit. Hapja e rrugëve do të sjellë më shumë njerëz në zonë dhe për rrjedhojë do të ketë më shumë presion mbi burimet natyrore aty.
- **Ndërtimet.** Në disa prej zonave me pyje të vjetër Ahu apo në afërsi të tyre ndërtimet po bëhen gjithnjë e më shumë shqetësim për ekosistemet natyrore. Zonat më të ndikuara aktualisht janë Lumi i Gashit dhe Lumi i Tropojës. Kjo pasi në pjesën e sipërme të këtyre luginave gjenden sipërfaqe kullimore (bjeshkët e Dobërdolit dhe Sylbices). Ndërtimet bëhen kryesisht për stane të cilat kanë filluar si struktura druri, por po pasohen apo shoqërohen nga ato të betonit. Disa nga banorët po përpiqen ti përshtasin stanet si bujtina duke e shtuar akoma më shumë tendencën e zhvillimit të ndërtimeve në këto zona. Po përdoren materiale jo të përshtatshme për peizazhin e zonës (beton, tulla, hekur)
- **Ndërtimi i HEC-eve.** Nisur dhe nga sasia e burimeve ujore duket se Zall-Gjoçaj dhe Lumi i Gashit janë më të kërcënuarit prej ndërtimit të HEC-eve. Aktualisht ka disa kërkesa për zhvillimin e HEC-eve në ato zona. Përveç ndryshimeve drastike në rrjedhjet ujore dhe ndikimet në faunën dhe ekosistemet ujore dhe breg-lumore, ndërtimi i HEC-eve shkakton shkatërrimin e pakthyeshëm të peizazheve natyrore. Pavarësisht mbrojtjes ligjore që gëzojnë këto zona, eksperiencia ka treguar se ajo nuk është aspak e mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të tilla edhe në zonat e mbrojtura (veçanërisht Parqet Kombëtare). Por, edhe zona të tjera janë të kërcënuara nga HEC-et; Lumi i Tropojës, Curraj i Epërm dhe Rrajca. Vetëm Livadhi i Harushës pritet të mos preket nga ndërtimi i HEC-eve.
- **Çështjet e pronësisë mbi tokën.** Pronësia mbi tokën mbetet një kërcënim për pyjet e vjetër të Ahut. Paqartësia e madhe që ekziston mbi pronën do të prekë edhe pyjet e vjetër. Shumë familje kanë livadhe apo çeltira në pyjet e vjetër të Ahut apo përreth tyre në të cilat kulloshin bagëtisë e tyre dhe ku kosisin barin. Ata kanë ndërtuar në “tokat e tyre” stane ku shkojnë çdo vit për të veruar atje. Çdo familje, fis apo fshat ka kufinj të e vet të përdorimit të këtyre sipërfaqeve kullimore të cilat zakonisht njihen dhe respektohen nga banorët. Pronësia mbi tokën dhe konfliktet për të janë një rrezik që duhet konsideruar dhe menaxhuar në vijim.


Vlerësimi i rreziqeve

Vlerësimi i rrezikut për secilën zonë është bërë në tabelën në vijim. Kjo duke vlerësuar çdo rrezik të mundshëm (aktual dhe potencial) për zonën me një shkallë nga 1 deri në 10, ku numri 10 përfaqëson nivelin më të lartë të rrezikut potencial për zonën përkatëse dhe numri 1 rrezikun më të vogël. Janë analizuar dhe vlerësuar vetëm 10 rreziqet më kryesore për këto zona;

Figura 19. Rreziqet kryesore për pyjet e vjetër të Ahut

Rreziqet kryesore për pyjet e Ahut	Zonat me pyje të vjetër Ahu					
	Livadhi i Harushës	Lumi i Gashit	Lumi i Tropojës	Curraj i Epërm	Zall-Gjoçaj	Rrajcë
Zjarret	9	8	7	8	9	6
Prerja e drurëve dhe pyjeve	1	2	8	2	8	6
Gjuetia dhe peshkimi	2	3	5	2	4	5
Mbetjet	1	2	5	2	3	5
Hapja e rrugëve auto	1	4	10	2	8	4
Vizitorët	2	3	6	2	3	4
Erozioni	2	2	4	2	4	4
Ndërtimet	2	4	6	1	2	2
Ndërtimi i HEC-eve	1	3	3	4	6	2
Pronësia mbi tokën	2	5	6	2	3	3
Shuma e vlerësimit	23	36	60	27	50	41


Sipas vlerësimit të bërë në tabelën e mësipërme kemi këtë situatë të ekspozimit të pyjeve të vjetër të Ahut ndaj rreziqeve kryesore;



Grafiku 17. Niveli i rrezikut sipas zonave me pyje të vjetër Ahu

Duke ju referuar tabelës dhe grafikut të mësipërm Lumi i Tropojës mbetet masivi pyjor më i rrezikuar aktualisht. Kjo për shkak të ndërtimit të rrugës që e përshkon masivin pyjor mes për mes tij, duke sjellë me vete rreze të tjera potenciale (prerja e pyjeve, zjarret, ndërtimet, mbetjet, gjuetia etj) në zonë. Një tjetër efekt i rëndësishëm i prezencës së rrugës dhe që ka shfaqur tashmë ndikimin në zonë, është ai i ndërtimeve që kanë filluar të bëhen në pjesën e sipërme të luginës; në bjeshkët e Sylbicës. Ndër masivet e tjera Zall-Gjoçaj paraqitet më i rrezikuari. Kjo për shkak të zjarreve, prerjeve dhe ndërtimit të rrugës, e cila aktualisht gjendet fare afër sipërfaqes me pyje të vjetër Ahu. Dy masivet e tjera; Lumi i Gashit dhe Rrajca kanë thujtë të njëjtin nivel rreziku. Rrajca mbetet më e rrezikuar për shkak se është lehtësisht më e aksesueshme ndërsa Lumi i Gashit kryesisht prej zjarreve dhe ndërtimeve që kanë filluar të bëhen në bjeshkët e Dobërdolit.

Në këtë drejtim vëmendja dhe përkushtimet e stafeve të bashkive dhe inspektoriateve si dhe AKZM duhen fokusuar në zonat në fjalë. Vëmendje e madhe duhet treguar ndaj çdo grumbulli të vjetër me pyje Ahu, por si më prioritare dhe më në fokus duhet të jenë ato zona që kanë një shkallë më të lartë rreziku potencial.



Mbrojtja e pyjeve të vjetër të Ahut

Plani i veprimit për mbrojtjen e pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri

Për mbrojtjen e zonave me pyje të vjetër të Ahut dhe të natyralitetit të tyre, është e nevojshme që të ndërmerren disa masa;

- **Mbrojtja nga zjarri.** Duhet bërë fushata ndërgjegjësuese dhe komunikime të vazhdueshme me komunitetet e zonave, lidhur me parandalimin e zjarreve dhe pjesëmarrjen për shuarjen e tyre. Duke qenë se pesë nga gjashtë masivet me pyje të vjetër Ahu shtrihen në zonat kufitare, mbrojtja e tyre nga zjarret duhet koordinuar edhe me vendet fqinje (Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia). Veçanërisht kjo vlen për Livadhin e Harushës duke qenë se mundësia më e mirë për menaxhimin e situatës së zjarreve është nga fshati Kutit (Mali i Zi). Një arsye tjetër për koordinimin me vendet fqinje është edhe fakti se shpesh herë zjarret vijnë nga ato vende, apo anasjelltas. Rekomadohet ngritja e skuadrave lokale me vullnetarë për fikjen e zjarreve në zonë. Një masë tjetër në këtë drejtim është edukimi në shkollat dhe komunitetet e zonës, duke qenë se fëmijët dhe banorët e zonave dalin nëpër pyje a kullota, për të kullotur blegtorinë, grumbulluar dru zjarri apo mbledhur bimë mjeksore. Gjithashtu angazhimi i OSHC është i rëndësishëm në këtë drejtim.
- **Zbatimit i ligjit.** Zonat kanë aktualisht probleme me dëmtimet nga zjarret, prerjet, ndërtimet, gjuetia, etj. ndaj është me rëndësi jetike zbatimi i të gjithë paketës së legjislacionit lidhur me mbrojtjen e këtyre masiveve pyjore dhe vlerave natyrore që ato përfaqësojnë.
- **Mbrojtja nga prerjet.** Duke qenë se rreziku kryesor qëndron tek drurët e rrallë të Bredhit, Rrobullit, Arnenit apo Hormoqit, puna kryesore duhet përqendruar me komunitetet e zonave që kanë akses në ato pyje. Është me shumë rëndësi forcimi i zbatimit të ligjshmërisë në këto zona. Duhet bërë identifikimi i zonave problematike, dhe më tej ndërgjegjësimi i komuniteteve lidhur me dëmin që i shkaktohet zonës nga prerjet e drurëve. Gjithashtu duhet bërë edhe shpjegimi i legjislacionit përkatës të mbrojtjes së natyrës si moratoriumi i pyjeve por edhe vlerave që drurët apo pyjet e vjetër përfaqësojnë për zonat dhe për vendin.
- **Ndalimi i gjuetisë dhe peshkimit.** Numri i gjuetarëve në zonat me pyje të vjetër Ahu është i vogël për shkak të pamundësisë për ti aksesuar ato zona. Ashtu si dhe në rastin e zjarreve, problemet e gjuetisë shpeshherë janë edhe ndërkuftare, ku gjuetarët shkojnë për të gjuajtur në zona jashtë kufirit, apo e kundërta. Ndaj edhe ky problem duhet zgjidhur e trajtuar në bashkëpunim me vendet fqinje. Evidentimi dhe komunikimi i vlerave të biodiversitetit të zonës dhe moratoriumi i gjuetisë duhet të njihen dhe prezantohen në vijimësi grupeve kryesore të interesit dhe veçanërisht gjuetareve në

ato zona. Gjithashtu prezenca e institucioneve ligjzbatuese duhet të jetë shumë më e madhe dhe efikase atje.

- **Ndalimi apo kufizimi i ndërtimeve.** Ka një nevojë emergjente për të kufizuar, ndaluar apo rregulluar procesin e ndërtimeve që kanë nisur së fundmi në Dobërdol dhe Sylbicë. Zonat kanë nevojë për pranimë e institucioneve ligjzbatuese për të normalizuar situatën dhe për ta sjellë atë në ligjshmëri të plotë. Në Lumin e Gashit dhe Sylbicë nevojitet ndërhyrje më urgjente në këtë drejtim.
- **Komunikimi dhe interpretimi.** Ka nevoja emergjente për të komunikuar dhe interpretuar vlerat unike të zonave me pyje të vjetër Ahu. Aktualisht banorët i shohin ato zona kryesisht si atraksione natyrore, për gjueti, kullotje apo prerjen e drurëve. Por zonat kanë edhe shumë vlera të tjera ekologjike të cilat njihen pak ose aspak nga komunitetet vendore. Është e nevojshme që të hartohen e publikohen studime, materiale informuese etj. dhe të komunikohen vlerat natyrore dhe kulturore të zonave, në mënyrë që ato të njihen më mirë si nga komunitetet ashtu dhe institucionet dhe OSHC.
- **Hartimi dhe zbatimi i planeve për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave.** Zonat duhet të vazhdojnë të mbeten si ekosisteme natyrore të pasqetësuar. Përveç përdorimit të mënyrave të deritanishme për aksesimin e zonave (rrugët këmbësore), mënyrat e tjera duhen përjashtuar. Duhet promovuar mekanizma zhvillimi që janë miqësore me mjedisin, që ulin presionin njerëzor dhe që nuk çenojnë natyralitetin dhe peizazhin e pyjeve dhe zonave përreth tyre. Gjithashtu duhet një përfshirje më aktive e komunitetit si dhe duhen gjetur mekanizma mbështetës për të.
- **Përmiresimi i bazës ligjore për pyjet e vjetër të Ahut.** Përmiresimi i bazës ligjore synon mbrojtjen e pyjeve të vjetër të Ahut, bazuar në një legjislacion specifik kombëtar por edhe të konventave të ndryshme që shteti shqiptar ka miratuar apo aderon. Në rastin e pyjeve të vjetër të Ahut sygjerohet një shtesë në ligjin përkatës të Zonave të Mbrojtura (Ligji 81/2017), ku këto masive pyjore të kenë mbrojtje ligjore (duke u shpallur si pjesë e Sistemit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura, kategoria I ose II).
- **Ngritja e një rrjeti kombëtar për pyjet e vjetër.** Synimi është krijimi i një rrjeti të afirmuar dhe të promovuar të pyjeve të vjetër të Ahut në Shqipëri. Rrjeti do të përbënte burimin më të rëndësishëm të vlerave të diversitetit biologjik, por edhe një bankë të mirëfilltë gjenetike për burimet pyjore të vendit. Gjithashtu një mënyrë të shkëlqyer të promovimit dhe mbrotjes së këtyre zonave.
- **Plan menaxhimi për pyjet e vjetër të Ahut.** Për secilën zonë duhet bërë një plan i detajuar për menaxhimin e pyjeve të vjetër të Ahut, në mënyrë që ajo trashëgimi natyrore të mbrohet dhe promovohet në vijim. Plani duhet të përfshijë mënyrat se si do të menaxhohen, si do mbrohen nga ndikimet dhe rreziqet e mundëshme, so do bëhet promovimi, përfshirja e aktorëve dhe komuniteteve lokale, përfshiraj dhe roli i OSHC, zhvillimet socio-ekonomike të komuniteteve. Nga ana tjetër do ishte e nevojshme edhe një plan veprimi, me aktivitete të përcaktuara dhe të shtrira në kohë si dhe kostot financiare të tyre. Gjithashtu është e nevojshme që të promovohen dhe zbatohen disa praktika të mira menaxhuese në këtë drejtim.

Propozime për pyjet e vjetër të Ahut në Shqipëri

Duke qenë se pyjet e vjetër të Ahut nuk kanë mbrojtje specifike ligjore si të tilla, rekomandohet si fillim përfshirja e tyre në legjislacionin kombëtar dhe më tej në rrejet apo organizatat ndërkombëtare. Disa nga rrejet që janë të pranishme aktualisht në Evropë dhe Botë janë; UNESCO, Wilderness Europe, European beech network etj. Gjithashtu do të ishte i nevojshëm edhe krijimi i një rrjeti kombëtar me pyjet e vjetër të Ahut.

Dhënia e statusit ligjor (kombëtar) ose integrimi i pyjeve të vjetër të Ahut në këto rreje shihet si e vetmja mundësi për garantimin e mbrojtjes së sipërfaqeve të fundit me pyje të vjetër dhe natyrore të vendit. Kuptohet që duhet shumë punë dhe përkushtim në terren, për të garantuar mbrojtjen e këtyre pyjeve nga dëmtimet e mundëshme si zjarret, prerjet, ndërtimet, mbetjet, HEC-et etj.

Nga vëzhgimet e kryera në terren, rezulton se zonat paraqesin situata të ndryshme dhe duhen bërë propozime specifike për secilën prej tyre;

- **Pëfshirja në Sistemin kombëtar të zonave të mbrojtura.** Ky propozim synon që masivet me pyje të vjetër Ahu të propozohen dhe të jenë pjesë e Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura të Shqipërisë. Kjo do ti jepte status ligjor mbrojtje secilës zonë me pyje të vjetër Ahu, dhe do të garantonte ruajtjen e saj në kushte natyrore siç është tani. Për më tepër, organizata të tilla si UNESCO kërkojnë që së pari zonat të mbulohen nga legjislacioni kombëtar, pra të kenë mbrojtje nga legjislacioni kombëtar. Mbrojtja ligjore do të ndikonte edhe në promovimin e zonave në nivel kombëtar dhe rajonal. Propozimi duhet të bazohet në përfshirjen e pyjeve të vjetër vetëm në dy kategoritë e para të zonave të mbrojtura; Rezervë strikte natyrore (kategoria I) dhe Park Kombëtar (kategoria II). Të gjitha zonat (masivet e përmendura këtu) me pyje të vjetër Ahu duhet të jenë pjesë e këtij sistemi.
- **Zonë e Trashëgimisë Natyrore të UNESCO.** Shqipëria është anëtare e kësaj organizate që nga viti 1958. Vetëm pak zona në Shqipëri kanë statusin e UNESCO-s, dy prej të cilave janë zonat me pyje të vjetër Ahu ('Rrajca' dhe 'Lumi i Gashit' e kanë marrë këtë status në Korrik 2017). Marrja e këtij statusi do të mundësonte një promovim në nivel ndërkombëtar të pyjeve të vjetër të Ahut si dhe do të garantonte mbrojtjen e tyre bazuar si në legjislacionin kombëtar ashtu dhe atë ndërkombëtar. Statusi 'zonë e UNESCO-s' do të përmirësonte më shumë rrejetin e zonave të UNESCO-s që ka aktualisht Shqipëria duke rritur më tej interesin turistik ndaj vendit tonë. Marrja e attributeve të tilla do bënte që ato të tërhiqnin një numër më të madh vizitorësh, të cilët do të kontribonin në zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve që jetojnë në afërsi të zonave me pyje të vjetër Ahu. Nga vëzhgimet në terren rezulton se dy zona janë aktualisht të përshtatshme për tu propozuar si zona të UNESCO-s; Livadhi i Harushës dhe Zall-Gjoçaj edhe pyjet e vjetër te Currajt të Epërm apo Lugina e Tropojës mund të jenë propozime të tilla.

- **Evropa e Egër (Wilderness Europe).** Në Evropë dhe nëpër botë gjithnjë e më shumë po krijohen rrjete të mbrojtjes dhe promovimit të natyrës së egër. Duke qenë se disa nga zonat me pyje të vjetër Ahu përfaqësojnë oaze të vërteta natyrore, marrja e këtij statusi do ti rriste mjaft vlerat e tyre duke mundësuar një promovim si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar. Të gjitha zonat me pyje të vjetër Ahu të evidentuar këtu janë të përshtatshme në këtë drejtim. Dy zona; Lumi i Tropojës dhe Zall-Gjoçaj duhet të propozohen në këtë rrjet në një fazë të mëvonshme për shkak të intensitetit dhe dinamikës së zhvillimeve në zonat respektive. Në këto dy zona dëmtimet e mundëshme mund të ndikojnë shumë në këtë drejtim.
- **Rrjeti kombëtar i Pyjeve të Vjetër.** Ende nuk kemi një rrjet të tillë në Shqipëri por do të propozohet që ky rrjet të ngrihet së shpejti, si kontribut në përmiresimin e Sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura në vend. Prania e këtij rrjeti do të ishte një qasje e re për natyrën në Shqipëri dhe do të ndihmonte në ruajtjen e vlerave unike të saj pikërisht në këto zona. Rrjeti do të mund të ishte partneri kryesor i Rrjetit Evropian të Natyrës së egër (Wilderness Europe Network) apo i atij për pyjet e Ahut (European beech network) në punën për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e pyjeve të vjetër të Ahut. Të gjithë masivet me pyje të vjetër duhet të jenë pjesë e këtij rrjeti.

Propozimet e mësipërme jepen të paraqitura në figurën në vijim;

Figura 20. Propozimet për pyjet e vjetër të Ahut

Propozimet për pyjet e vjetër të Ahut	Zonat me pyje të vjetër Ahu							
	Livadhi i Harushës	Lumi i Gashit	Lumi i Tropojës	Curraj i Epërm	Zall-Gjoçaj	Rrajcë		
Zonë e Trashëgimisë Natyrore të UNESCO								
Zonë e Rrjetit Natyror Evropian e Egër (Wilderness Europe)								
Pjesë e rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura								
Pjesë e rrjetit kombëtar të Pyjeve të Vjetër të Ahut								
	Propozim aktual		Zona e ka atë status			Propozim i mundshëm në të ardhmen		



Inventarizimi i pyjeve të vjetër

Për të patur një situatë sa më të qartë për pyjet e vjetër të Ahut në vendin tonë është e nevojshme që grumbujt pyjorë të inventarizohen bazuar në metodologji standarte dhe të çertifikuara.

Elementët kryesorë të inventarit duhet të përfshijnë, por të mos kufizohen në;

- a. *Inventarizimin e parametrave dendrometrikë dhe të gjendjes fito-sanitare të grumbullit;*
 - Lartësia mesatare e drurëve (model)
 - Diametri bazimetrik (në 1.3 m lartësi nga toka)
 - Moshja e drurëve, përmes matjeve dendrokronologjike në çdo zonë
 - Numri i drurëve të tharë
 - Numri i drurëve të rrëzuar
 - Numri i drurëve të kalbur
 - Gjendja e kurorës së drurëve
 - Prania e myshqeve dhe likeneve
 - Dëmtimet natyrore tek drurët
- b. *Inventarizimin e aspekteve sasiore të grumbullit;*
 - Sipërfaqja e grumbullit pyjor
 - Përbërja llojore
 - Struktura e grumbullit pyjor
 - Kurorëndësia
 - Funksionet kryesore të grumbullit
- c. *Inventarizimi i florës dhe faunës*
 - Inventari i florës dhe faunës
 - Llojet e rrezikuara
 - Llojet indikatorë
 - Habitatet e zonës
 - Shoqërimet kryesore bimore
- d. *Inventarizimi i parametrave mjedisorë*
 - Ndryshimet në përdorimin e tokës
 - Ndryshimet në mbulesën e tokës
 - Burimet ujore dhe gjendja e tyre
 - Toka dhe përbërja e saj (përfshirë vlerësimin për lëgushën dhe humusin)
 - Peizazhi i zonës
 - Efektet e ndryshimeve klimatike
- e. *Inventarizimi i ndikimeve njerëzore*

- Prerja e drurëve
- Zjarret
- Shkalla e natyralitetit
- Rrugët dhe gjendja e tyre....etj.
- Gjuetia dhe peshkimi
- Erozioni
- Mbetjet, etj.

Plani i monitorimit për pyjet e vjetër të Ahut

Për të parë dinamikën e grumbujve me pyje të vjetër Ahu është e nevojshme monitorimi i tyre në vijimësi. Monitorimi duhet të ndjekë protokolle standarte dhe të çertifikuara. Monitorimi duhet bërë në periudha 5 vjeçare, por nëse në ka patur zhvillime të ndryshme periodiciteti i monitorimit mund të jetë edhe 1-2 vjeçar.

Monitorimi duhet të përfshijë të gjithë listën e inventarit bazë të pëshkruar më sipër, por mund të përfshijë edhe elementë të tjerë shtesë sipas nevojave specifike;

- a. *Monitorimi i parametrave dendrometrikë dhe të gjendjes fito-sanitare të grumbullit;* lartësia, diametri, mosha, drurët e tharë, drurët e rrëzuar, drurët e kalbur, kurora e drurëve, myshqet dhe likenet, dëmtimet natyrore etj;
- b. *Monitorimi i aspekteve sasiore të grumbullit;* sipërfaqja, përbërja, struktura, kurorëndësia, funksionet e grumbullit;
- c. *Monitorimi i florës dhe faunës;* lista e florës dhe faunës, llojet e rrezikuara dhe statusi i tyre, llojet indikatorë, habitatet e zonës, shoqërimet kryesore bimore;
- d. *Monitorimi i parametrave mjedisorë;* përdorimi i tokës, mbulesa e tokës, burimet ujore dhe gjendja e tyre, aktivitetet njerëzore, toka dhe përbërja e saj, peizazhi i zonës, efektet e ndryshimeve klimatike;
- e. *Monitorimi i ndikimeve njerëzore;* prerjet, zjarret, natyraliteti, rrugët, gjuetia dhe peshkimi, erozioni, mbetjet, pakësimet dhe shtesat në sipërfaqe etj.

Monitorimi mund të përfshijë edhe elementë të tjerë përveç atyre të listuar më sipër, nëse vlerësohen si të nevojshëm sipas rasteve dhe situatave specifike.

Krahasimi i të dhënave ndërmjet dy inventareve jep të dhëna të vlefshme për monitorimin. Në këtë mënyrë bëhet vlerësimi i aspekteve të veçanta që kanë të bëjnë me zhvillimin e aspekteve sasiore dhe cilësore të grumbullit pyjor.

Nga ana tjetër në këtë mënyrë bëhet edhe një vlerësim mbi kërcënimet, natyrën e tyre, tendencën, shkaqet dhe pritshmëritë.



Old beech forests in Albania

Introduction

Albania is currently ranked as the country with the least forest resources in Europe. Based on data from the forest cadaster and INSTAT (2017) Albania has about 1.052 million ha with forests (36.6% of the country's area), with a timber volume of about 51.6 million m³. Based on these figures, it turns out that the forests in Albania are quite degraded, with a volume of only 49 m³/ha. In the last 20 years, the national forest stock has reduced by 32 million m³, while the average volume per hectare has decreased by 40%, dropping from 81 m³/ha (1997) to 49 m³/ha (2017). There is a deep gap between the natural growth of forests and the volume of the forest stock that decreases and where the cutting of forests exceeds 2-3 times their growth.

If in 1997 virgin forests accounted for about 7% of the national forestry stock area (2017), nowadays these forests account for only 1% of the forests, an indicator of their drastic reduction over a period of only 20 years.

Albania represents today the only country in Europe where cutting of forests exceeds their natural growth by 2-4 times. The old forest in Albania are also a part of this difficult situation of the national forestry stock.

Nowadays, old forests face many threats such as; fires, logging, grazing, hunting, waste, erosion, road opening, construction activities, HPPs, land ownership etc. These threats make these clusters even more exposed to the risk of their final disappearance.

The purpose of this article is to identify and promote those few natural areas with old beech forests that have remained in the country.

They are areas where nature has developed itself without being influenced by human activities at all. Dynamic natural processes have followed their normality of development, reaching the forest ecosystems currently represented by their "*climax*" stage. Old beech forests represent the wild Albania or its "ultimate natural islands".

Old beech forests

Each country has formulated its own proposals regarding the definition of the old/virgin forest. In Albanian forestry terminology, this formulation may include mature and over-mature clusters (usually over 120 years old) with a natural (garden) structure.

A proposal to define the old forests in Albania would be: (i) *Naturally generated forests*, (ii) *forests which have not experienced significant human impact during their development*, (iii) *forests where trees of age ≥ 120 years¹ prevail*, (iv) *forests that are located in uniform territorial units (un fragmented)* and (v) *forests that occupy a minimum area of 100 ha*.

Identification of old beech forests in Albania

The selection of the most important clusters with old beech forests was based on several key criteria;

- a. Age of forest clusters (over 120 years old);
- b. A minimum area ≥ 150 ha;
- c. Topography and homogeneity of the area (an area organized in the shape of a valley, a slope, a plateau, etc., showing an un-fragmented forest cluster);
- d. Lack of human influence on the development of forest ecosystems (clusters where human influence did not exist in the dynamics of forest development).
- e. The opportunity to guarantee the management and protection of these forest clusters under the conditions they are today, undisturbed by man.

Based on the above criteria, it turns out that the areas with old beech forests in Albania are:

1. Livadhi i Harushës/ She-bear's Meadow (Malësi e Madhe Municipality)
2. Lumi i Gashit/ Gash River (Tropoje Municipality)
3. Curraj i Epërm/Upper Curraj (Tropoje Municipality)
4. Lumi i Tropojës/ Tropoje River (Tropoje Municipality)
5. Zall-Gjoçaj (Mat Municipality)
6. Rrajcë (Përrenjas Municipality)

These areas are shown in Figure no 1 below. Four from six proposed areas (Livadhi i Harushës (She-bear's Meadow), Lumi i Gashit (Gash River), Curraj i Epërm (Upper Curraj) and Lumi i Tropojës (Tropoje River) are situated in the Albanian Alps Region constituting thus the Southern Region of the Dinaric Alps. Whereas Zall-Gjoçaj is situated in the Central Mountainous Area and Rrajca is situated in the Eastern Region of Albania.

¹ This age should represent a minimum limit for at least 50% of the number of dominant trees in a given area.

There are interesting data regarding two of the areas: Lumi i Gashit (Gash River) and Curraj i Epërm (Upper Curraj) in terms of the age of some trees surveyed in this region. The measurements were conducted by a group of students from the Faculty of Forestry and Timber Sciences (Czech University of Life Sciences), Department of Forestry Ecology led by the professors Martin Mikoláš and Ondrej Kameniar (2016).

- In Lumi i Gashit (Gash River) 9 trees were found (from 35 surveyed trees) more than 250 years old, where two of them were 401-450 years old.
- In Curraj i Eperem (Upper Curraj) 8 trees were found (from 32 surveyed trees) more than 250 years old, where four of them were 300-350 years old.

Table 1. Data on the age of some trees in Lumi i Gashit (Gash River) and Curraj i Epërm (Upper Curraj)

Area	Surveyed trees	Age, according to age classes(every 50 years)				
		$\Sigma >250$	251-300	301-350	351-400	401-450
Lumi i Gashit	35	9	4	-	3	2
Curraj i Epërm	32	8	4	4	-	-

These are the recent data regarding the age of the two forest clusters in question.




Figure1. Areas with old beech forests in Albania

Areas with old beech forests are shown map graphed in this publication, divided into two zones (Figure no 2):

- Core zone – represents old beech forests ecosystems;
- Buffer zone – represents other ecosystems that associate beech forest ecosystems, mainly the Alpine pasture belt. They are called buffer zones so that when any management activity or use of the territory is conducted, these areas serve to mitigate impacts or pressures on old beech forests.




Figure 2 Zoning of areas with old beech forests

On the map, the proposed zones are shown as a uniform geographic unit (valley), where the buffer zone represents the crown surrounding the area with old beech forest. It is called a buffer zone because of the fact that in reality it offers some protection for old beech forests both from the point of view of the territory and the socio-economic activities that the local communities conduct there.

Old beech forests in Albania

The old beech forest clusters in Albania represent unique areas, almost natural and which so far have not experienced any significant human impacts. They are identified in 6 different regions of the country with different areas and characteristics from each other. Table No.2 below shows areas with old beech forests in Albania and the respective areas/surfaces of their core and buffer zones:

Table 2. Areas with old beech forests and their surfaces

No	Name	Core zone, ha	Buffer zone, ha	Total, ha
1	Livadhi i Arushës	1058.5	1381.3	2439.8
2	Lumi i Gashit	5228.8	4123.4	9352.15
3	Lumi i Tropojës	1243.6	2973.8	4217.5
4	Curraj i Epërm	1644.1	895.8	2539.9
5	Zall Gjoçaj	792.2	1652.9	2445.1
6	Rrajce	1730.0	1025.4	2755.4
	Amount	11697.3	12052.5	23749.8

The surface of old beech forest areas in Albania is estimated at 11,697.3 ha. This figure represents only 1.1% of the area of the forest stock of the country. The surface of the buffer zones surrounding the old beech forests is estimated at 12,052.5 ha. This is also a very important area for the protection of old beech forests ecosystems and also the mitigation of impacts on these forests. The total surface of the areas where the old beech forests (core and buffer zones) are located, is estimated at 23,749.8 ha.

Old forests and the national system of protected areas

The conservation of the old beech forests is very important. The presence of old beech forests would be an added value for the national system of protected areas. Today, only two of the six areas with old beech forests are part of the national system of protected areas. To have a clearer view about the coverage or not of the old beech forests within the national system of protected areas, see the data shown in Table no 3:

Table 3. Coverage of old beech trees in the National System of Protected Areas

Old beech forest area	Protected area category ¹	Category (IUCN)
Livadhi i Harushës	“Albanian Alps” National Park	II*
Lumi i Gashit	Strict nature reserve/ scientific reserve	I
Lumi i Tropojës	“Albanian Alps” National Park	II*
Curraj i Epërm	“Nikaj-Mertur” Natural Municipal Park	IV*
Zall-Gjoçaj	-	-
Rrajca	“Shebenik-Jabllanice” National Park	II
<i>*Zones represent proposals that have not been adopted yet</i>		

Two areas with old beech forests that are currently included within the national system of protected areas are the Lumi i Gashit (Gash River) (category I) and Rrajca (category II). Other areas are currently out of this system. For three of these areas (Livadhi i Harushës (She-bear’s Meadow), Lumi i Tropojës (Tropoje River) and Curraj i Epërm (Upper Curraj) there are concrete proposals to designate them as protected areas. Livadhi i Harushës (She-bear’s Meadow) and Lumi i Tropojës (Tropoje River) have been proposed (proposal of 2016, which is not yet adopted) to be designated as the core zone of the “Albanian Alps” National Park (category II); in the framework of the drafting of the respective management plan which included almost the entire Albanian Alps region.

Curraj i Epërm (Upper Curraj) has been proposed as the core zone of the Municipal Natural Park / Regional Natural Park (category IV). The proposal was made in the framework of the drafting of the “Nikaj-Mërtur” Regional Natural Park management plan (2014), which includes the whole territory of the Administrative Unit Lekbibaj (Tropoje). The proposal has not yet been adopted by the Ministry of Tourism and Environment.

As regards the old beech forests in Zall-Gjoçaj, there is no concrete proposal to include them in the Albanian system of protected areas.

The fact that only two of the six areas have a protection status is currently a call for assessing the situation of these forests, including them as soon as possible in the national system of protected areas of Albania.

Fauna

Old beech forests shelter a large number of species of flora and fauna, thus becoming very sensitive and at the same time very important environmental areas. These forests represent places of shelter and food for a large number of endangered species, part of the red list of IUCN and that of Albania. The old beech forests are the only areas in Albania where all three species of big carnivores are encountered: **The Bear** (*Ursus arctos*), **the Wolf** (*Canis lupus*) and **The Lynx** (*Lynx lynx ssp. balcanicus*) and the three species of large ungulates: **The Chamois** (*Rupicapra rupicapra*), **The wild Boar** (*Sus scrofa*) and **The European Roe Deer** (*Capreolus capreolus*).

Flora

Flora also is quite diverse and with many species that are part of the IUCN red list and that of our country. Thus old beech forests become the most important habitat of these species that are already endangered. About 81 plant species with endangered status are found in these forests.

Risk assessment

Risk assessment for each area is done by assessing any probable (current and potential) risk for the area with a scale from 1 to 10, where the number 10 represents the highest level of potential risk for the respective area and the number 1 the lowest risk. Only the top 10 risks for these areas have been analyzed and assessed:

Table 4. Major risks posed to old beech forests

Major risks posed to beech forests	Old beech forest areas					
	She-Bear 's Meadow	Gash river	Tropoje River	Upper Curraj	Zall-Gjoçaj	Rrajcë
Fires	9	8	7	8	9	6
Cutting of trees and forests	1	2	8	2	8	6
Hunting and fishing	2	3	5	2	4	5
Waste	1	2	5	2	3	5
Opening of roads/highways	1	4	10	2	8	4
Visitors	2	3	6	2	3	4
Erosion	2	2	4	2	4	4
Construction activities	2	4	6	1	2	2
Construction of HPPs	1	3	3	4	6	2
Land ownership	2	5	6	2	3	3
Assessment amount:	23	36	60	27	50	41

According to the assessment made in the table above this is the exposure situation of old beech forests to major risks:




Figure 3. Risk level by old beech forest areas

Referring to the table and chart above, Lumi i Tropojës (Tropoje River) remains the most endangered forest massif currently. This is due to the construction of the road that goes across the forest massif, bringing with itself other potential dangers (cutting of forests, fires, construction, waste, hunting etc.) in the area. Another important effect of the presence of the road and that has already shown its impact on the area is that of the construction activities that have started in the upper part of the valley; in the mountains of Sylbica. Among other massifs, that of Zall-Gjoçaj is the most vulnerable and endangered one. This is due to fires, logging and road construction, which is currently very close to the area of old beech forest. Two other massifs; Lumi i Gashit (Gash River) and Rrajca have almost the same level of risk. Rrajca remains the most vulnerable and endangered one because it is easily accessible whereas Lumi i Gashit (Gash River) is mainly endangered from the fires and construction activities that have begun in the mountains of Doberdol.

Protection of old beech forests

To protect the old beech forest areas and their naturalness, it is necessary to undertake some measures:

- Fire protection
- Increase of law enforcement
- Protection from cutting
- Prohibition of hunting and fishing
- Prohibition or restriction of construction activities
- Communication and Interpretation of the nature
- Drafting and implementation of plans for the area sustainable development
- Improvement of the legal basis on old beech forests
- Establishment of a national network for old beech forests
- Old beech forest management plan

Proposals for old beech forests in Albania

Since old beech forests do not have specific legal protection as such, it is first recommended to include them in national legislation and further in international networks or organizations. Some of the networks currently present in Europe and the World are: UNESCO, Wilderness Europe, European Beech Network, etc. It would also be necessary to establish a national network with old beech forests.

Giving the legal status (national) or integrating old beech forests into these networks is seen as the only opportunity to guarantee the protection of recent areas with old and natural forests in the country. It is understandable that much work and devotion is needed in the field to guarantee the protection of these forests from possible damages such as fires, logging, construction activities, waste, HPPs etc.

From surveys conducted on the ground, it turns out that the areas represent different situations and specific proposals need to be made for each of them;

- Inclusion in the National System of Protected Areas.
- Proposals for inclusion in the UNESCO Natural Heritage Inventory.
- Proposals for inclusion in the Wilderness Europe Network
- Proposals for inclusion in the National Network of Old Forests.

The above proposals are shown in the table below:

Table 5. Proposals concerning old beech forests

Proposals concerning old beech forests	Old Beech Forest Areas					
	Livadhi i Harushës	Gashi river	Tropoja River	Curraj i epërm	Zall-Gjoçaj	Rrajcë
UNESCO's Natural Heritage Site						
Wilderness Europe network Area						
Part of National System of Protected Areas						
Part of National Network of Old Beech Forests						
	Current proposal		The area has that status		Probable future proposal	

Referenca / References

- Atlas i Florës së Shqipërisë (2016). Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Jani Vangjeli.
- Dendrologjia (2013). Prof.Vasil Marku
- Inventory of the Largest Primeval Beech Forest in Europe. Swiss Federal Institute for Forest, Snow and Landscape Research WSL. Commarmot, Brigitte; Brändli, Urs-Beat; Hamor, Fedir; Lavnyy, Vasyi (2013).
- Ligji nr. 48/2016 për “Disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9385, Datë 4.5.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar.
- Lista e monumenteve të Natyrës, shpallur me VKM Nr. 676, datë 20.12.2002.
- Prof.Anesti Postoli (2014) mbi “Pyjet virgjër” në Shqipëri.
- Pyjet e Virgjër të Shqipërisë-(Vëzhgim ekologjik). 1997. Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave (Prof.Dr.Dalip Habili, Dr.Dhimo Koçi, Dr.Koço Danaj, Dr.Maxhun Dida), Instituti i Kërkimeve Biologjike (Prof.Dr.Jani Vangjeli, As.Prof. Dr. Babi Ruçi). Muzeu i Shkencave të Natyrës (Prof.Dr.Kastriot Misja, Prof.Dr.Nikolla Peja, As.Prof. Dr.Idriz Haxhiu, Dr.Ferdinand Bego). Dr.Phillip Brylski (Banka Botërore).
- Raport “Menaxhimi i Parqeve Kombëtare”. Kontrolli i Lartë i Shtetit (2016).
- The IUCN Red List of Threatened Species.

Gjithashtu janë konsultuar faqet e internetit;

- <http://www.iucnredlist.org>
- <http://datazone.birdlife.org/species/factsheet/>
- <http://www.akzm.gov.al/>

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Diku, Abdulla

Pyjet e vjetër të ahut në Shqipëri / Abdulla Diku, Lulëzim

Shuka ; red. Jetmira Muçaj. – Tiranë : Gent grafik, 2018

154 f. : me il. ; 16 x 24 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-202-93-2

I.Shuka, Lulëzim

1.Ahu 2.Pyje 3.Menaxhimi 4.Mbrojtja e natyrës

630.2 :582.631(496.5)



ISBN 978-9928-202-93-2



9 789928 202932